



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 64

Tiranë – E hënë, 27 prill 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 24/2015, datë 19.3.2015	Për një shtesë në ligjin nr. 48/2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”..... 2811
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 308, datë 8.4.2015	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit..... 2811
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm nr. 894, datë 11.3.2015	Për procedurat dhe rregullat e hollësishme të trajtimit të armëve provë materiale..... 2817
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 15.4.2015	Me objekt: Shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën të ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Pezullimin e ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, deri në shpalljen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese..... 2819
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 15.4.2015	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 97/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar. Pezullimin e zbatimit të ligjit deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese..... 2842
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 16.4.2015	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 10-2012-219 (132), datë 8.2.2012, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 00-2012-2437, datë 22.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi)..... 2857
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 18.3.2015	Për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 2862

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 38, datë 18.3.2015	Për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	2862
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 39, datë 18.3.2015	Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.....	2863
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 40, datë 18.3.2015	Për miratimin e raportit vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtarisë së ERE-s” gjatë vitit 2014.....	2863
Udhëzim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 4, datë 9.4.2015	Për mënyrën e caktimit dhe organizimit të vendit të numërimit të votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit.....	2864

**LIGJ**
Nr. 24/2015**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.**
48/2014 “PËR PAGESAT E VONUARA NË
DETYRIMET KONTRAKTORE E
TREGTARE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 2, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) që rrjedhin nga shitja, blerja dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, pa përfshirë pagesat që kryhen në tregun e parregulluar, sipas përcaktimeve të rregullave të tregut të energjisë elektrike.”.

Neni 2

Përfshirja e parashikuar në nenin 1 të këtij ligji i shtrin efektet deri më 1 janar 2018.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miratuar në datën 19.3.2015

VENDIM
Nr. 308, datë 8.4.2015**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,**
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SERBISË, PËR
NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE
TË DREJTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË
MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE
TË DREJTIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Serbisë, më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”, me qëllim përmirësimin e sigurisë së transportit rrugor, si dhe lehtësimin e qarkullimit rrugor në territoret e Palëve Kontraktuese,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese njohin reciprokisht lejet e rregullta të drejtimit (me përjashtim të lejeve të drejtimit të përkohshme, të provave dhe të llojeve të ngjashme) të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, në



pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, kur përdoren për qëllime qarkullimi në territoret e tyre dhe bien dakord të lejojnë konvertimin e tyre në favor të mbajtësve të lejeve të drejtimit, të cilëve u është dhënë leja e qëndrimit ose e qëndrimit të përkohshëm në territoret e tyre.

Neni 2

Leja e drejtimit e lëshuar nga një prej autoriteteve të Palëve Kontraktuese pushon së qeni e vlefshme për qëllim qarkullimi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, pas përfundimit të periudhës së qëndrimit të përkohshëm të përcaktuar nga legjislacioni përkatës i brendshëm i Palëve Kontraktuese.

Neni 3

Në interpretim të neneve të kësaj Marrëveshjeje, termi “qëndrim” dhe “qëndrim i përkohshëm” ka kuptimin e përcaktuar dhe të rregulluar nga legjislacioni përkatës i brendshëm në fuqi i Palëve Kontraktuese.

Neni 4

Nëse mbajtësve të lejeve të drejtimit, të lëshuara nga një prej autoriteteve të Palëve Kontraktuese, iu është dhënë leja e qëndrimit ose qëndrimit të përkohshëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të konvertojnë leje të tilla drejtimi pa iu nënshtruar provimeve teorike dhe praktike.

Gjatë procedurës së konvertimit të lejeve të drejtimit të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, është e detyrueshme paraqitja e një certifikate të përshtatshmërisë mjekësore, e cila vërteton se aplikanti për konvertimin e lejes së drejtimit është i përshtatshëm nga ana mjekësore për të drejtuar një mjet ose një kombinim të mjeteve të kategorisë përkatëse.

Për zbatimin e paragrafit të parë të këtij neni, mbajtësi i lejes së drejtimit duhet të ketë moshën e parashikuar nga legjislacionet përkatëse të brendshme të Palëve Kontraktuese, i cili parashikon kërkesat për lëshimin e lejes së drejtimit për të cilën kërkohet konvertimi.

Neni 5

Dispozitat e përmendura në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje nuk u referohen lejeve të drejtimit të Palëve Kontraktuese, të cilat janë lëshuar mbi bazën e shkëmbimit të një lejeje drejtimi të huaj ose dokumenti tjetër të lëshuar nga një autoritet i një pale të tretë.

Neni 6

Gjatë procedurës së konvertimit të lejeve të drejtimit, Palët Kontraktuese njohin kategoritë e barasvlershme të lejeve të drejtimit në bazë të tabelave teknike të barasvlershmërisë që i bashkëlidhen kësaj Marrëveshjeje tek e cila janë pjesë përbërëse. Këto tabela dhe një listë e modeleve të lejeve të drejtimit, përbëjnë shtojcat teknike që mund të ndryshohen me anë të një njoftimi me shkrim ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.

Autoritetet qendrore kompetente për konvertimin dhe verifikimin e lejeve të drejtimit janë si më poshtë:

a) në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës – Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

b) në Republikën e Serbisë, Ministria e Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Neni 7

Palët Kontraktuese përdorin gjuhën angleze në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe, gjithashtu, mund të bien dakord mbi përdorimin e gjuhëve të tjera për komunikim.

Neni 8

Gjatë procedurës së konvertimit të lejeve të drejtimit, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese tërheqin lejet që duhet të konvertohen dhe ua kthejnë autoriteteve kompetente të Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet misionit diplomatik ose konsullor, së bashku me një listë të këtyre lejeve dhe një njoftim.

Neni 9

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese që vlerësojnë përmbushjen e kushteve për konvertimin e një lejeje të huaj

drejtimi, mund të kërkojnë përkthimin zyrtar të saj. Autoriteti kompetent i njëres prej Palëve Kontraktuese mund të kërkojë nga autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese, nëpërmjet misionit diplomatik ose konsullor, informacion në lidhje me autenticitetin dhe vlefshmërinë e lejes së drejtimit dhe të dhënave të përcaktuara në të.

Neni 10

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike që konfirmon se Palët Kontraktuese kanë përmbushur të gjitha procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar. Secila Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër

Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast denoncimi do të hyjë në fuqi pas gjashtë muajsh nga data e marrjes së këtij njoftimi.

Çdo konflikt në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me anë të konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese.


Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me miratim të ndërsjellë me shkrim të Palëve Kontraktuese. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

Bërë në Beograd, më 17.12.2014, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

SHTOJCA 1

I. MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT TË LËSHUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

a) Leja e drejtimit prej *letrë* (modeli i vjetër) e lëshuar deri më 30 qershor 2005, e vlefshme deri me 1 korrik 2015.





LLOJI I DESHMISE SE AFTESISE		KOHA E LESHIMIT	FIRMA, VULA
A	Motocikletë me pesë deri 400 kg	Data Prot. Nr.	
B	Automjete, përjashto A, me pesë me ngarkesë të plotë 3500 kg, ose me tetë vende, përjashto drejtuesin	Data Prot. Nr.	
C	Automjete për transport mallrash me ngarkesë të plotë mbi 3500 kg	Data Prot. Nr.	
D	Automjete për transport personash me mbi tetë vende përjashto drejtuesin	Data Prot. Nr.	
E	Automjete të kategorisë B, C dhe D, për të cilat drejtuesi është aftësuar në drejtues me rimorkio jo të lehtë	Data Prot. Nr.	
F	Traktore me mota, toke që lëvizin me rimorkio me pesë me ngarkesë të plotë jo më të madhe se pesë të tona të lehtë	Data Prot. Nr.	

SHENIM: Automjeteve të kategorisë B, C dhe D mund t'u lidhet prapëtim rimorkio të lehtë, me kusht që për kategorinë B pesha e saj dhe e mjetit tërëqes me ngarkesë të plotë të mos kalojë 3500 kg.

b) Leja e drejtimit prej *kartoni* (modeli i ri), në përdorim zyrtar që nga data 1 korrik 2005.





II. MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT TË LËSHUARA NË REPUBLIKËN E SERBISË

a) Leja e drejtimit prej *letre* (modeli i vjetër), në përdorim zyrtar që prej muajit gusht 2006, e vlefshme deri më 10 qershor 2017.

The image shows the front of a pink Serbian Driving License (leja e drejtimit prej letre). It features the coat of arms of the Republic of Serbia at the top center, followed by 'REPUBLIKA SRBIJA' and 'SRB' in a blue oval. Below this, it says 'VOZAČKA DOZVOLA' and 'PERMIS DE CONDUIRE'. The license number 'CP00000000' is printed in red at the bottom. The form includes fields for 'PROMENA PREBIVALIŠTA' (Change of Residence) and 'PRODUŽENO VAŽENJE VOZAČKE DOZVOLE' (Extension of Driving License Validity), both with sections for 'do' (valid until) and 'g.' (month/year), and 'Datum' (Date) and 'Potpis' (Signature). There are also sections for 'MERA BEZBEDNOSTI ILI ZAŠTITNA MERA' (Safety or Protective Measure) and 'ZABRANJENO JE DA UPRAVLJA MOTORNIM VOZILOM KATEGORIJE' (Prohibited from driving motor vehicles of category), with fields for 'od' (from) and 'do' (until), and 'Datum' (Date) and 'Potpis' (Signature).

The image shows the back of a pink Serbian Driving License (leja e drejtimit prej kartoni). It features the coat of arms of the Republic of Serbia at the top center, followed by 'REPUBLIKA SRBIJA' and 'SRB' in a blue oval. Below this, it says 'VOZAČKA DOZVOLA' and 'PERMIS DE CONDUIRE'. The license number 'CP00000000' is printed in red at the bottom. The form includes fields for '1. Prezime' (Surname), '2. Ime' (First Name), '3. Datum i mesto rođenja' (Date and place of birth), '4. Jedinstveni matični broj' (Unique Matriculation Number), '5. Prebivalište (mesto)' (Residence (place)), '6. Potpis vozača' (Driver's Signature), '7. U' (Issued on), '8. Važi do' (Valid until), '9. Br.' (Number), '10. M. P.' (Month/Year), and '11. Potpis' (Signature). There is a section for 'FOTOGRAFIJA VOZAČA 35 x 45 mm' (Driver's Photo 35 x 45 mm). The right side of the form contains a table for 'KATEGORIJA VOZILA ZA KOJU VAŽI VOZAČKA DOZVOLA' (Vehicle Category for which the Driving License is valid).

KATEGORIJA VOZILA ZA KOJU VAŽI VOZAČKA DOZVOLA	M. P.
A Motocikli	M. P.
B Motorna vozila, osim motocikla, čija najveća dozvoljena masa ne prelazi 3.500 kg i čiji broj sedišta ne računajući sedišta vozača, ne prelazi osam	M. P.
C Motorna vozila za prevoz tereta čija najveća dozvoljena masa prelazi 3.500 kg	M. P.
D Motorna vozila za prevoz lica koja, pored sedišta za vozača, imaju više od osam sedišta	M. P.
E Skupovi vozila čija vučna vozila spadaju u kategoriju B, C ili D, a sami skupovi ne spadaju u kategoriju tih vučnih vozila	M. P.
OGRANICENJE:	

b) Leja e drejtimit prej *kartoni* (modeli i ri), në përdorim zyrtar që nga muaji janar 2011.

The image shows the front of a new Serbian Driving License (leja e drejtimit prej kartoni). It features the coat of arms of the Republic of Serbia at the top center, followed by 'REPUBLIKA SRBIJA' and 'REPUBLIC OF SERBIA'. Below this, it says 'VOZAČKA DOZVOLA' and 'DRIVING LICENCE'. The license number '0999999999' is printed in red at the bottom. The form includes fields for '1. TEST', '2. MILICA', '3. 29.02.1968. BEOGRAD', '4a. 27.04.2011. 4b. 27.04.2021.', '4c. PU ZA GRAD BEOGRAD', '5. 0999999999', '7. Milica Test', '8. BEOGRAD', and '9. AM B B1 BE C C1 F M'. There is a section for 'FOTOGRAFIJA VOZAČA 35 x 45 mm' (Driver's Photo 35 x 45 mm). The right side of the form contains a table for 'KATEGORIJA VOZILA ZA KOJU VAŽI VOZAČKA DOZVOLA' (Vehicle Category for which the Driving License is valid).

KATEGORIJA VOZILA ZA KOJU VAŽI VOZAČKA DOZVOLA	M. P.
A Motocikli	M. P.
B Motorna vozila, osim motocikla, čija najveća dozvoljena masa ne prelazi 3.500 kg i čiji broj sedišta ne računajući sedišta vozača, ne prelazi osam	M. P.
C Motorna vozila za prevoz tereta čija najveća dozvoljena masa prelazi 3.500 kg	M. P.
D Motorna vozila za prevoz lica koja, pored sedišta za vozača, imaju više od osam sedišta	M. P.
E Skupovi vozila čija vučna vozila spadaju u kategoriju B, C ili D, a sami skupovi ne spadaju u kategoriju tih vučnih vozila	M. P.
OGRANICENJE:	



13. (14.)

VD 000000000

1. Презиме 2. Име
3. Датум и место рођења
4а. Датум издавања дозволе
4б. Дозвола важи до
4с. Дозвола издао
5. Број дозволе
8. Пребивалиште
9. Категорије
10. Важи од
11. Важи до
12. Ограничења

999999990

	9.	10.	11.	12.
AM	27.11.1991.	27.04.2021.	-	
A1	-	-	-	
A2	-	-	-	
A	-	-	-	
B1	27.11.1991.	27.04.2021.	-	
B	27.11.1991.	27.04.2021.	-	
BE	27.11.1991.	27.04.2021.	-	
C1	05.06.1994.	27.04.2021.	-	
C1E	-	-	-	
C	05.06.1994.	27.04.2021.	-	
CE	-	-	-	
D1	-	-	-	
D1E	-	-	-	
D	-	-	-	
DE	-	-	-	
F	27.11.1991.	27.04.2021.	-	
M	27.11.1991.	27.04.2021.	-	
12.				

SHTOJCA 2
TABELAT E BARASVLERSHMËRISË

I. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Serbisë sipas modelit prej letre në përdorim zyrtar që prej muajit gusht 2006 me leje drejtimi të Republikës së Shqipërisë

Leje drejtimi e Republikës së Serbisë	Leje drejtimi të Republikës së Shqipërisë						
	A	B	C	D	BE	CE	DE
A	x						
B		x					
C			x				
D				x			
E*					x	x	x

*Kategoria E konvertohet me kategoritë BE, CE ose DE, nëse leja e drejtimit është lëshuar për kategoritë B,C ose D dhe kategoria E u përfutua pas fitimit të së drejtës për të drejtuar mjete me traktor.

II. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Serbisë në përdorim zyrtar që prej 1 janarit 2011 me leje drejtimi të Republikës së Shqipërisë

Lejet e drejtimit të Republikës së Serbisë	Lejet e drejtimit të Republikës së Shqipërisë						
	A	B	C	D	BE	CE	DE
AM							
A1							
A2							
A	x						
B1							
B		x					
BE					x		
C1							
C1E							
C			x				
CE						x	
D1							



D1E							
D					X		
DE							X
F							
M							

III. Për konvertimin e lejeve të drejtimit të Republikës së Shqipërisë, të lëshuara deri më 30 qershor 2005, të vlefshme deri më 1 korrik 2015 me leje drejtimi të Republikës së Serbisë

Leje drejtimi të Republikës së Shqipërisë	Leje drejtimi të Republikës së Serbisë																
	AM	A1	A2	A	B1	B	BE	C1	C1E	C	CE	D1	D1E	D	DE	F	M
A				X													
B						X											
C										X							
D														X			
E*							X				X				X		
F																X	

* Kategoritë E konvertohen me kategoritë BE, CE ose DE, nëse leja e drejtimit është lëshuar për kategoritë B, C ose D dhe kategoritë E u përfshijnë pas fitimit të së drejtës për të drejtuar mjete me traktor.

IV. Për konvertimin e lejeve të drejtimit prej kartoni të Republikës së Shqipërisë (modeli i ri) në përdorim zyrtar që prej datës 1 korrik 2005 me leje drejtimi të Republikës së Serbisë

Leje drejtimi të Republikës së Shqipërisë	Leje drejtimi të Republikës së Serbisë																
	AM	A1	A2	A	B1	B	BE	C1	C1E	C	CE	D1	D1E	D	DE	F	M
A				X													
B						X											
C										X							
D														X			
BE							X										
CE											X						
DE															X		

UDHËZIM

Nr. 894, datë 11.3.2015

PËR PROCEDURAT DHE RREGULLAT E HOLLËSISHME TË TRAJTIMIT TË ARMËVE PROVË MATERIALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, shkronjës “c”, të nenit 7 dhe në zbatim të nenit 43, pika 2, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”,

UDHËZOJMË:

I. Provat materiale, armatimi e municione luftarake dhe sportive, trajtohen si më poshtë:

1. Armët e kapura, e zbuluara e të sekuestruara si provë materiale në vendngjarje

apo në rrethana të tjera, të trajtohen me kujdes për mosdëmtimin e gjurmëve, të cilat ndikojnë në dokumentimin ligjor ose jo të veprës penale. Provat materiale merren në vendin e ngjarjes nga oficeri i policisë gjyqësore (OPGJ), i cili ka kryer këqyrjen e vendit të ngjarjes apo ka bërë sekuestrimin e provës materiale. Procesverbali i përshkrimit të armës, duhet të përmbajë detyrimisht:

a) të dhëna për armën: tipi, kalibri, fabrika e prodhimit, modeli, numri i serisë;

b) nëse ka shenja të veçanta apo ndryshime të konstruktit, apo sipërfaqes së armës.

2. Armët e sekuestruara si provë materiale, që merren në vendin e ngjarjes apo në rrethana të tjera, dërgohen për t'u ekzaminuar në Drejtorinë e Policisë Shkencore. Titullari i njësisë vendore të



policisë merr masa për dërgimin e provës materiale (armë, municion) në Drejtorinë e Policisë Shkencore nën përgjegjësinë e ekspertit kriminalist/oficeri i policisë gjyqësore.

3. Oficeri i policisë gjyqësore, që ka kryer këqyrjen e vendit të ngjarjes apo sekuestrimin e provës materiale ose punonjësi i policisë i autorizuar, e dorëzohet provën materiale, armën, në Drejtorinë e Policisë Shkencore, së bashku me vendimin e ekspertimit kundrejt firmës së marrësit e të dorëzuesit.

Drejtoria e Policisë Shkencore administrimin e trajtimin e armës provë materiale e kryen sipas rregullave të brendshme të vendosura prej saj.

4. Eksperti kriminalist/oficeri i policisë gjyqësore në njësitë vendore të policisë, është përgjegjës për tërheqjen e provës materiale, së bashku me vendimet përkatëse nga Drejtoria e Policisë Shkencore.

5. Arma provë materiale, që kthehet nga Drejtoria e Policisë Shkencore në njësinë policore që e ka dërguar, i dorëzohet së bashku me aktin e ekspertimit, kundrejt firmës punonjësit të policisë/oficerit të policisë gjyqësore që ka kryer këqyrjen e vendit të ngjarjes apo sekuestrimin e provës materiale.

6. Punonjësi i policisë/oficeri i policisë gjyqësore është i detyruar, që brenda ditës së marrjes së armës provë materiale, të bëjë hyrjen e saj, kundrejt dokumentacionit respektiv, në depon e armatimit të drejtorisë së policisë së qarkut apo të komisarariatit të policisë, ku ai është efektiv.

7. Provat materiale në njësitë vendore të policisë ruhen në magazinat të veçanta nga ato ku ruhet armatimi municioni e pajisjet organike të policisë. Në rastet e vendosjes së mosfillimit të procedimit, pushimit të çështjes ose parashkrimit të procedimit penal, lidhur me provat materiale, veprohet sipas urdhrat të Prokurorit.

8. Ndalohet mbajtja e armëve, municionit, lëndëve plasëse në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, ekspertëve kriminalistë apo çdo punonjësi tjetër të policisë, prokurorëve e gjyqtarëve, përveç depos së caktuar për këtë qëllim.

9. Punonjësi i policisë/oficeri i policisë gjyqësore është i detyruar, që brenda 24 orëve të dorëzojë armën, municionin provë materiale së bashku me procesverbalin e sekuestrimit në

depon e provave materiale, armatimit të njësisë vendore të policisë.

Në procesverbalin e sekuestrimit të armës nga oficeri i policisë gjyqësore duhet të regjistrohet detyrimisht:

a) numri dhe viti i procedimit penal të çështjes referuar në prokurorinë përkatëse;

b) shenja të veçanta apo ndryshime të konstruktit apo veshjes së armës.

10. Punonjësi i policisë/oficeri i policisë gjyqësore, jo më vonë se 24 orë nga dorëzimi i armës provë materiale në magazinë, vendos në dosjen hetimore respektive një kopje të dokumentit, fletëhyrjes së armës provë materiale në magazinë.

11. Armët apo materialet e tjera, kur lind nevoja për kryerjen e veprimeve hetimore, të dërgohen për riekperimentim, eksperimente hetimore etj., tërhiqen nga depo ku janë lënë në ruajtje nga punonjësi i policisë/oficeri i policisë gjyqësore ose person tjetër i pajisur me autorizim nga prokurori i rrethit gjyqësor ose gjyqtari i çështjes. Autorizimi i prokurorit/gjyqtarit sigurohet nga shefi i komisarariatit të policisë, për një afat të caktuar, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë. Personi i autorizuar për marrjen në dorëzim të armës apo të materialeve të tjera firmos, në librin e daljes së përkohshme, ndërsa autorizimi mbahet nga magazinieri.

12. Me marrjen e njoftimit për vendimin e formës së prerë të gjykatës ose pushimit të çështjes nga Prokurori, njësia policore, ku është administruar arma si provë materiale, merr masa që brenda 15 ditëve, armët e vërtetuara në organikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Shërbimit Informativ Shtetëror apo në pronësi të subjekteve juridike e fizike t'u jepen atyre kundrejt dokumenteve të përcaktuara në aktet respektive, kurse të tjerat dorëzohen në magazinat qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

13. Drejtoria e Policisë Shkencore mban për qëllime studimore (metodike e didaktike) armë të kapura, të zbuluara e të sekuestruara, vetëm pasi të ketë mbaruar procesi gjyqësor i shprehur në vendimin e formës së prerë. Procedura e mbajtjes së këtyre armëve bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 94, datë 4.2.2015, "Për procedurat për armët, në rastet e deklarimit të vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të



aktivitetit, për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit”.

II. Provat materiale me përbërje lëndë plasëse

14. Provat materiale me përbërje eksplozivi merren në vendin e ngjarjes, duke respektuar rregullat e shërbimit kriminalistik dhe rregullat e sigurimit teknik nga punonjësi i policisë/oficeri i policisë gjyqësore dhe ekspertë kriminalist, që kryejnë këqyrjen e vendit të ngjarjes apo kanë sekuestruar provën materiale.

15. Prova materiale me përbërje eksplozive, që paraqesin rrezik për shpërthim, sekuestrimi dhe transportimi i tyre për në vende të sigurta bëhet me ndihmën e ekspertëve me njohuri të posaçme të specialistëve antieksplzivë.

16. Provat materiale me përbërje eksplozivi dhe që nuk paraqesin rrezik shpërthimi në të gjitha rastet ruhen në magazinën/depon e armatimit të drejtorisë së policisë të qarkut ose të komisarariatit të policisë.

17. Për ekspertimin ose për riekspertimin dhe veprime të tjera me to, zbatohen rregullat e përcaktuara në pikën 11, “Provat materiale, armatim dhe municioneve luftarake e sportive”.

18. Provat materiale me përbërje eksplozivi, që paraqesin rrezik të menjëhershëm shpërthimi dhe teknikisht nuk mund të ruhen, asgjësohen me urdhër të Prokurorit për ekzekutimin e provës materiale. Për asgjësimin e këtyre provave materiale hartohet procesverbal i veçantë, i cili i bashkëngjitet dosjes hetimore. Asgjësimi i tyre bëhet nga specialistë antieksplzivë në vend ose nëse mund të transportohen në poligone të miratuara me ligj, në prezencë të OPGJ-së dhe ekspertit kriminalist.

19. Me marrjen e vendimit të formës së prerë, prokurori nxjerr urdhrin për ekzekutimin e vendimit që kanë lidhje me disponimin e provave materiale armatim, municion, lëndë plasëse. Një kopje e vendimit i dërgohet njësisë së policisë që ruan provat materiale.

20. Provat materiale armatim, municion, lëndë plasëse, pasi ka dalë urdhri i prokurorit, Policia e Shtetit një herë në vit bën dorëzimin e armatimit, municionit, lëndës plasëse në Ministrinë e Mbrojtjes për t'i kaluar në procedura të tjera të asgjësimit, riparimit apo shitjes.

21. Me këtë udhëzim të njihen punonjësit e policisë, punonjësit e strukturave të Prokurorisë

së Përgjithshme, punonjësit e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes.

22. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen punonjësit e Policisë së Shtetit, punonjësit e prokurorive, punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes.

23. Aktet e tjera nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë udhëzim, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Saimir Tahiri

MINISTRI I MBROJTJES

Mimi Kodheli

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Adriatik Llalla

VENDIM

Nr. 19, datë 15.4.2015

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 9.12.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare, çështjen nr. 59/27 Akti që i përket:

KËRKUES: Një grup deputetësh, jo më pak se 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga zoti Oerd Bylykbashi, zoti Gazment Bardhi dhe zoti Ivi Kaso.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), përfaqësuar përfaqësuar në gjykim nga zoti Armando Subashi, zoti Alban Brati dhe zonja Mimoza Pano.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga zoti Bledi Çuçi, zoti Artur Metani dhe zoti Enea Hoti.



OBJEKTI: Shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Pezullimin e ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, deri në shpalljen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 13, 75, 83/3, 108, 116, 131, shkronja “a” dhe 134/1 shkronja “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, i cili kërkonte pranimin e kërkesës; prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, të cilat kërkonin rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi, me ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (*në vijim “ligji nr. 115/2014”*), ka miratuar ndarjen e re administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore. Sipas ligjit, numri i njësive të qeverisjes vendore është 61 bashki dhe 12 qarqe. Emërtimi, shtrirja territoriale, kufijtë, qendra, njësitet administrative përbërëse për çdo njësi të qeverisjes vendore dhe nënndarjet e tyre janë të përcaktuara në hartat dhe tabelat bashkëlidhur me ligjin (*nenet 1 dhe 2*).

2. Organet e njësive të qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011 dhe me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuara me ligjin nr. 8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2015. Zgjedhjet për organet e

qeverisjes vendore të vitit 2015 do të organizohen dhe zhvillohen mbi bazën e ndarjes administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj. Organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, do të organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj (*neni 3 i ligjit*).

3. Po sipas këtij ligji, ligji nr. 8653, datë 31.7.2000, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet (*neni 4/2*). Ky ligj, i shfuqizuar tashmë, përcaktonte se ndarja administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë është 309 komuna, 65 bashki dhe 12 qarqe (*neni 1*).

II

4. **Kërkuar** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr. 115/2014, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

4.1 Komisioni i Posaçëm i krijuar për reformën territoriale nuk ka qenë gjithëpërfshirës dhe konsensual.

4.2 Projektligji është shqyrtuar në kundërshtim me rregullat kushtetuese të procesit ligjvënës, të sanksionuara në nenin 81/2, shkronja “P”, 83/3 dhe 75/2 të Kushtetutës, si dhe në Rregulloren e Kuvendit.

4.3 Ligji nr. 115/2014 ka bërë një ndryshim të kufijve ekzistues të komuniteteve vendore, duke i zgjeruar ato në kuptimin ekonomik, tradicional. Kushtetuta detyron ligjvënësin që në rastet e ndarjes ekzistuese territoriale të realizojë konsultimin paraprak me popullsinë, në mënyrë që të shprehet drejtpërdrejt lidhur me ndryshimin e kufijve nëpërmjet bashkimit të njësive territoriale dhe suprimimit të organeve vetëqeverisëse.

4.4 Ligji nr. 115/2014 ka cenuar parimin e hierarkisë së akteve normative dhe të shtetit të së drejtës, pasi jo vetëm nuk ka plotësuar dhe rregulluar njësitet bazë të qeverisjes vendore, por në mënyrë antikushtetuese dhe abuzive ka suprimuar komunën si një prej njësive bazë të qeverisjes vendore, të përcaktuara në nenin 108/3 të Kushtetutës. Njësitet bazë të përcaktuara në këtë dispozitë dhe kompetencat e tyre mund të hiqen apo ndryshohen vetëm me amendament kushtetues.



4.5 Ligjit nr. 115/2014 cenon parimin e barazisë së votës, pasi njësitë e ndryshme territoriale kanë madhësi të pakrahasueshme me njëratjetrën, edhe pse janë të gjitha bashki, duke ndikuar drejtpërdrejt në peshën e votës së zgjedhësve.

4.6 Ligji nr. 115/2014 ka marrë për bazë censusin e vitit 2011, duke iu referuar një numri popullsie jashtë parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

4.7 Ligji nr. 115/2014 deformon votën e zgjedhësve, pasi paracaktohet rezultati zgjedhor për zgjedhjet vendore për anëtarë të këshillave bashkiakë dhe kryetarë bashkish nga ndarja e re territoriale, fenomene të njohura përkatësisht për sisteme proporcionale si “gjeometri aktive zgjedhore” dhe për sisteme mazhoritare si “garrymandering”.

5. Subjekti i interesuar, Kuvendi ka prapësuar se:

5.1 Projektligji, si nismë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nuk është shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar.

5.2 Komisioni i Posaçëm, duke pasur kompetenca shteruese mbi çështjen e rëndësishme që i është ngarkuar, në parim e bën të panevojshme shqyrtimin e nismës ligjvënëse të Komisionit të Posaçëm nga komisionet e përhershme të Kuvendit e për rrjedhojë të panevojshme përfshirjen në programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit.

5.3 Në kuptimin e nenit 108 të Kushtetutës, marrja e mendimit të popullsisë, nuk është domosdoshmërisht marrja e pëlqimit të popullsisë.

5.4 Ligji nuk ka cenuar parimin e subsidiaritetit, sepse nuk ka pasur për qëllim organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, por vetëm ndarjen administrativo-territoriale.

5.5 Suprimimi i komunës nuk sjell probleme për kushtetutshmërinë e ligjit, pasi “bashkia” dhe “komuna”, sipas nenit 108 të Kushtetutës, janë të dyja njësi bazë të qeverisjes vendore, dhe si të tilla mund të ekzistojnë të dyja ose vetëm njëra.

5.6 Elementi i popullsisë është kriter variabël dhe dinamik dhe mbi të gjitha nuk është kriter kushtetues për ndarjen administrativo-territoriale, prandaj edhe pretendimi për mbështetjen e reformës territoriale në censusin e vitit 2011 si antikushtetues, është i pabazuar.

5.7 Pretendimet për cenimin e parimit të barazisë së votës janë të pambështetura në argumente kushtetuese, pasi për zhvillimin e

zgjedhjeve vendore të ardhshme dhe numrin e zgjedhësve, organet e ngarkuara nga ligji zgjedhor do t’i referohen Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile dhe jo Censurit të vitit 2011.

6. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave ka prapësuar se:

6.1 Procesi i ndarjes administrativo-territoriale dhe kufijtë e njërive të qeverisjes vendore që rezultojnë prej këtij procesi, edhe pse gëzojnë mbrojtje kushtetuese, nuk përfshihen në sferën e rezervës së të drejtave dhe kompetencave që Kushtetuta ia njeh ekskluzivisht pushtetit vendor, përkundrazi neni 81/2, shkronja “P” e Kushtetutës për ndarjen administrativo-territoriale ka parashikuar miratimin me ligj nga Kuvendi.

6.2 Në një interpretim literal, sistematik dhe teleologjik të nenit 108/2 të Kushtetutës, ndryshimi i kufijve të njërive të qeverisjes vendore i nënshtrohet vetëm kushtit të marrjes paraprake të mendimit të popullsisë që banon në to, por jo edhe marrjes domosdoshmërisht paraprakisht të pëlqimit të kësaj popullsie.

6.3 Ndarja e kufijve administrativo-territoriale nuk është çështje thjesht me karakter vendor, por ajo ka një ndikim të rëndësishëm në interesin e përgjithshëm kombëtar.

6.4 Neni 108 i Kushtetutës nuk ka bërë asnjë dallim thelbësor për bashkitë apo komunat si njësi bazë të qeverisjes vendore sa i përket mënyrës së krijimit, organizimit dhe ushtrimit të kompetencave të tyre, prandaj edhe përdorimi i termit “bashki” apo “komuna” nuk paraqet asnjë dallim nga pikëpamja kushtetuese.

6.5 Argumentet e kërkuarit mbi deformimin dhe paracaktimin e rezultatit i referohen rezultatit të zgjedhjeve të mëparshme, prirjeve të elektoratit dhe historikut të rezultatit ndër vite, si dhe formulës së përcaktimit të mandateve vendore, këshilltar bashkiak/banorë, që pritet të ndryshohet, kështu që nuk mund të shërbejnë si shkak për shfuqizimin e ligjit nr. 115/2014.

III

Vlerësimi i Gjykatës

A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 115/2014

7. Kërkuarisi ka kërkuar pezullimin e ligjit nr. 115/2014, duke parashtruar këto argumente: ligji mund të sjellë pasoja që prekin interesa



shtetërore, shoqërore ose të individëve; dëmi që mund t'u shkaktohet interesave shtetërore është i rëndë dhe i pamundur për t'u riparuar, pasi zhvillimi i zgjedhjeve jo të rregullta dhe jo në përputhje me standardet, si pasojë e mungesës së kohës së mjaftueshme për përgatitjen e tyre, sjell deformim të vullnetit të zgjedhësve dhe cenim të së drejtës së tyre kushtetuese; nga ana tjetër, ekziston urgjencë për pezullimin e ligjit, sepse dekretimi i zgjedhjeve dhe përgatitja e tyre fillon shumë kohë para përfundimit të mandatit të organeve ekzistuese; vendimi i Gjykatës Kushtetuese hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe organet zgjedhore nuk kanë kohën e mjaftueshme për përgatitjen e zgjedhjeve.

8. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt shqyrtimi të paraqitur nga kërkuuesi dhe vlerësoi se kjo kërkesë nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Për rrjedhojë, Gjykata në datën 13.11.2014 ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë si të papabuar.

B. Për legjitimitimin e kërkuetit¹

9. Edhe pse subjektet e interesuara nuk kanë parashtruar pretendime që kanë lidhje me legjitimitimin e kërkuetit, Gjykata çmon të ndalet te ky kriter i vënies në lëvizje të Gjykatës për kontrollin kushtetues abstrakt të normës juridike.

10. Gjykata rithekson se në nenin 134/1 të Kushtetutës është përcaktuar në mënyrë shteruese rrethin e subjekteve kushtetuese, të cilat legjitimohen të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kriteri kushtetues i "detyrimit për të justifikuar interesin", i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit të mësipërm, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues në ndarjen e rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori: subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, subjektet e parashikuara në shkronjat "dh", "e", "ë", "f" dhe "g", të paragrafit 1, të nenit 134, të cilat mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre, janë subjekte të kushtëzuara. Parashikimi i këtij kriteri kushtetues vetëm për

një numër të kufizuar subjektësh kushtetuese, në një interpretim *a contrario*, do të thotë se ai nuk është i zbatueshëm për subjektet e tjera të parashikuara në pikat "a", "b", "c", "ç" të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës, të cilat nuk kanë detyrimin për të justifikuar interesin në rast se i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) të një të pestës së deputetëve ka qenë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë në shumë raste të tjera, në të cilat ajo në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar se një e pesta e deputetëve përfaqëson një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1, shkronja "c" të Kushtetutës, të cilat kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimet nr. 18, datë 29.7.2008; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata në asnjë rast nuk e ka vënë në dyshim legjitimitimin e një të pestës së deputetëve, kur ata i janë drejtuar kësaj Gjykate për kontrollin abstrakt të normës juridike, prandaj ajo rithekson se në referim të nenit 134/1, shkronja "c", të Kushtetutës, 1/5 e deputetëve të Kuvendit përfaqëson një subjekt me legjitimitet të pakushtëzuar dhe si e tillë ka të drejtë të kërkojë kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së një akti normativ.

C. Për themelin

1. Për pretendimin se procedura e miratimit të ligjit është në kundërshtim me nenet 81/2, shkronja "f", 83/3 dhe 75/2 të Kushtetutës si dhe me Rregulloren e Kuvendit

13. Kërkuuesi pretendon se projektligji është shqyrtuar në kundërshtim me kërkesat kushtetuese të procesit ligjvënës të sanksionuara në nenet 81/2, shkronja "f", 83/3 dhe 75/2 të Kushtetutës. Sipas tij, nisma ligjvënëse për këtë projektligj është depozituar në Kuvend në datën 23.7.2014, duke u futur për miratim në seancën e datës 31.7.2014, edhe pse nuk ishte përfshirë në kalendarin 3-javor të punimeve të Kuvendit (për

¹ Gjyqtari V. Kristo votoi kundër legjitimitimit të kërkuetit, sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 25, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese.



periudhën 4-25 korrik), jashtë radhës së përcaktuar, veprime që e kthejnë procedurën e shqyrtimit të këtij ligji në procedurë të përshpejtuar. Gjithashtu, po në këtë drejtim, kërkuksi pretendon shkelje të nenit 75/2 të Kushtetutës, pasi projektligji nuk është shqyrtuar dhe miratuar paraprakisht nga Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

14. Subjekti i interesuar, Kuvendi, pretendon se projektligji si nismë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nuk mund të shqyrtohej dhe nuk është shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar. Shqyrtimi dhe miratimi nga komisionet e përhershme, në kushtet e krijimit të një komisioni të posaçëm për një çështje të rëndësishë së veçantë, e bën të panevojshëm shqyrtimin nga komisionet e përhershme.

15. Gjykata çmon të sqarojë paraprakisht se pretendimet e kërkuksit të lidhura me Rregulloren e Kuvendit do të vlerësohen, me qëllim që t'i jepet përgjigje pretendimit për shkelje të nenit 83/2 të Kushtetutës mbi zbatimin e procedurës së përshpejtuar për miratimin e ligjit edhe pse kjo Rregullore nuk përbën lëndë kontrolli kushtetues. Sipas Gjykatës, nisur nga natyra harmonike e normave kushtetuese, parashikimi i nenit 81, pika 2, shkronja “P” duhet analizuar në raport me rregullimet e nenit 83, pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës, por edhe me nenet përkatëse të Rregullores së Kuvendit që parashikojnë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve, si dhe përjashtimet në lidhje me to, në këndvështrim të nenit 75/2 të Kushtetutës.

16. Kërkuksi bazohet vetëm në dy momente procedurale, të cilat sipas tij nuk janë bërë sipas parashikimeve të Rregullores së Kuvendit dhe që *de facto* e kanë bërë procedurën e miratimit të ligjit objekt shqyrtimi të përshpejtuar: a) mosshqyrtimi i projektligjit nga Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut; b) futja në rendin e ditës pa u përfshirë më parë në kalendarin 3-javor të punimeve.

17. Neni 77/1 i Kushtetutës përcakton se Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme. Komisionet parlamentare organizohen dhe funksionojnë sipas Rregullores së Kuvendit.

18. Në bazë të Rregullores së Kuvendit, komisionet e përhershme shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryejnë studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozojnë për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta (*neni 18*). Përbërja e komisioneve të përhershme, për aq sa është e mundur, pasqyron grupet parlamentare, sipas përpjesëtimimit që zënë në Kuvend (*neni 20*).

19. Komisionet e posaçme krijohen nga Kuvendi për shqyrtimin dhe përgatitjen e nismave ligjvënëse, si dhe për çështje të një rëndësie të veçantë (*neni 24*). Pra, këto komisione, në dallim nga komisionet e përhershme, përveç funksionit të shqyrtimit të projektakteve që i paraqiten Kuvendit, ngarkohen, ndër të tjera, edhe me detyrën për propozimin e nismave ligjvënëse, të cilat formalizohen si propozime të një grupi deputetësh. Rregullat për organizmin dhe zhvillimin e mbledhjeve të komisioneve të përhershme zbatohen edhe për komisionet e posaçme, me përjashtim të rastit kur Kuvendi vendos ndryshe. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka në fushën e tij të përgjegjësisë kodet dhe organizimin e pushtetit gjyqësor, administratën publike, organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut (*neni 19*).

20. Konkretisht, Kuvendi me vendimin nr. 1, datë 23.1.2014, “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-territoriale. Komisioni i Posaçëm ka pasur për objekt të veprimtarisë së tij: i) Përcaktimin e kriterëve për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë; ii) Hartimin dhe përcaktimin e kalendarit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale; iii) Përgatitjen e projektit për ndarjen e re administrativo-territoriale (*pika 2 e vendimit*). Në përbërje të tij parashikohej të kishte 16 anëtarë, nga të cilët 8 përfaqësues të pozitës (6



PS-ja, dhe 2 LSI-ja) dhe 8 përfaqësues të opozitës (6 PD-ja, 1 PR-ja, dhe 1 PDIU-ja). Emrat e anëtarëve të komisionit do të përcaktoheshin me vendim të Kuvendit (*pika 3 e vendimit*). Komisioni do të zhvillonte veprimtarinë e tij në një afat kohor 3-mujor, nga data 24.1.2014 deri në datën 24.4.2014 (*pika 5 e vendimit*).

21. Gjykata vëren se Komisioni i Posaçëm i krijuar me vendimin e sipërcituar nuk ka funksionuar, duke mosrealizuar asnjë mbledhje apo vendimmarrje deri në afatin e parashikuar për veprimtarinë e tij, që ishte data 24.4.2014. Me vendimin nr. 24, datë 24.4.2014, Kuvendi ndryshoi pikën 3 të vendimit mbi përbërjen e Komisionit, duke përcaktuar se “Komisioni i Posaçëm ngrihet mbi bazën e përfaqësuesve pozitë-opozitë. Në përbërje të tij do të ketë 17 anëtarë, nga të cilët 9 janë përfaqësues të pozitës (7 PS-ja dhe 2 LSI-ja) dhe 8 përfaqësues të opozitës (6 PD-ja, 1 PR-ja dhe 1 PDIU-ja); emrat e anëtarëve të komisionit përcaktohen me vendim të Kuvendit; opozita ruan të drejtën për të kërkuar ndryshimin e këtij përfaqësimi në çdo moment, mbi bazë të barazisë së anëtarësive pozitë-opozitë, në këtë komision. Me pjesëmarrjen e opozitës në këtë komision, mbi bazën e parimit të barazisë së anëtarësive pozitë-opozitë, pozita garanton respektimin e këtij parimi si në përbërje, ashtu dhe në vendimmarrje. Kuvendi miraton menjëherë raportin e ri të përfaqësimit, në përbërje të këtij komisioni.” (*pika 3 e ndryshuar*). Në lidhje me afatin e veprimtarisë së komisionit, ndryshohet, duke u përcaktuar si afat përfundimi data 24.6.2014 (*pika 5 e ndryshuar*). Ndërsa me vendimin nr. 43, datë 24.6.2014 të Kuvendit, “Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 1, datë 23.1.2014, “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me vendimin nr. 24/2014”, ky afat i veprimtarisë së komisionit shtyhet deri me datë 31.7.2014. Ky komision pas miratimit të programit, ka zhvilluar mbledhjet e tij, sipas kalendarit të dëgjësave publike, me rend dite: - Seancë dëgjimore me përfaqësues të njëjësive të qeverisjes vendore dhe shoqatave të të zgjedhurve vendorë (*referuar procesverbalit të datës 29.4.2014 dhe procesverbalit 2.5.2015*); - Seancë dëgjimore me organizatat

jofitimprurëse (*referuar procesverbalit të datës 5.5.2014*); - Seancë dëgjimore paradite me përfaqësues të organizatave dhe agjencive ndërkombëtare, si dhe donatorët që mbështesin reformën territoriale (*referuar procesverbalit të datës 9.5.2014*); - Seancë dëgjimore pasdite me përfaqësues të institucioneve të pavarura: KLSH-në, Avokatin e Popullit dhe ILDKPKI-në (*referuar procesverbalit të datës 9.5.2014*); - Seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në fushën e biznesit (*referuar procesverbalit të datës 12.5.2014*); - Seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe me ekspertë ndërkombëtarë (*referuar procesverbalit të datës 13.5.2014*); - Prezantimi i ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, zotit Bledi Çuçi, lidhur me variantet e ndarjes së re administrative-territoriale të Shqipërisë (*referuar procesverbalit të datës 16.5.2014*); - Miratimi i variantit përfundimtar të ndarjes administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë (*referuar procesverbalit të datës 22.5.2014*); - Shqyrtimi i mendimeve të NJQV-ve dhe të këshillave të qarqeve në lidhje me propozimet për ndarjen e re administrativo-territoriale (*referuar procesverbalit të datës 10.7.2014*); - Shqyrtimi i përgjigjeve zyrtare të kryetarëve të bashkive, komunave dhe këshillave të bashkive dhe komunave, sipas qarqeve për propozimin për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë (*referuar procesverbalit të datës 15.7.2014*); - Shqyrtimi i përgjigjeve zyrtare të kryetarëve të bashkive, komunave dhe këshillave të bashkive e komunave, sipas qarqeve për propozimin për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë (*referuar procesverbalit të datës 17.7.2014*). Me vendimin nr. 5, datë 17.7.2014, Komisioni miratoi variantin përfundimtar të hartës për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë, që do të ishte pjesë përbërëse e projektligjit “Për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”. Me vendimin nr. 6, datë 23.7.2014 “Për miratimin e nismës ligjore për depozitimin e projektligjit “Për ndarjen administrativo-territoriale të njëjësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Posaçëm Parlamentar e miratoi nismën ligjore për depozitim në Kuvend të projektligjit.



22. Gjykata, bazuar në kuptimin dhe qëllimin e rregullave parlamentare për organizimin dhe funksionimin e komisioneve parlamentare dhe fakteve të paraqitura më lart, vlerëson se Komisioni i Posaçëm i krijuar për ndarjen e re administrativo-territoriale, përveç propozimit të nismës ligjvënëse, ka përmbushur edhe funksionin e shqyrtimit të projektaktit, i cili sipas rregullit të zakonshëm, përpara se të kalonte në seancë, duhej të shqyrtohej në komisionin e përhershëm përkatës. Grupet parlamentare kanë pasur mundësi për të marrë pjesë në debat dhe për të bërë propozime konkrete nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në komisionin e posaçëm. Qëllimi i krijimit të komisionit të posaçëm presupozon formimin e një trupe për të bërë vlerësime më të plota, të thelluara dhe teknike për fushën që lidhet me objektin e komisionit.

23. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se projektligji për ndarjen administrative nuk ka qenë i miratuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhat 4-25 korrik 2014 dhe 25-31 korrik 2014.

24. Gjykata vëren se rregullorja përcakton rregullat mbi hartimin e programit dhe Kalendarit të punimeve të Kuvendit. Programi përmban listën e çështjeve që do të shqyrtojë Kuvendi. Në të shënohen institucioni që ka ndërmarrë nismën, data e paraqitjes, si dhe komisioni përgjegjës që ngarkohet me shqyrtimin e tij. Si komision përgjegjës, Kryetari propozon një komision të përhershëm dhe në rastet kur e sheh të nevojshme, ai propozon mbledhje të përbashkët të dy komisioneve të përhershme ose ngritjen e një komisioni të posaçëm (*neni 26/3*). Po kështu, Rregullorja sanksionon se për zbatimin e programit të punës së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit i propozon Konferencës së Kryetarëve kalendarin e punimeve të Kuvendit për një periudhë 3-javore. Kalendarin e punimeve të Kuvendit përmban në mënyrë të detajuar kohën kur Kuvendi zhvillon punimet në seancë plenare dhe në komisione. Kalendarin publikohet dhe u shpërndahet deputetëve, si dhe u vihet në dispozicion përfaqësuesve të medias. Në çdo rast, rendi i ditës duhet të jetë bërë publik të paktën 2 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e komisionit ose seancës plenare (*neni 27/5*).

25. Në vështrim të Rregullores, rregullat procedurale, të lidhura me rendin e ditës, me zhvillimin e mbledhjeve, me organizimin e

punës, me publicitetin e mbledhjeve, me seancat dëgjimore, me shqyrtimin, me kuorumin si dhe me vendimmarrjen në komisione, zbatohen edhe për komisionet e posaçme, me përjashtim të rastit kur në vendimin e krijimit të tyre përcaktohet ndryshe (*nenet 24/4 dhe 32-41*).

26. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimi i Kuvendit nr. 1, datë 23.1.2014, “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë” nuk ka pasur asnjë parashikim të ndryshëm, prandaj dhe procedura në lidhje me rendin e ditës, zhvillimin e mbledhjeve, organizimin e punës, kuorumin, vendimmarrjen dhe programin e punës së Komisionit të Posaçëm mbi Reformën Territoriale duhet të jetë e njëjtë me rregullat procedurale që aplikohen dhe zbatohen edhe nga komisionet e përhershme.

27. Nisur nga kjo premisë, Gjykata vëren se Komisioni i Posaçëm e zhvilloi mbledhjen e parë të punës në datë 28.4.2014 me rend dite: i) miratimi i *planit të punës* së Komisionit të Posaçëm dhe i listës së subjekteve për organizimin e seancave dëgjimore publike; ii) miratimi i kriterëve teknike për ndarjen e re administrativo-territoriale. Me vendimin nr. 2, datë 28.4.2014, Komisioni i Posaçëm miratoi *planin e detajuar të punës*, sipas aktiviteteve në vijim: 1. Propozimi i kriterëve teknike me institucion përgjegjës Ministrin për Çështjet Vendore; 2. Miratimi i kriterëve teknike me institucion përgjegjës komisionin; 3. Konsultime dhe dëgjesa publike me aktorët e interesit brenda periudhës 29 prill-16 maj me institucion përgjegjës komisionin; 4. Paraqitja e propozimeve për ndarjen e re administrativo-territoriale për periudhën 15 maj-19 maj me institucion përgjegjës Ministrin për Çështjet Vendore; 5. Shqyrtimi i propozimeve dhe miratimi i projektthartës për ndarjen e re administrativo-territoriale brenda periudhës 19 maj-22 maj me institucion përgjegjës komisionin; 6. Projekttharta e miratuar nga komisioni dërgohet për mendim në të gjitha bashkitë/komunat, brenda datës 23 maj-23 korrik me institucion përgjegjës Ministrin për Çështjet Vendore; 7. Procesi i konsultimit në të gjithë Shqipërinë për projektthartën e propozuar brenda periudhës 23 maj-23 korrik me institucion përgjegjës Ministrin për Çështjet



Vendore; 8. Përgatitja e paketës ligjore me ndryshimet në ligjin nr. 8652, datë 30.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” brenda datës 23 maj-23 korrik me institucion përgjegjës Ministrin për Çështjet Vendore; 9. Miratimi i projektligjit për ndarjen e re administrativo-territoriale brenda datës 31 korrik 2014 me institucion përgjegjës Kuvendin.

28. Gjykata vëren se Komisioni i Posaçëm ka pasur një plan pune 3-mujor (28.4.2014 - 31.7.2014), ku përfshihej përgatitja dhe miratimi i projektligjit për ndarjen e re administrativo-territoriale nga ky komision brenda datës 23 korrik 2014, me afat funksionimi disa herë të ndryshuar dhe të shtyrë, duke e bërë edhe përfshirjen e projektligjit në kalendarin 3-javor të punimeve jo saktësisht të parashikueshëm.

29. Në parashikimet e nenit 31/2 të Rregullores përcaktohet si përjashtim se për çështje që janë jashtë kalendarit të punimeve, Kuvendi merr vendim me jo më pak se tre të pestat e deputetëve të pranishëm për të diskutuar ose vendosur në seancë plenare për çështje që nuk janë në rendin e ditës. Propozimet për vendosje të çështjeve të tjera në rend të ditës duhet të paraqiten me shkrim nga të paktën 10 deputetë, nga një kryetar grupi parlamentar ose nga Këshilli i Ministrave vetëm para fillimit të seancës, para fillimit të diskutimit të një pike të rendit të ditës ose kur është pezulluar diskutimi.

30. Ky rregullim është ndjekur dhe në rastin konkret, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i diskutimit në seancë plenare të çështjeve të parashikuara nga kalendarin 3-javor i punimeve. Gjykata konstaton se kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, me shkresën nr. 2575/1, të datës 23.7.2014, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste ka parashtruar kërkesë për futjen në rendin e ditës të datës 31.7.2014, për shqyrtim të projektligjit për ndarjen administrativo-territoriale. Ky propozim është votuar me 3/5 e anëtarëve të Kuvendit (megjithëse Rregullorja kërkon 3/5-at e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit), duke u përfshirë në rendin e ditës të kësaj seance plenare.

31. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se vetë Rregullorja lë hapësira që në rendin e ditës të përfshihen projektligje që kërkojnë shumicë të cilësuar, me kusht që të ndiqen rregullat e parashikuara mbi subjektet që bëjnë propozimet,

fazën në të cilën bëhet ky propozim, si dhe kuorumin e nevojshëm për votimin dhe miratimin e propozimit.

32. Duke iu kthyer pretendimit se ligji është miratuar me procedurë të përshpejtuar, Gjykata vëren se rregullimi kushtetues i përcaktuar në nenin 83/3 e ndalon zbatimin e procedurës së përshpejtuar për shqyrtimin e projektligjeve të renditura në nenin 81/2, me përjashtim të ligjit për gjendjen e jashtëzakonshme, të parashikuar nga shkronja “dh” e kësaj dispozite. Neni 83, pika 2, i Kushtetutës parashikon kushtet dhe kriteret për shqyrtimin dhe miratimin e një projektligji me procedurë të përshpejtuar. Po ashtu, norma evidenton edhe subjektet që legjitimohen t’i drejtohen me kërkesë Kuvendit, të cilat janë Këshilli i Ministrave ose një e pesta e të gjithë numrit të deputetëve. Për sa i përket aspektit kohor të zbatimit të kësaj procedure, norma kushtetuese vendos kufij kohorë, duke sanksionuar se *“Kuvendi... mund të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit”*.

33. Në rastin konkret, Komisioni i Posaçëm Parlamentar, me vendimin nr. 6, datë 23.7.2014, “Për miratimin e nismës ligjore për depozitimin e projektligjit “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, e ka miratuar nismën ligjore, si nisëm e një grupi deputetësh, bazuar në nenin 81/1 të Kushtetutës, dhe e ka dorëzuar pranë Kryetarit të Kuvendit për të vijuar me procedurat parlamentare, sipas nenit 68 të Rregullores (*pika 2 e vendimit*). Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste me shkresën nr. 2575/1, të datës 23.7.2014, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste parashtrroi kërkesë për futjen në rendin e ditës të datës 31.7.2014 për shqyrtim të projektligjit për ndarjen administrativo-territoriale. Ky propozim është votuar me 3/5-at e anëtarëve të Kuvendit, duke u përfshirë në rendin e ditës të kësaj seance plenare. Projektligji është miratuar në seancën plenare të datës 31.7.2014 nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

34. Në këndvështrim të këtyre fakteve, Gjykata vlerëson se projektligji “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, me objekt ndryshimin e ndarjes administrativo-territoriale të njësive



vendore në Republikën e Shqipërisë, është propozuar nga një grup deputetësh - pjesë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Ky projektligj nuk është shoqëruar me kërkesë drejtuar Kryetarit të Kuvendit, për shqyrtim me procedurë të përsheptuar, sipas nenit 28 të Rregullores. Në seancë projektligji është miratuar me 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Afati brenda të cilit është shqyrtuar projektligji nga fillimi i procedurës së shqyrtimit nuk cenon kërkesën e nenit 83/2 të Kushtetutës. Prandaj, duke iu referuar kërkesave të nenit 81/2, shkronja “P”, në lidhje me shumicën e cilësuar, dhe nenit 83, prg. 2 dhe prg. 3 të Kushtetutës në lidhje me subjektet që iniciojnë procedurën e përsheptuar dhe afatin që duhet respektuar, nuk konstatohen elemente të cenuara të procedurës së përsheptuar në miratimin e ligjit objekt shqyrtimi.

35. Krahas vlerësimeve të mësipërme, Gjykata çmon të rëndësishme të evidentojë se kërkuesi nuk ka argumentuar se si dhe deri në çfarë mase është prekur në të drejtat e tij kushtetuese parlamentare, konkretisht gjatë procedurës së zhvilluar nga Kuvendi për futjen në rendin e ditës së shqyrtimit dhe miratimit të ligjit nr. 115/2014, jashtë kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit si dhe duke mënjeluar nga shqyrtimi dhe miratimi paraprak Komisionin e Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut. Kërkuesi nuk ka marrë pjesë në komisionin e posaçëm dhe gjatë shqyrtimit të ligjit në komision dhe në seancat plenare përkatëse.

36. Për sa më lart, Gjykata konkludon se pretendimet e kërkuetit për cenim të nenit 81/2, shkronja “P”, dhe 83/3 të Kushtetutës gjatë procedurës së miratimit të ligjit nr. 115/2014, si dhe të rregullores së Kuvendit, janë të pabazuara.

2. Për pretendimin se ligji bie ndesh me nenin 108/1 të Kushtetutës

37. Kërkuesi pretendon se ligji objekt shqyrtimi bie ndesh me nenin 108/1 të Kushtetutës, pasi suprimon njësinë e qeverisjes vendore “komunë”. Gjithashtu, ky ligj bie ndesh edhe me nenin 116 të Kushtetutës, pasi me ligj ndryshohet një koncept i parashikuar nga Kushtetuta. Subjekti i interesuar, Kuvendi parashtron se neni 108/1 i Kushtetutës e parashikon “komunën” si njësi vendore

alternative me “bashkinë”. Në këtë kuptim nuk kemi të bëjmë me cenim të nenit 116 të Kushtetutës. Të njëjtin argument ka paraqitur dhe Këshilli i Ministrave.

38. Gjykata fillimisht e çmon me vend të ndalet në ndryshimet që sjell ligji objekt shqyrtimi. Ndarja administrativo-territoriale, para hyrjes në fuqi të ligjit objekt shqyrtimi (me 12 qarqe, 65 bashki dhe 308 komuna), është miratuar me ligjin nr. 8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj, së bashku me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë” ishte e pjesë e paketës ligjore të reformës së decentralizimit që u miratua në vitin 2000. Kjo reformë u bazua në konceptin e decentralizimit simetrik të funksioneve dhe kompetencave, pra duke mos bërë dallim në madhësinë e njërive të qeverisjes vendore apo kapacitetet e tyre për kryer këto funksione. Kalimi drejt modelit të qeverisjes nëpërmjet decentralizimit pas vitit 1992 dhe reformës administrative dhe fiskale që u miratua me ligjin organik të qeverisjes vendore në vitin 2000, u shoqërua me një ndryshim në strukturën e organizimit administrativo-territorial të vendit.

39. Gjatë seancës gjyqësore të zhvilluar para kësaj Gjykate, subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtoi se arsyet kryesore që nxitën shumicën qeverisëse të ndërmarrë një reformë tërësore për sa i takon organizimit administrativ të territorit të vendit, ishin kryesisht këto: ndryshimet demografike të dekadës së fundit sollën ndryshime drastike në madhësinë e njërive të qeverisjes vendore (më poshtë: NJQV-ja); niveli i lartë i fragmentimit të NJQV-ve ka penguar thellimin e mëtejshëm të decentralizimit, si rezultat i mungesës së kapaciteteve dhe i pamundësisë për të ofruar shërbime me eficiencë të lartë. Kjo ka sjellë, gjithashtu, edhe mosrealizimin e decentralizimit duke krijuar një sërë pabarazish të ndjeshme mes NJQV-ve; rritja e shpenzimeve administrative në nivel vendor dhe tendenca e një pjese të konsiderueshme të NJQV-ve për të pasur buxhet të dominuar vetëm nga shpenzimet e personelit. Një numër i madh njësisish vendore nuk arrinin të mbledhnin asnjë të



ardhur të vetën, duke mos qenë në gjendje të ofronin shërbime për banorët e tyre.

40. Këto mangësi sollën si rrjedhojë mospasjen sukses të procesit të demokratizimit në thuajse të gjitha nivelet e qeverisjes vendore, i cili ishte objektivi kryesor i ndarjes territoriale të vitit 2000. Kjo solli, gjithashtu, si pasojë krijimin e pabarazive mes NJQV-ve në ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Për këtë arsye, mazhoranca qeverisëse caktoi si një nga prioritetet kryesore të programit të saj kryerjen dhe zbatimin e reformës administrativo-territoriale, me synim rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike vendore dhe fuqizimin e NJQV-ve me qëllim menaxhimin sa më të mirë të fondeve publike. Në zbatim të këtij prioriteti, qeveria caktoi ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore si institucionin përgjegjës për përgatitjen e projektligjit. Përveç kësaj, me qëllim garantimin e gjithëpërfshirjes të faktorit politik, Kuvendi, me vendimin nr. 1, datë 22.1.2014 miratoi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale.

41. Në datën 31.7.2014 Kuvendi miratoi ligjin nr. 115, “Për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, i cili përmban 6 nene, si dhe hartat e tabelat shoqëruese. *Neni 1* përcakton ndarjen administrativo-territoriale të vendit në 12 qarqe dhe 61 bashki. Ndarja administrativo-territoriale në nivelin e qarqeve mbetet e pandryshuar me 12 qarqe. Rrethi, si njësi territoriale dhe nënndarje e qarkut, është suprimuar. Niveli i parë i qeverisjes vendore është riorganizuar me 61 njësi të qeverisjes vendore, nga 373 (bashki dhe komuna) që kishte para miratimit të ligjit objekt shqyrtimi. Sipas relacionit shoqërues të ligjit, ndarja administrativo-territoriale me 61 bashki bazohet në metodologjinë e zonave funksionale, që do të thotë se janë bashkuar disa bashki dhe komunat ekzistuese, të cilat së bashku formojnë 1 zonë funksionale, nisur nga kriteret teknike të miratuara nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar. *Neni 2* u referohet qendrave të bashkive të reja, shtrirjes territoriale dhe nënndarjeve të bashkive, të cilat përcaktohen në tabelat dhe hartat që i bashkëlidhen projektligjit dhe janë pjesë përbërëse e tij. Fshatrat dhe qytetet në përbërje të bashkive dhe komunave ekzistuese mbeten edhe

me ndarjen e re administrativo-territoriale. *Neni 3* dhe *neni 4* parashikojnë se organet e zgjedhura të njësive të qeverisjes vendore ekzistuese vijojnë ushtrimin e mandatit 4-vjeçar pa ndërprerje deri në përfundimin e tij sipas legjislacionit në fuqi për zgjedhjet vendore. Në këtë aspekt, ndarja e re territoriale do t’i shtrijë efektet me zgjedhjet e reja vendore, duke mos cenuar mandatet aktuale të të zgjedhurve vendorë.

42. Pretendimi kryesor i kërkuesit është se ligji objekt shqyrtimi bie ndesh me nenet 108/1 dhe 116 të Kushtetutës, pasi ai suprimon njësinë vendore komunë të parashikuar në Kushtetutë. Sipas kërkuesit, ligji ka suprimuar një njësi vendore ekzistuese të parashikuar në nivel kushtetues, gjë e cila nuk mund të shmanget me ligj, qoftë ky i miratuar me shumicë të cilësuar.

43. Gjykata vëren se neni 108 i Kushtetutës parashikon: “*Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj...Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore.*” Neni 1 i ligjit 115/2014 objekt shqyrtimi parashikon: “*1. Njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë: Bashki – 61; Qarqe – 12*”. Ligji i ri ka lënë jashtë parashikimit “komunën” si njësi qeverisjeje vendore. Ky ligj në ndarjen e re, sipas tabelave shoqëruese të tij, i referohet kriterit të zonave funksionale, i cili parashikon ndërthurjen e zonave urbane dhe rurale në njësi të vetme administrative, duke bashkuar bashkitë (si rregull zona urbane) dhe komunat (si rregull zona rurale). 61 bashkitë e reja përfshijnë mesatarisht 5-6 bashki dhe/ose komuna ekzistuese, që do të thotë se në përbërjen e tyre do të kenë si zona urbane, ashtu edhe zona rurale.

44. Gjykata fillimisht vlerëson të ndalet në detyrimin që rrjedh nga neni 108 i Kushtetutës lidhur me nivelet e qeverisjes vendore. Sipas nenit 108/1, fjalia e parë, garantohet qeverisja vendore me dy nivele: niveli i parë është komuna ose bashkia dhe niveli i dytë është qarku. Ndërsa referuar fjalisë së dytë të nenit 108/1 të Kushtetutës, Gjykata çmon se mundësia e pasjes së njësive të tjera vendore, përveç atyre të parashikuar në Kushtetutë (komunat/bashkitë-/qarqet), është e hapur. Ajo që paraqet rëndësi në aspektin kushtetues është fakti nëse



organizimi i qeverisjes vendore me një, dy ose më shumë njësi vendore mbetet efikas apo dëmtohet. Ligjvënësi, para ndërmarrjes së çdo reforme për pakësimin apo shtimin e numrit të NJQV-ve, duhet t'i përgjigjet pyetjes nëse një gjë e tillë sjell pasoja negative për qeverisjen vendore dhe rrjedhimisht për komunitetin. Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, ligjvënësi duhet të vlerësojë të gjitha kriteret kushtetuese dhe ligjore të nevojshme për t'u respektuar kur ndërmerret një reformë territoriale tërësore. Nëse rezulton se komunitetit nuk i ka ardhur ndonjë pasojë negative konkrete nga reforma, atëherë nuk kemi të bëjmë me një pretendim të natyrës kushtetuese, por me çështje të oportunitetit të ligjvënësit, gjë e cila nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë. Reformat ligjore janë pjesë e programeve qeveritare dhe si të tilla duhet të vlerësohen edhe në aspektin e oportunitetit të ligjvënësit, për aq kohë sa nuk bien ndesh me parime kushtetuese.

45. Meqë Kushtetuta nuk parashikon ndalim të shprehur ose të nënkuptuar lidhur me numrin e NJQV-ve që mund të ketë në vend, Gjykata e sheh me vend të ndalet më tej, të çështja nëse *komuna* është koncept i mbrojtur nga Kushtetuta. Për këtë qëllim, Gjykata do t'u drejtohet metodave të interpretimit teleologjik dhe gramatikor. Referuar këtyre metodave, Gjykata thekson se qëllimi i kushtetutbërësit në hartimin e gjithë pjesës së gjashtë të Kushtetutës, ka qenë organizimi i qeverisjes vendore sipas parimeve të caktuara. Një nga parimet e organizimit të pushtetit vendor është edhe krijimi i njërive bazë të qeverisjes vendore, të cilat janë thelbësore për realizimin e qeverisjes vendore. Këto njësi bazë janë mjaft të rëndësishme, pasi mbajnë peshën kryesore të realizimit të funksioneve të tyre brenda juridiksionit të tyre. Pa njësinë bazë nuk është i mundur realizimi i vetëqeverisjes lokale, si formë e qeverisjes demokratike. Është kjo arsyeja që ato parashikohen në Kushtetutë dhe kjo e fundit autorizon ligjvënësin që të krijojë me ligj, nëse e sheh të arsyeshme, edhe njësi të tjera (neni 108/1, fjalia e dytë). Pra, si komuna, ashtu edhe bashkia njihen si NJQV-të bazë.

46. Para Gjykatës shtrohet çështja a ka qenë qëllimi i kushtetutbërësit që këto njësi bazë (komuna/bashki) të jenë njëkohësisht prezente. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, Gjykatës nuk i

vjen në ndihmë metoda e interpretimit historik, pasi periudha së cilës mund t'i referohet nuk është aq e gjatë sa të justifikojë një qëndrim të konsoliduar. Për këtë arsye, i referohemi interpretimit gramatikor. Duke iu referuar shprehjes së përdorur në nenin 108/1, njësitë e qeverisjes vendore janë *komunat ose bashkitë* dhe më tej në nenin 108/3 *komunat dhe bashkitë* janë njësitë bazë të qeverisjes vendore, vihet re se ka në dukje një mospërputhje gramatikore në përdorimin e lidhëzës “ose” apo “dhe” midis fjalëve “komuna” e “bashki”. Më tej, në nenin 109 e gjejmë përsëri të shprehur lidhëzën “ose” midis organeve ekzekutive të *komunës ose bashkisë*, apo të *këshillave të komunës ose bashkisë*.

47. Gjykata çmon se qëllimi i ligjvënësit kushtetues ka qenë dhënia e konceptit të njësisë bazë të qeverisjes vendore, e cila mund të jetë *komunë ose bashki*. Secila prej këtyre njërive synon realizimin e funksioneve të veta bashkë me organet përkatëse ekzekutive ose përfaqësuese, *kryetar komune ose kryetar bashkie, këshill komune ose këshill bashkiak*. Pra, Kushtetuta ka parashikuar njësinë bazë dhe organet e saj, sipas rastit, nëse do të jetë komunë ose bashki. Gjykata konstaton se në asnjë prej dispozitave që i dedikohet qeverisjes vendore nuk bëhet dallimi midis dy njërive bazë, pra nuk rezulton që komuna ose bashkia të kenë kompetenca të veçanta. Përdërisa Kushtetuta nuk ka bërë dallim midis komunave dhe bashkive për sa i takon mënyrës së krijimit të tyre, funksioneve që ato kanë apo mënyrës së mbarimit të këtyre organeve, atëherë kushtetutbërësi nuk ka pasur si qëllim domosdoshmërisht ekzistencën e njëhershme të tyre. Në të kundërt, ai do t'i kishte parashikuar ato me kompetenca të veçanta, madje edhe me procedura të veçanta emërimi/zgjedhje ose shkarkimi/mbarimi. Kështu, nenet 108/4 dhe 109 parashikojnë se organet përfaqësuese të komunave ose bashkive zgjidhen me anë të zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Neni 115/1 parashikon se organet e qeverisjes vendore mund të shkarkohen ose shpërndahen me vendim të Këshillit të Ministrave. Neni 108/3 parashikon se komunat ose bashkitë kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse, pa bërë dallim mes tyre. Neni 111 parashikon se njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë dhe kanë buxhet të pavarur, pa bërë dallime mes tyre.



48. Gjykata, duke u nisur nga parashikimi i dispozitave konkrete kushtetuese që parashikojnë NJQV-ve, çmon se midis komunës dhe bashkisë nuk rezulton të ketë dallim të nivelit kushtetues, në mënyrë që të justifikohet domosdoshmërisht ekzistenca e tyre e njëkohshme si njësi të qeverisjes vendore. Fakti që me ligjin 8652/2000 është bërë dallimi që zonat rurale të grupohen në komuna dhe ato urbane në bashki, nuk është argument kushtetues, pasi është çështje e vlerësimit të ligjvënësit të zakonshëm, i cili në kohë të ndryshme mund të formojë një vullnet të ndryshëm të shprehur në ligj. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se mosparashikimi në ligjin objekt shqyrtimi të komunave nuk cenon nenin 108/1 si dhe rrjedhimisht, as nenin 116 të Kushtetutës.

49. Gjithashtu, Gjykata konstaton se edhe argumenti i kërkuarit që mosparashikimi i komunave si njësi bazë vendore cenon parimin e sigurisë juridike, është i pabazuar, pasi ekzistenca e komunave/bashkive nuk është e garantuar për të ruajtur vetë njësitë si të tilla, por për të realizuar qeverisjen vendore në tërësi. Kërkuari nuk arriti të sjellë argumente të nivelit kushtetues se përse modeli i zgjedhur nga ligjvënësi nuk e realizon qëllimin për të cilin ai është parashikuar.

50. Për sa i takon pretendimit tjetër se suprimimi i komunave cenon procesin zgjedhor, pasi zonat zgjedhore janë të organizuara apo të ndara duke marrë si njësi bazë komunën, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të jetë objekt shqyrtimi prej saj, pasi kjo çështje lidhet me Kodin Zgjedhor dhe jo me ligjin objekt kërkesë. Ky i fundit ka për qëllim organizimin e pushtetit vendor dhe jo organizimin e zgjedhjeve, i cili rregullohet me ligj të posaçëm.

3. Për pretendimin se ligji bie ndesh me nenin 108/2 të Kushtetutës

51. Kërkuari pretendon se projektligji për reformën administrativo-territoriale është hartuar duke mosrespektuar parimin kushtetues të marrjes së mendimit të komunitetit që preket prej saj. Në mbështetje të pretendimit të tij, kërkuari i referohet nenit 108/2 të Kushtetutës, i cili parashikon se kufijtë e njësive të qeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që jeton në to. Sipas tij, konsultimi paraprak është i domosdoshëm, me qëllim ruajtjen e identitetit kulturor dhe

historik të njësive vendore. Kërkuari është i qëndrimit se mënyra e vetme e konsultimit për ndryshimin e kufijve administrativo-territorial është referendumi vendor, pasi, sipas tij, vetëm kjo formë konsultimi e realizon në thelb detyrimin kushtetues të sanksionuar në nenin 108/2. Ligjvënësi nuk e ka respektuar këtë kriter dhe si rrjedhojë ndarja e re territoriale është antikushtetuese.

52. Subjekti i interesuar Kuvendi argumenton se ndryshimi i kufijve të njësive të qeverisjes vendore i nënshtrohet vetëm kushtit të marrjes paraprake të mendimit të popullsisë që banon në to, por jo marrjes domosdoshmërisht të pëlqimit të saj nëpërmjet referendumit. Ky nuk është mjeti i vetëm me të cilin merret mendimi i popullsisë që preket nga reforma administrativo-territorial. Subjekti i interesuar Këshilli i Ministrave, argumenton se marrja e mendimit të popullsisë nuk mund të interpretohet ngushtë duke iu referuar vetëm referendumit, me qëllim ndryshimin e kufijve administrativo-territoriale. Kushtetuta, nëse do të kishte pasur këtë synim, do ta kishte parashikuar shprehimisht si të vetmen formë konsultimi. Format e marrjes së mendimit janë parashikuar në ligjin përkatës dhe ato rezultojnë të jenë respektuar para miratimit përfundimtar të ligjit.

53. Gjykata vëren se neni 108 i Kushtetutës parashikon:

“1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.

2. Ndarjet administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to...”

Neni 5 i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, shprehet:

“Mbrotjtja e kufijve territorialë të bashkësive vendore

Për çdo ndryshim të kufijve territorialë vendorë, bashkësive vendore përkatëse duhet t'u merret mendimi paraprakisht, po qe nevoja, me anë referendumi, aty ku e lejon ligji.”

Neni 67 i ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (më poshtë ligji nr. 8652/2000), parashikon se:



“Argumentimi dhe dokumentimi i riorganizimit nga propozuesi”

Propozimi për riorganizimin e një ose më shumë njësive të qeverisjes vendore, për çdo rast të veçantë, i paraqitet Kuvendit së bashku me këto fakte dhe argumente:

Mënyrat e marrjes së mendimeve në mbledhje të hapura, seanca këshillimi me publikun, dëgjime publike, sondazhe opinioni të certifikuara nga organe kompetente ose qëndrim i shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të besueshme...”

54. Gjykata çmon me vend të ndalet fillimisht në konceptin kushtetues “*të marrjes së mendimit nga popullsia*”, sipas nenit 108 të Kushtetutës, si kriter për kryerjen e një reforme administrativo-territoriale. Gjykata konstaton se neni 108 i Kushtetutës, i cili është i pari midis 8 neneve që përbëjnë “Pjesën e Gjashtë” të Kushtetutës kushtuar organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, mishëron disa parime. Kështu, në këtë dispozitë përcaktohen këto parime: *Njësitet bazë të qeverisjes vendore janë përcaktuar të jenë bashki ose komuna, të cilat kryejnë detyrat vetëqeverisëse; NJQV të tjera mund të përcaktohen me ligj; Ndarja administrativo-territoriale përcaktohet me ligj; Ndarja administrativo-territoriale bazohet te nevojat dhe interesat e përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike; Kufijtë e NJQV-ve nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to; Vetëqeverisja ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese dhe referendumeve vendore.*

55. Gjykata vlerëson se qëllimi i përfshirjes së këtyre parimeve në këtë dispozitë ka qenë përcaktimi i disa prej shtyllave kryesore ku duhet të mbështetet organizimi i qeverisjes vendore, të cilat në terma më të përmbledhura mund të shprehen në dy drejtime kryesore: a) *vetëqeverisja lokale nëpërmjet njësive të përcaktuara në ligj; dhe b) organizimi i pushtetit lokal mbështetur në interesa dhe tradita të zonës, si dhe duke marrë parasysh mendimin e popullsisë që banon në to.*

56. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se koncepti i marrjes së mendimit nga popullsia që banon në NJQV, në rastet kur synohet ndryshimi i kufijve pjesorë ose tërësorë është detyrim kushtetues. Detajet mbi mënyrat e realizimit të këtij detyrimi, kushtetutbërësi ia ka deleguar ligjvënësit të zakonshëm. Për këtë qëllim është miratuar edhe ligji nr. 8652/2000, i cili

parashikon mënyrat me të cilat realizohet marrja e mendimit të popullsisë. Referuar nenit 67 të këtij ligji, marrja e mendimit realizohet nëpërmjet këtyre metoda alternative: mbledhjeve të hapura; seancave të këshillimit me publikun; dëgjimeve publike; sondazheve të opinionit të certifikuara nga organe kompetente; qëndrimit të shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të besueshme.

57. Gjykata vëren se ligji nr. 8652/2000 ka bërë një zbrërthim të mënyrave me të cilat mund të merret mendimi i popullsisë që banon në njësitet vendore dhe që preken nga ndryshimi i kufijve midis NJQV-ve. Para se të ndalet te mënyrat e realizimit të marrjes së mendimit të popullsisë në çështjen në gjykim, Gjykata vlerëson të nevojshme të ndalet te rëndësia e këtij detyrimi kushtetues, duke qenë se nuk ka praktikë të mëparshme kushtetuese për këtë qëllim. Gjithashtu, duke qenë se mungon jurisprudenca e kësaj Gjykate në lidhje me konceptin e marrjes së mendimit para bërjes së një reforme territoriale administrative, Gjykata për këtë qëllim i është referuar praktikës së Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane, e cila ka elaboruar këtë koncept kushtetues si standard që duhet respektuar nga ligjvënësi.

58. Koncepti i vetëqeverisjes së pushtetit lokal është një ide relativisht moderne, i cili lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e qeverisjes në tërësi dhe me shërbimin sa më të mirë kundrejt shtetasve në veçanti. Ajo ka si kusht kryesor ekzistencën e njësive administrative me qëllim realizimin e funksioneve të veta. Këto njësi nuk duhen parë vetëm si ndarje administrative vertikale të pushtetit apo si një mënyrë e organizimit të administratës publike. Më shumë ato duhen konceptuar si shprehje të shkallëzimit të demokracisë, si një pjesë përbërëse dhe formuese e shtetit demokratik (*vendim i GJKF-së gjermane BverfGE 52, 95 (111)*). Ideja ku u mbështet si fillim koncepti i vetëqeverisjes lokale, ishte përfshirja më e madhe e qytetarëve në vendimmarrje që lidhen me interesat e tyre, duke realizuar kështu edhe demokracinë funksionale nga poshtë lart. Në funksion të këtij koncepti, vetëqeverisja nuk është një e drejtë themelore, por një parim kushtetues që përmban një garanci institucionale (*Horst Dreier, Grundgesetzkommentar – Kommentar i Ligjit Themelor Gjerman (1998) f. 523*).



Kjo garanci lidhet me ekzistencën e NJQV-ve si të tilla dhe me ushtrimin e kompetencave të tyre brenda juridiksionit që u është dhënë. Elementet e vetëqeverisjes së NJQV-ve janë të lidhura jo vetëm me ekzistencën e tyre si institucione, por edhe me kompetencat që ushtrojnë. Kështu, koncepti i vetëqeverisjes lidhet me 3 garanci:

a) *Garancia institucionale* – NJQV-ve kanë të drejtë të ekzistojnë si subjekte të së drejtës publike, të cilat krijohen dhe organizohen me ligj. Ligjvënësi ka të drejtë në këtë aspekt të respektojë autonominë gjatë krijimit të tyre, do të thotë se ligjvënësi nuk ka të drejtë t'i suprimojë të gjitha njësitë vendore në atë shkallë sa të bëjë të pamundur realizimin e qeverisjes vendore në thelb, por as edhe t'i prekë kompetencat e tyre deri në atë pikë sa t'i bëjë ato të pamundura për t'u ushtruar. Mbrojtja institucionale e organeve të qeverisjes vendore nuk është individuale, por institucionale, gjë e cila do të thotë se nga kjo garanci nuk rrjedh detyrimisht ekzistenca dhe statusi i njërive vendore të veçanta, por i të gjitha njërive vendore, si bashkësi njësishe që realizojnë vetëqeverisjen në shkallë vendi. Rrjedhimisht, ndryshimi i kufijve të NJQV-ve është i mundur, por gjatë këtij ndryshimi duhen respektuar kriteret formale dhe materiale.

b) *Garancitë objektive* – NJQV-të kanë të drejtë të ushtrojnë kompetencat e tyre të dhëna me ligj pa u penguar nga pushteti qendror. Ushtrimi i tyre lidhet si me anën formale ashtu edhe me atë materiale, me qëllim realizimin e funksioneve të tyre brenda konceptit të vetëqeverisjes. Ligjvënësi në çdo rast ka detyrimin të respektojë autonominë e NJQV-ve me qëllim mospengimin e tyre në realizimin e funksionit për të cilin ato janë krijuar.

c) *Garancitë subjektive* – NJQV-të kanë të drejtë të përdorin mjete juridike të krijuara, me qëllim mbrojtjen e tyre nga ndërhyrjet e pajustificuara të ligjvënësit, kur ato kanë bindjen se autonomia e tyre është cenuar në thelb. Pretendimet e NJQV-ve mund të lidhen me: konsultimin e tyre nga qeveria/ligjvënësi për ndërmarrjen e reformave të çdo lloji që prekin edhe NJQV-të; bashkëpunimin gjatë proceseve të planifikimit urban, etj. Procesi i konsultimit, p.sh mund të realizohet nëpërmjet dëgjimit, këshillimit apo bashkëpunimit nga ana e NJQV-ve deri në procesin vendimmarrës (*Horst Dreier,*

Grundgesetzkommentar (Komentar i Ligjit Themelor Gjerman) f. 530).

59. Gjykata thekson se parimi i vetëqeverisjes, i përbërë nga këto tri elemente nuk e ndalon ndryshimin e kufijve të çdo njësie, pasi garancia kushtetuese që rrjedh nga neni 108/1 lidhet me ekzistencën e njërive (komunës/bashkisë) nga pikëpamja institucionale dhe jo nga pikëpamja individuale. Për këtë arsye, në parim, shkrirja e komunave, bashkimi i tyre, ngjitja e tyre në një njësi tjetër ose çdo formë tjetër e ndryshimit të kufijve lokalë nuk prek thelbin e vetëqeverisjes lokale si garanci kushtetuese. Megjithatë çdo ndryshim që prek kufijtë e njërive vendore duhet të ketë si pikënisje interesin publik dhe të jetë i bazuar edhe mbi mendimin e komunitetit të prekur nga ndryshimet (*vendim i GJFK-së gjermane: BverfGE 86, 90, 12 maj 1992).*

60. Gjykata e sheh me vend të nënvizojë se detyrimi për të dëgjuar NJQV-ve që preken nga ndryshimi i kufijve të tyre (nëpërmjet ndarjes së re apo çdo lloj riorganizimi), nënkupton që njësitë të marrin dijeni/informacion për rregullimin e ri. Informacioni duhet të përfshijë përmbajtjen substanciale të riorganizimit, si dhe arsyet përkatëse që çuan në këtë rregullim të ri. Thelbi i parimit të vetëqeverisjes, sipas nenit 108/1 të Kushtetutës, është që NJQV-ja, në realizimin konkret të kompetencave të tyre të dhëna nga Kushtetuta, t'u jepet mundësia që të mbajnë qëndrim lidhur me reformën territoriale apo çdo rregullim tjetër që do të sillte si pasojë, veç të tjerash, edhe ndryshimin e kufijve midis njërive. Qëllimi i mundësisë për t'u dëgjuar është që NJQV-të të mos kthehen në objekt të veprimtarisë së pushtetit qendror, por të jenë pjesëmarrëse në reformë.

61. Gjykata thekson se vendimmarrja e ligjvënësit në lidhje me një ndarje të re administrativo-territoriale të vendit është e nevojshme t'i nënshtrohet testit të proporcionalitetit, i cili duhet të peshojë interesa të ndryshëm të të gjitha subjekteve që preken nga reforma. Ky test nuk mund të japë rezultate të sakta pa pjesëmarrjen e të gjitha subjekteve. Nëpërmjet këtij testi, ligjvënësi mbledh informacion mbi të gjitha çështjet e ndjeshme që përfshihen në një reformë të mundshme. Për këtë arsye, e drejta e komunitetit për t'u dëgjuar para ndërhyrjes së ligjvënësit në kufijtë



territoriale të hapësirës administrative ku ai jeton, është jo vetëm përmbajtja materiale e garancisë objektive të vetëqeverisjes lokale, por edhe element i shtetit të së drejtës, i cili ka për synim funksionimin siç duhet të të gjithë pushtetit shtetëror. Procesi i dëgjimit të NJQV-ve që preken nga reforma nuk është i detyrueshëm të jetë i detajuar, mjafton marrja e mendimit për thelbin e reformës dhe argumentet ku ajo mbështetet (*vendim i GJK-së gjermane: BverfGE 50, 195, 17 janar 1979*). Megjithatë, Gjykata çmon se pavarësisht detajeve, procesi i dëgjimit duhet të përfshijë si kusht minimal pjesëmarrjen formale të banorëve të NJQV-ve që preken nga reforma në një proces diskutimi, ku jo vetëm të paraqitet varianti përfundimtar që do të miratohet, por ai të jetë i hapur për ndryshime të mundshme, sipas sugjerimeve të komunitetit, aty ku ka (*vendim i GJK-së të Landit të Brandenburgut: VfGBbg 95/03, 18 dhjetor 2003*).

62. Gjykata vlerëson se detyrimet e vendosura nga Kushtetuta dhe nga Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore specifikohen në detaje nga ligji nr. 8652/2000. Ky ligj, përveç mënyrave të marrjes së mendimit, parashikon edhe kategorinë e subjekteve, të cilat duhet të shprehen dhe konsultohen mbi ndarjen administrativo-territoriale, si dhe mënyrat dhe mjetet se si duhet t'u merret mendimi këtyre subjekteve. Konkretisht, neni 67 parashikon: *"Propozimi për riorganizimin e një ose më shumë njësite të qeverisjes vendore, për çdo rast të veçantë, i paraqitet Kuvendit së bashku me këto fakte dhe argumente: ...Mënyrat dhe materialet ose dokumentet e përdorura për informimin e publikut mbi riorganizimin dhe çështjet që lidhen me të; Mendimin e popullatës që banon në njësitë e qeverisjes vendore që do të riorganizohen, si dhe mendimin "pro" dhe "kundër" këtij riorganizimi, sipas çdo rasti të veçantë nga subjekte ose grupe të interesuara drejtpërdrejt ose jo-drejtpërdrejt në këtë riorganizim.; Mënyrat e marrjes së mendimeve në mbledhje të hapura, seanca këshillimi me publikun, dëgjime publike, sondazhe opinionit të certifikuara nga organe kompetente ose qëndrim i shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të besueshme."*

63. Nisur nga standardet e shprehura më lart, Gjykata konstaton se referuar edhe ligjit nr. 8652/2000, i cili parashikon si metoda alternative të marrjes së mendimit: mbledhjet e hapura, seancat e këshillimit me publikun, dëgjimet

publike, sondazhet e opinionit të certifikuara nga organe kompetente ose qëndrimin e shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të besueshme, nuk është e domosdoshme për hartuesin e ligjit që këto metoda të konsultimit të plotësohen të gjitha njëherësh, me qëllim që ky proces të quhet i kryer. Natyrisht sa më shumë prej këtyre metodave të përdoren aq më i besueshëm dhe i qëndrueshëm është rezultati.

64. Gjithashtu, në nenin 68 sanksionohet detyrimi për të shprehur mendimin me shkrim nga organet e qeverisjes vendore brenda afatit prej 60 ditësh: *"Këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarqeve, që janë të përfshira drejtpërdrejt në riorganizim, si dhe kryetarët e tyre japin mendimin e tyre zyrtar dhe nëse ka, edhe mendimin "kundër" të një pjesë të këshilltarëve të këshillit përkatës."*

65. Nisur nga baza ligjore, si dhe nga materialet e sjella në gjykim nga subjektet e interesuara në këtë gjykim, Gjykata konstaton se janë ndjekur këto metoda, me qëllim kryerjen e procesit të konsultimit publik lidhur me reformën e re territoriale-administrative:

- Informimi i publikut mbi ecurinë e reformës administrativo-territoriale është kryer duke përdorur disa instrumente, si p.sh: takimet dhe mbledhjet e hapura, seancat e këshillimit publik, dëgjimet publike, sondazhin kombëtar, si dhe mediat vizive dhe të shkruara. Konsultimi publik, ashtu siç përcaktohet nga ligji 8652/2000, është zhvilluar në disa faza të reformës me 3 grupe kryesore:

Grupi i parë përbëhej nga përfaqësues të qeverisjes vendore dhe të shoqatave të të zgjedhurve vendorë. Gjatë gjithë fazës së parë të reformës, informimi dhe konsultimet janë zhvilluar nëpërmjet takimeve të punës, seminareve, konferencave dhe dërgimit të informacioneve me shkrim. Në muajin mars-prill 2014 u zhvillua raundi i parë i konsultimit publik, ku ka pasur mbledhje publike me përfaqësues të qeverisjes vendore në të gjitha qarqet e vendit për të informuar mbi procesin e reformës dhe për konsultimin e kriterëve teknike. Në periudhën 28 prill 2014 deri në 16 maj 2014, Komisioni i Posaçëm Parlamentar zhvilloi disa seanca dëgjimesh publike, ku u dëgjuan përfaqësues të qeverisjes vendore dhe shoqatave të tyre. Mendimet e organeve të qeverisjes



vendore mbi variantin 39/47, të miratuar nga Komisioni në datën 22 maj 2014, u kërkuar në mënyrë zyrtare, bazuar në nenin 68 të ligjit organik 8652/2000, në datën 23 maj 2014. Sipas këtij neni, organet e njësisë të qeverisjes vendore duhet të shprehen me shkrim brenda 60 ditëve. Ky afat skadoi në datën 22 korrik 2014.

Grupi i dytë përbëhej nga grupet e interesit, shoqëria civile dhe përfaqësues të biznesit lokal, për konsultimin e të cilëve, gjatë gjithë procesit të prezantimit të reformës administrativo-territoriale, gjatë periudhës maj-qershor 2014 janë zhvilluar 37 takime në qendrat e rrethit me grupet e interesit dhe shoqërinë civile, si dhe 5 takime e një anketim kombëtar me biznesin.

Grupi i tretë përbëhej nga banorët e zonave që preken nga reforma, për konsultimin e të cilëve është përdorur instrumenti i sondazhit kombëtar të opinionit, bazuar në nenin 67 të ligjit organik të qeverisjes vendore nr. 8652/2000. Në sondazhin e kryer nga një organizatë shqiptare e përzgjedhur nga PNUD-i me financimin e projektit STAR, kanë marrë pjesë 16000 të intervistuar. Rezultatet e sondazhit kombëtar raportojnë për një mbështetje të reformës administrativo-territoriale nga mbi 50% e të anketuarve. Pyetjeve për propozimin konkret të ndarjes së territorit në 39/47 NJQV, shumica e të anketuarve u përgjigj në favor të variantit të ndarjes së vendit në 39 zona funksionale.

66. Gjithashtu, në zbatim të nenit 68, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 8652/2000, organet e njësisë të qeverisjes vendore kanë të drejtë të japin mendimin e tyre zyrtar me shkrim mbi propozimin për riorganizimin administrativo-territorial brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës. Në funksion të këtij procesi, Komisioni i Posaçëm Parlamentar, pas miratimit më datë 22.5.2014, të variantit të ndarjes administrativo-territoriale me 39/47 njësi të qeverisjes vendore, ngarkoi ministrin e Çështjeve Vendore për të kërkuar mendimin zyrtar mbi këtë variant nga të gjithë kryetarët e bashkive dhe komunave si dhe nga këshillat e bashkive dhe të komunave. Ministri për Çështjet Vendore, me shkresën përcjellëse nr. 2068, datë 23.5.2014, i dërgoi propozimin konkret të riorganizimit për secilën njësi të qeverisjes vendore sipas variantit 39/47, të gjithë kryetarëve të bashkive dhe këshillave të bashkive, si dhe kryetarëve të komunave dhe këshillave të komunave, në total 746 organeve vendore të nivelit të parë

bashki/komunë. Deri në datën 22.7.2014, nga totali prej 373 bashkish dhe komunash, kishin kthyer përgjigje 286 NJQV-ve ose 76% e numrit të përgjithshëm të bashkive dhe komunave në vend, në emër të të cilave janë shprehur ose kryetari i njësisë vendore, ose këshilli, ose të dyja organet së bashku. Gjithsej janë 393 përgjigje zyrtare të sjella nga 263 kryetarë bashkish dhe komunash, si dhe nga 130 këshilla të bashkive dhe komunave. Pra, gjithsej kanë shprehur mendimin zyrtar 52,5% e totalit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të bashkive dhe komunave në vend. Nga shqyrtimi në detaje i përgjigjeve të ardhura dhe pas marrjes në konsideratë nga ana e komisionit të mendimeve të ardhura, rezulton se: 160 kryetarë të bashkive dhe komunave, si dhe këshilla të bashkive dhe të komunave kanë kthyer përgjigje pozitive (PRO) ndaj variantit të propozuar 39/47; 56 kryetarë të bashkive dhe komunave, si dhe këshilla të bashkive dhe të komunave janë shprehur për një ndarje tjetër nga varianti i propozuar 39/47, duke dhënë propozime konkrete për riorganizimin e njësisë të tyre vendore. Komisioni, pas vlerësimit të këtyre propozimeve dhe argumenteve, vendosi t'i pranojë këto propozime dhe mbi bazën e tyre të miratojë variantin me 61 bashki; 41 kryetarë të bashkive dhe komunave si dhe këshilla të bashkive dhe të komunave janë shprehur për një ndarje tjetër nga varianti i propozuar 39/47, duke mbështetur në parim reformën administrativo-territoriale në variantin me mbi 60 njësi vendore; 58 kryetarë të bashkive dhe komunave, si dhe këshilla të bashkive dhe të komunave janë shprehur kundër variantit të propozuar, duke dhënë argumentet përkatëse në mbështetje të kundërshtimit të tyre; 78 kryetarë të bashkive dhe komunave, si dhe këshilla të bashkive dhe të komunave janë shprehur kundër variantit të propozuar 39/47, duke mos dhënë asnjë lloj argumenti.

67. Nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se procesi i marrjes së mendimit është realizuar nëpërmjet përdorimit të pjesës më të madhe të metodave të parashikuara nga ligji nr. 8652/2000. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kriteri kushtetues i marrjes së mendimit, sipas nenit 108/2 të Kushtetutës, nuk është cenuar.

4. Për cenim të parimit kushtetues të barazisë së votës



68. Kërkuesi pretendon se ligji nr. 115/2014 cenon parimin kushtetues të barazisë së votës, pasi Censusi 2011 përbën një bazë të paligjshme dhe të deformuar për përllogaritjen e popullsisë në vitin 2014, në funksion të kërkesave kushtetuese për rishikim të kufijve territoriale të njësive vetëqeverisëse dhe sigurimit të përfaqësimit të barabartë të popullsisë. Për shkak të deformimeve të rënda në kriterin demografik, njësitë e ndryshme kanë madhësi territoriale të pakrahasueshme me njëra – tjetrën. Kjo lloj pabarazie si demografike edhe territoriale nuk respekton parimin e barazisë së përfaqësimit, pra të votës.

69. Subjekti i interesuar Kuvendi prapëson se pretendimet për cenimin e parimit të barazisë së votës janë të pambështetura, pasi për zhvillimin e zgjedhjeve vendore të ardhshme dhe numrin e zgjedhësve, organet e ngarkuara nga ligji zgjedhor do t'i referohen Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile dhe jo Censurit të vitit 2011. Ndërsa subjekti tjetër i interesuar, Këshilli i Ministrave, argumenton se pretendimet e kërkuesit bazohen mbi rezultatin e zgjedhjeve të mëparshme, prirjet e elektoratit dhe historikun e rezultatit ndër vite, si dhe formulën e përcaktimit të mandateve vendore, këshilltar bashkiak/banorë, që pritet të ndryshohet.

70. Neni 45 i Kushtetutës parashikon se e drejta e zgjedhjes është një ndër të drejtat kushtetuese të shtetasve që luan një rol kryesor në procesin zgjedhor. Kjo e drejtë garanton barazinë dhe fshehtësinë e votës së shtetasve gjatë procesit zgjedhor. Koncepti i votës së barabartë u jep të drejtë zgjedhësve, sa të jetë e mundur, të ndikojnë në mënyrë të njëjlojtë dhe me të njëjtën peshë në rezultatin e zgjedhjeve (vendimi nr. 1, datë 7.1.2005 i Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka theksuar se nisur edhe nga lloji i sistemit zgjedhor, barazia e peshës së çdo vote nuk nënkupton barazinë e saktë matematike të kontributit të çdo vote në rezultatin final të zgjedhjeve. Pësia e çdo vote është e lidhur me mekanizmat e sistemit zgjedhor dhe është e pashmangshme ekzistenca e dallimeve në influencën që mund të ketë çdo votë në varësi nga mekanizmat e adoptuar (vendimi nr. 1, datë 7.1.2005 i Gjykatës Kushtetuese). Sipas saj, “koncepti kushtetues ‘numër i përafërt zgjedhësish’ nuk është i njëjlojtë dhe as nuk mund të konfondohet me numrin e

barabartë të zgjedhësve, pasi një koncept i tillë do të ishte i pakuptimtë për t’u përdorur në ndarjen e zonave zgjedhore, por edhe i pamundur njëkohësisht. Koncepti ‘numër i përafërt zgjedhësish’ sigurisht që e përmban në vetvete kriterin numerik, por nuk mund të konkludohet se ai është i vetmi kriter që shërben për përcaktimin e zonave zgjedhore” (vendimi nr. 40, datë 17.5.2001 i Gjykatës Kushtetuese).

71. Gjykata, gjithashtu, i ka dhënë rëndësi edhe ndarjes territoriale në funksion të barazisë së votës, duke u shprehur se “... Ndarja e zonave zgjedhore nuk duhet konceptuar si një ndarje e thjeshtë e natyrës tekniko-administrative. Ajo përbën një proces me rëndësi kushtetuese dhe është pjesë integrale e parimit të barazisë së votës” (vendimi nr. 1, datë 7.1.2005 i Gjykatës Kushtetuese).

72. Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore, duke përmbledhur standardet evropiane për zgjedhje demokratike, përcakton edhe aspektet e ndryshme të barazisë së votës, që duhet kuptuar, si: i) *E drejtë votimi e barabartë*: çdo votues ka në parim një votë; nëse sistemi zgjedhor i jep zgjedhësve më shumë se një votë, çdo zgjedhës ka të njëjtin numër votash (prg. 2.1); ii) *Peshë votimi e barabartë*: mandatet duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë nëpër zona zgjedhore (prg. 2.2); iii) *Barazia e mundësive* (prg. 2.3). Ky Kod thekson se fuqia e barabartë e votës konsiston në shpërndarjen e qartë dhe të balancuar të mandateve midis zonave zgjedhore mbi bazën e një prej kriterëve të mëposhtme të ndarjes së mandateve: popullsia, numri i banorëve lokalë (duke përfshirë minorenët), numri i zgjedhësve të regjistruar dhe mundësisht numri i njerëzve që faktikisht votojnë. (Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore; Udhëzime dhe raporti shpjegues - miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij të 51-të dhe të 52-të).

73. Gjykata konstaton se Kodi Zgjedhor (miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), në lidhje me zgjedhjen e përfaqësuesve për Kuvendin, në nenin 74 përcakton: “1. Zona zgjedhore përputhet me territorin e qarkut dhe shërben si njësi zgjedhore për zgjedhjen e një numri të caktuar mandatesh, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod. 2. Kufijtë administrativë të qarqeve vendosen me ligjin për ndarjen administrative e territoriale të Republikës së Shqipërisë.” Ndërsa ligji nr. 115/2014 për ndarjen territoriale të nivelit të dytë, parashikon ndarjen në 12 qarqe, ashtu siç ka qenë edhe me ligjin nr. 8652/2000.



74. Gjykata vlerëson se për zgjedhjet e përgjithshme të Kuvendit “zona zgjedhore” përputhet me territorin e qarkut dhe në këtë kuptim ligji nr. 115/2014, nuk sjell efekte në zgjedhjet e përgjithshme dhe rezultatin e tyre, bazuar mbi argumentin e ndarjes së re territoriale – administrative, pasi zona zgjedhore mbetet e njëjtë në kuptimin territorial. Duke qenë se kërkuesi pretendimet i ka të orientuara drejt zgjedhjeve vendore dhe pasojave që mund të sjellë kjo ndarje e re administrativo-territoriale në cenimin e barazisë së votës për këshillat bashkiakë dhe kryetarët e bashkive, Gjykata e shih me vend të ndalet edhe në këtë pretendim.

75. Konkretisht, parashikimet ligjore të Kodit Zgjedhor në lidhje me përfaqësuesit vendorë sanksionojnë mënyrën e zgjedhjes së kryetarëve të komunave dhe bashkive për sa vijon: Kryetarët e bashkive ose të komunave, si dhe këshillat e bashkive ose komunave zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë nga zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë ose të komunës (*neni 165/1*). 1. Kryetar bashkie ose komune zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse. 2. Në rastin kur dy ose më shumë kandidatë marrin numër të barabartë votash, atëherë ndërmjet tyre hidhet short. Shorti organizohet nga KQZ-ja në një seancë publike, me pjesëmarrjen edhe të kandidatëve. KQZ-ja përcakton rregullat e organizimit të shortit (*neni 166, prg. 1 dhe prg. 2*). Ndërsa për sa u përket anëtarëve të këshillave të bashkive dhe të komunave, sipas Kodit ata zgjidhen në bazë të listave shumemërore të paraqitura nga partitë politike, koalicionet, ose kandidaturat e propozuara nga zgjedhësit (*neni 165/2*). Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KQZ-ja në bazë të sistemit proporcional, sipas të njëjtave procedurave të parashikuara në nenet 162 dhe 163 të këtij Kodi (*neni 166/3*).

76. Ndërkohë që sipas ligjit nr. 8652/2000, këshilli komunal dhe ai bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë (*neni 23*). Ndërsa numri i anëtarëve të këshillit komunal dhe atij bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë: komunat dhe bashkitë deri në 5000 banorë, 13 anëtarë; 5000-10000 banorë, 15 anëtarë; komunat me 10000-20000

banorë, 17 anëtarë; komunat me 20000-50000 banorë, 25 anëtarë; komunat me 50000-100000 banorë, 35 anëtarë; komunat me 100000-200000 banorë, 45 anëtarë, ndërsa Bashkia e Tiranës ka 55 anëtarë. Në zbatim të këtij neni, prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo komunë e bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet (*neni 24*).

77. Për sa i takon këtij pretendimi, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente kushtetuese që të mbështesin pretendimin e tij se ndarja e re territoriale administrative sjell cenim të barazisë së votës së shtetasve.

78. Kërkuesi pretendon, gjithashtu, se ndarja e re territoriale paracakton rezultatin për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive. Konkretisht, sipas tij, territori i Bashkisë së re të Tiranës është shtrirë duke përmbledhur sa më shumë njësi të favorshme për mazhorancën në pushtet, përfshirë ish-komunën e Shëngjergjit pas malit të Dajtit, me qëllim që të sigurohet një rezultat i qëndrueshëm zgjedhor në favor të mazhorancës parlamentare. Sipas tij, kësaj bashkie i është bashkuar edhe ish-komuna e Zall-Herit, që nuk ka lidhje tokësore të drejtpërdrejtë me bashkinë aktuale të Tiranës. Një gjë e tillë të çon në përfundimin se bashkimi i njërive vendore është bërë në funksion të një rezultati më të favorshëm zgjedhor për shumicën qeverisëse.

79. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata çmon se kërkuesi bazohet në argumente hipotetike, duke u nisur nga premisa të karakterit politik, si rezultatet e zgjedhjeve të mëparshme dhe prirjet e elektoratit përkatës. Gjykata vlerëson se argumentet e parashtruara nga kërkuesi nuk ishin të nivelit kushtetues dhe për këtë arsye ajo nuk mund t’u japë atyre një përgjigje përfundimtare.

80. Në përfundim, bazuar në sa më lart, Gjykata çmon se kërkesa për shfuqizimin e ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a, 132 dhe



134/1/c, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur në Tiranë, më 15.4.2015

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Gani Dizdari

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen e kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 115, datë 31.7.2014, “Për ndarjen administrative të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, shumica ka vendosur rrëzimin e kërkesës së 1/5-s së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

2. Kërkuesi pretendon se procedura e miratimit të ligjit është në kundërshtim me nenet 81/2, shkronja ”P”, 83/3 dhe 75/2 të Kushtetutës, si dhe me Rregulloren e Kuvendit; se reforma territoriale suprimon njësinë vendore *komunë*, çka bie ndesh me nenin 108/1 të Kushtetutës, i cili parashikon komunën dhe bashkinë si njësi të qeverisjes vendore, si dhe me nenin 116 të Kushtetutës, pasi me ligj ndryshohet një koncept i parashikuar nga Kushtetuta; se ligji është realizuar në cenim të parimit kushtetues të marrjes së mendimit të popullsisë që banon në njësitë e qeverisjes vendore, të sanksionuar në nenin 108/2 të Kushtetutës; se cenohet parimi i barazisë së votës, pasi ligji nr. 115/2014 deformon votën e zgjedhësve.

3. Parimet e funksionimit të qeverisjes vendore garantohen nga neni 13 i Kushtetutës dhe, për rëndësinë që ajo paraqet, është pjesë e vlerave themelore të mbrojtura nga Kushtetuta. Konkretisht, parimi i decentralizimit të pushtetit dhe i autonomisë vendore, si parime kushtetuese që qëndrojnë në themelin e dy shtyllave të qeverisjes vendore, përbëjnë thelbin e nenit 13.

Ndërsa rregullat e detajuara të kësaj qeverisjeje përcaktohen në pjesën e gjashtë të Kushtetutës (nenet 108-115).

4. Sikurse konstaton edhe shumica, neni 108 i Kushtetutës, i cili është i pari midis 8 neneve që përbëjnë “Pjesën e Gjashtë” të Kushtetutës dedikuar organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, mishëron disa parime. Kështu, në këtë dispozitë citohen këto parime: *Përcaktimi i njësisë bazë të qeverisjes vendore, të cilat kryejnë detyrat vetëqeverisëse; NJQV të tjera mund të krijohen me ligj; Ndarja administrativo-territoriale përcaktohet me ligj; Ndarja administrativo-territoriale bazohet te nevojat dhe interesat e përbashkët ekonomike dhe të traditës historike; Kufijtë e njësisë të qeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to; Vetëqeverisja ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese dhe referendumeve vendore* (shih paragrafin nr. 54 të vendimit).

5. Gjithashtu, parime të tjera të qeverisjes vendore sanksionohen në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore, e cila është bërë pjesë integrale e sistemit të brendshëm juridik shqiptar.

6. Pikërisht për rëndësinë që gëzojnë njësitë e qeverisjes vendore, Kushtetuta ka parashikuar miratimin, ndryshimin apo shfuqizimin e ligjit për ndarjen administrativo-territoriale të Republikës me shumicë të cilësuar, 3/5-at e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 81/2/f i Kushtetutës).

7. Lidhur me nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se në thelb ajo mbetet një dispozitë që synon mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, për shkak të rëndësisë së fushave që rregullojnë ligjet e cilësuar, me qëllim për t’i bërë ato sa më të qëndrueshme, për të kërkuar një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend dhe për të shmangur mundësinë që forca politike që ka shumicën, të mund të cenojë parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike (*shih vendimet nr. 25, datë 5.12.2008 dhe nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, respektimi i kriterit kushtetues “shumicë e cilësuar” është edhe në funksion të parimit të sigurisë juridike, parim që ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligjet në tërësi duhet të garantojnë qartësi, parashikueshmëri dhe kuptueshmëri për individin (*shih vendimet nr. 23, datë 8.6.2011 dhe nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).



8. Bazuar në këtë standard, ligji i kundërshtuar, edhe pse është miratuar me shumicën e cilësuar të kërkuar nga neni 82/2/f i Kushtetutës, mendojmë se respekton kriterin kushtetues vetëm nga pikëpamja formale, por nuk e respekton atë nga pikëpamja substanciale, pasi shpreh në mënyrë të njëanshme vetëm vullnetin e shumicës parlamentare dhe si i tillë nuk përfaqëson konsensusin e të gjitha forcave politike të Kuvendit. Në këtë këndvështrim, por edhe për sa do të trajtohet më poshtë, nuk jemi dakord me argumentet e shumicës për t'i rrëzuar pretendimet e kërkuesit që lidhen me cenimin e neneve 108/1, 108/2 dhe 116 të Kushtetutës, sepse ato nuk janë në koherencë me vlerat themelore që Kushtetuta mishëron dhe mbron në një shtet të së drejtës. Në këto kushte, ne gjyqtarët në pakicë po japim arsyet e këtij mendimi pakice.

Për pretendimin për cenimin e neneve 108/1 dhe 116 të Kushtetutës.

9. Kushtetuta në nenin 108/1 parashikon: “Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj”. Në vijim të këtij parashikimi neni 108/3 i Kushtetutës citon: “Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisëse, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësite të tjera të qeverisjes vendore”. Ndërsa neni 116 i Kushtetutës sanksionon piramidën e akteve normative dhe marrëdhëniet midis tyre, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së këtyre normave. Pavarësisht këtyre parashikimeve kushtetuese, ligji i kundërshtuar si njësi të qeverisjes vendore përcakton bashkitë dhe qarqet (neni 1 i ligjit), duke suprimuar komunat².

10. Shumica, edhe pse shprehet se çështjet e oportunitetit të ligjvënësit nuk janë objekt i kontrollit kushtetues (*shih paragrafin nr. 44 të vendimit*), pas një analize të detajuar të risive që sjell ligji objekt shqyrtimi (*shih paragrafët nr. 38-41 të vendimit*) ka vlerësuar si aspekt kushtetues të rëndësishëm, për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, faktin nëse organizimi i qeverisjes vendore me një, dy ose më shumë njësi vendore

mbetet efikas apo dëmtohet (*shih paragrafin nr. 44 të vendimit*). Ajo (shumica), pavarësisht se ka vlerësuar se komuna, ashtu sikurse edhe bashkia njihen si njësi bazë të qeverisjes vendore (*shih paragrafin nr. 45 të vendimit*), nëpërmjet interpretimit gramatikor të Kushtetutës, ka arritur në përfundimin se midis komunës dhe bashkisë nuk rezulton të ketë dallim të nivelit kushtetues dhe se kushtetutëbërësi nuk ka pasur si qëllim ekzistencën e njëhershme të tyre. Për këtë arsye, sipas shumicës, mosparashikimi në ligjin objekt shqyrtimi të komunave nuk cenon nenin 108/1, rrjedhimisht as nenin 116 të Kushtetutës (*shih paragrafin nr. 48 të vendimit*).

11. Gjykata në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014 dhe nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014 dhe nr. 23, datë 8.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014 dhe nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie, ku në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, dukepërfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014 dhe nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Bazuar në këto parime, Gjykata ka theksuar se për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga

² Neni 1 i ligjit 115/2014, objekt shqyrtimi parashikon: “1. Njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë: Bashki – 61; Qarqe – 12”.



përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënës të zakonshëm, atëherë, nuk është i nevojshëm referimi te kjo dispozitë, pra e zbatimit të drejtpërdrejt të saj. Nëse ndodhemi para kësaj situate, është e pritshme që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim të respektojnë hierarkinë e akteve normative (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nga sa më lart, në ndryshim nga shumica, jemi të mendimit se çfarë shtrohet për diskutim nuk është çështja e efikasitetit apo dëmtimit të organizimit të qeverisjes vendore për shkak të suprimimit të komunës. Ajo që Gjykata duhet të vlerësonte është nëse ky suprimim, çka ka sjellë parashikimin nga ligji i kundërshtuar si njësi bazë të qeverisjes vendore vetëm të bashkisë, bie ndesh me rregullimet që burojnë nga nenet 13, 108/1 dhe 116 të Kushtetutës.

15. Neni 108 i Kushtetutës ka parashikuar si njësi bazë të qeverisjes vendore komunën dhe bashkinë së bashku. Në këndvështrim tonë, edhe po t'i referohemi kriterit të interpretimit gramatikor, të përdorur edhe nga shumica, arrihet pikërisht në këtë rezultat. Edhe pse në paragrafin e parë të këtij neni kushtetutëbërësi përdor lidhëzën “ose” ndërmjet fjalëve komunë dhe bashki³, ky paragraf nuk është përcaktues në këtë drejtim, pasi ai identifikon të gjitha njësitë e qeverisjes vendore (komunë, bashki, qark) dhe jo vetëm njësitë vendore bazë. Po ashtu ai parashikon edhe mundësinë që njësi të tjera mund të krijohen me ligj. Ajo që ka rëndësi vlerësoj se është paragrafi i tretë i nenit 108, pasi është ky paragraf që parashikon në mënyrë specifike *vetëm njësitë bazë* të qeverisjes vendore, ku jo rastësisht kushtetutëbërësi përdor lidhëzën “dhe”⁴. Kjo lidhëz (“dhe”) përdoret edhe në nenin 110 të Kushtetutës, ku sanksionohet njësia e dytë e qeverisjes vendore, qarku.

16. Edhe nëse *ad absurdum* do të pranonim që interpretimi gramatikor i përdorur më lart nuk çon në këtë rezultat, vjen në ndihmë interpretimi logjik, pra nxjerrja në pah e qëllimit (*ratio*) të

kushtetutëbërësit. Në këtë drejtim, sikurse thekson dhe doktrina, duhet të merren në konsideratë, para së gjithash, punimet përgatitore të normës juridike. Në diskutimet në komisionin parlamentar të hartuesve të Kushtetutës, pavarësisht mënyrave të ndryshme të propozuara për formulimin e nenit 108 të Kushtetutës, rezulton qartë se qëllimi i tyre ka qenë në favor të njësive bazë. Pra, edhe nëse me ligj mund të krijohen njësi të tjera apo kompetencat që nuk ushtrohen nga njësitë bazë, u jepen njësive të tjera të qeverisjes vendore, në këto diskutime asnjëherë nuk është vënë në dyshim ekzistenca e komunës dhe bashkisë. Konkretisht është theksuar se e rëndësishme është që “*njësitë bazë mbeten gjithmonë bashkitë dhe komunat. ... Kjo përcakton prioritetin e nivelit të parë kundrejt nivelit të dytë*”⁵.

17. Kushtetutëbërësi në zgjedhjen e tij, si më lart, ka pasur në konsideratë edhe parimin themelor të funksionimit të organeve të qeverisjes vendore, parimin e decentralizimit të parashikuar nga neni 13 i Kushtetutës. Ky parim ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 5 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, në të cilin përcaktohet se “*komuna përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh, si rregull në zona rurale*”, ndërsa “*bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh kryesisht në zona urbane*”. Theksojmë se ky ligj nuk është shfuqizuar nga ligji i ri, çka do të thotë jo vetëm se njësitë bazë të qeverisjes vendore vazhdojnë të jenë komunat dhe bashkitë, secila me veçoritë përkatëse, por njëkohësisht se krijohen edhe përplasje midis tyre.

18. Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Në juridiksionin kushtetues hyjnë papajtueshmëria e ligjeve apo kodeve me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 35, datë 10.10.2007 dhe nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Por, Gjykata është shprehur, gjithashtu, se mungesa e harmonizimit të dispozitave të një ligji me ato të ligjeve të tjera mund të mos krijojë në vetvete antikushtetutshmëri, por kur paqartësia krijon

³ Neni 108/1 parashikon “*Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj*”.

⁴ Neni 108/3 parashikon “*Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore*”.

⁵ Shih Debatë Kushtetues, vëllimi 2, Tiranë 2006, f. 115-120.



probleme të tilla që çojnë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në cenim të parimit të shtetit të së drejtës e të sigurisë juridike, atëherë nuk mund të pranohet se këto norma nuk janë të papajtueshme edhe me frymën e Kushtetutës (shih vendimin nr. 14, datë 22.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

19. Nga ana tjetër, edhe nëse do të marrim të mirëqena arsyet (një numër i madh njësisish vendore nuk arrinin të mblidhnin asnjë të ardhur të vetën, duke mos qenë në gjendje të ofronin shërbime për banorët e tyre), që nxitën ndërmarrjen e një reforme tërësore për sa i takon organizimit administrativ të territorit të vendit, të sjella nga Këshilli i Ministrave (shih paragrafin nr. 39 të vendimit), ndonëse ato mund të kenë rëndësi, bazuar në parimet e mishëruara në jurisprudencën kushtetuese, ato mund të shërbejnë në ndërmarrjen e nismave për ndryshimin e Kushtetutës, por në asnjë rast ky ndryshim nuk mund të bëhet me një akt ligjor që kapërcen frymën dhe përmbajtjen e saj.

20. Duke konsideruar sa më sipër, mendojmë se suprimi i komunës nga njësitë bazë të qeverisjes vendore deformon vullnetin e kushtetutëbërësit dhe si i tillë bie ndesh me nenet 13, 108/1 dhe 116 të Kushtetutës.

Për pretendimin për cenimin e nenit 108/2 të Kushtetutës.

21. Neni 108/2 i Kushtetutës parashikon: *“Ndarjet administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to”*.

22. Shumica, edhe pse çmon se koncepti i marrjes së mendimit nga popullsia që banon në njësitë e qeverisjes vendore është detyrim kushtetues (shih paragrafin nr. 56 të vendimit), lidhur me mënyrat e realizimit të këtij detyrimi, i referohet ligjit nr. 8652/2000. Bazuar në nenin 67 të këtij ligji, shumica ka konstatuar se metodat e ndjekura, me qëllim kryerjen e procesit të konsultimit publik lidhur me reformën e re administrativo-territoriale, janë takimet dhe mbledhjet e hapura, seancat e këshillimit publik, dëgjesat publike, sondazhi kombëtar, si dhe mediat vizive dhe të shkruara (shih paragrafin nr. 65 të vendimit). Për këto arsye ajo ka arritur në përfundimin se kriteri kushtetues i marrjes së

mendimit është realizuar nëpërmjet përdorimit të pjesës më të madhe të metodave të parashikuara nga ligji i lartpërmendur, prandaj nuk është cenuar neni 108/2 i Kushtetutës (shih paragrafin nr. 67 të vendimit).

23. Një trajtim i tillë i ngushtë i problemit më thelbësor në këtë çështje, duke u kufizuar thjesht në respektimin e nenit 108/2 të Kushtetutës, le jashtë vëmendjes atë që është më e rëndësishme në një shtet të së drejtës, respektimin e parimit të sovranitetit të popullit, që buron nga neni 2 i Kushtetutës.

24. Interpretimi gramatikor, por edhe logjik i nenit 108/2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të Kushtetutës, nxjerr në pah se ajo (Kushtetuta) mbron njësitë e qeverisjes vendore duke përcaktuar disa kriteret për procesin e ndryshimit të kufijve administrativo-territorialë të këtyre komuniteteve. Pra, që të jetë e mundur ndarja administrative duhet të përmbushen dy kushte: ajo të mbështetet në interesat e përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike, si dhe të bazohet në mendimin e popullsisë që banon në to.

25. Për më tepër, pjesa e parë e fjalisë së dytë të dispozitës është mohuese kategorike *“kufijtë e njësive të qeverisjes vendore nuk mund të ndryshohen”*, i vetmi përjashtim është përcaktuar në pjesën e dytë të fjalisë, pra marrja më parë e mendimit të popullsisë që banon në to.

26. Parimi i mbrojtjes së kufijve territorialë të bashkësive vendore sanksionohet edhe nga neni 5 i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, i cili përcakton: *“Për çdo ndryshim të kufijve territorialë vendorë, bashkësive vendore përkatëse duhet t'u merret mendimi paraprakisht, po qe nevoja, me anë referendumi, aty ku e lejon ligji”*.

27. Në këtë kuptim, për shkak të rëndësisë që kanë kufijtë administrativo-territorialë të njësive vendore, vlerësojmë se marrja e mendimit duhet të kryhet nëpërmjet një instrumenti sa më të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës, i cili i përgjigjet edhe kriterit të parë të përcaktuar nga neni 108/2 i Kushtetutës (interesat e përbashkët ekonomikë dhe tradita historike). Harmonizimi i kërkesave të parashikuara nga nenet 2/2, 13 dhe 108/2 të Kushtetutës, sipas pikëpamjes tonë, arrihet vetëm nëpërmjet referendumit, si mënyra më demokratike për të pasqyruar vullnetin e popullsisë së interesuar. Mendojmë se



referendumi, në rastin në shqyrtim ai konsultativ, duke qenë se siguron një votim të përgjithshëm, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, është i vetmi mjet që përmbush më mënyrën më adekuate të gjitha kriteret kushtetuese.

28. Veç sa më sipër, jemi të mendimit se ndryshimi i kufijve ndikon në mënyrën e vetëqeverisjes së njërive të qeverisjes vendore, prandaj mbrojtja e tyre është në funksion edhe të garantimit të parimit të autonomisë vendore. Në këtë drejtim, paragrafi i dytë i nenit 108 duhet interpretuar në unitet me paragrafin e katërt të tij, i cili citon se *“vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore”*. Pra, edhe në respekt të autonomisë vendore, mënyra më e përshtatshme e vetëqeverisjes ushtrohet nëpërmjet referendumit vendor.

29. Në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se metodat e ndjekura në rastin në shqyrtim, të tilla si: takimet dhe mbledhjet e hapura, seancat e këshillimit publik, dëgjuesat publike, sondazhi kombëtar, si dhe mediat vizive dhe të shkruara, mund të jenë të rëndësishme gjatë procesit të diskutimit të projektligjit për ndarjen administrative territoriale, por finalizimi i këtij procesi duhet domosdoshmërisht të bëhet nëpërmjet referendumit, si e vetmja metodë që siguron marrjen e mendimit të popullsisë në respekt të parashikimeve kushtetuese. Prandaj, mospërdorimi i këtij mjeti përbën cenim të neneve 2/2, 13 dhe 108/2 të Kushtetutës nga ligji nr. 115/2014.

30. Edhe gjykatat kushtetuese evropiane janë investuar për mënyrën e marrjes së mendimit të popullsisë në çështjet e referendumeve administrative. Kështu, Gjykata Kushtetuese Italiane, në mënyrë të përsëritur, është vënë në lëvizje për të interpretuar termin *“pasi ka dëgjuar popullsitë e vetë”*, të parashikuar nga neni 133/26 i Kushtetutës. Ajo ka theksuar se formulimi i këtij neni bën të qartë që në asnjë rast nuk mund të procedohet në mungesë të njërit prej kriterëve të përcaktuara nga neni 133/2 i Kushtetutës, të cilat janë: ligji rajonal dhe referendumi konsultativ. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata Kushtetuese

Italiane ka theksuar se *“është parim i konsoliduar i jurisprudence së kësaj Gjykate që neni 133/2 i Kushtetutës, duke i atribuuar rajonit kompetencën që me ligj rajonal të krijohet në territorin e tij komuna të reja dhe të ndryshojë kufijtë dhe emërtimet e tyre, parashikon që të dëgjohen popullsitë e interesuara, gjë që passjell për rajonet me statut të zakonshëm, detyrimin që të procedojnë për realizimin e këtij qëllimi nëpërmjet referendumit”* (shih vendimet nr. 214/2010, nr. 237/2004, 47/2003, 279/1994, nr. 107/1983 dhe nr. 204/1981). Gjithashtu, në vendimin nr. 36/2011 ajo gjykatë është shprehur se përmbushja e “dëgjimit të popullsisë të interesuara”, me anë të referendumit konsultativ, përbën një fazë të detyrueshme⁷ që duhet të ketë, në çdo rast, një evidencë të pavarur në procedurën e ndjekur”. Instituti i referendumit, në fakt, garanton *“nevojën e pjesëmarrjes së popullsisë të interesuara”* (vendimi nr. 279/2004) edhe thjesht për ndryshimin e territorit të komunave (vendimi nr. 433/1995). Për pasojë ligjvënësi rajonal disponon në këtë fushë vetëm kompetencën që të rregullojë procedurën që passjell ndryshimin dhe në mënyrë të veçantë të përcaktojë kriteret eventuale për të identifikuar “popullsitë e interesuara” për referendum.

31. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese Sllovene, në vendimin nr. UI – 85/94, datë 20.5.1994, është shprehur se Kushtetuta e detyron ligjvënësin për të mbajtur referendum para themelimit të komunave të reja. Ndërsa në vendimin nr. UI- 183/94, të datës 9.11.1994, thekson se *“referendumi, në kuptim të nenit 1398 të Kushtetutës, pasqyrojnë vullnetin e banorëve në një zonë të caktuar... dhe se referendumi konsultativ është parashikuar në Kushtetutë, ndërsa përcaktimi përfundimtar i zonave të një komune i është lënë ligjvënësit”*.

⁷ Gjykata është shprehur se nuk pranohen përjashtime edhe për ndonjë situatë që mund të konsiderohet si më pak e rëndësishme. Me fjalë të tjera, procedurat duhet të ndiqen (ligj rajonal dhe referendum) edhe kur ekziston një vullnet i përbashkët i organeve të komunave që përfshihen në ndryshimet territoriale (si ka ndodhur në rastin në shqyrtim nga GJK-ja – vendimi nr. 214/2010), ashtu edhe kur bëhet fjalë thjesht për një integrim të emërtimit original të komunës, të kërkuar nga këshilli komunal, sepse edhe kjo passjell një ndryshim (si ka ndodhur në rastin e vendimit nr. 237/2004).

⁸ Neni 139 (Komunat) citon: *“Komunat janë komunitete që vetëqeverisen. Territori i komunës përfshin një zonë apo disa zona së bashku të lidhura nga nevojat e përbashkëta dhe interesat e banorëve. Një komunë përcaktohet me ligj, si dhe nga referendumi me anë të të cilit merret vullneti i banorëve në një territor të caktuar. Edhe territori i komunës përcaktohet me ligj”*.

⁶ Neni 133 citon: *“Ndryshimi i territorit të provincës dhe krijimi i provincave të reja brenda një rajoni vendosen me ligje të Republikës, me nismën e komunave, pasi dëgjohet vetë rajoni”*.

Rajoni, pasi ka dëgjuar popullsitë e interesuara, mundet, me ligje të tij, të krijojë në territorin e vet komuna të reja dhe të ndryshojë territorin dhe emërtimet e tyre”.



32. Në këtë drejtim mendojmë se jo rastësisht si në formulimin e nenit 108/4 të Kushtetutës, ashtu edhe në atë të nenit 5 të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, ndërmjet shumë kritereve të njohura për marrjen e mendimit të popullsisë, përmendet në mënyrë specifike vetëm referendumi, pasi përveç sa më lart, ai është i vetmi instrument që lejon identifikimin e saktë të personave që marrin pjesë në proces, si dhe transparencën e plotë të tij (procesit).

33. Një parashikim të tillë e gjejmë edhe në nenin 7 të ligjit të vitit 2000 për administrimin dhe vetëqeverisjen vendore të Republikës së Kroacisë⁹, i cili përcakton se mendimi i banorëve për ndryshimet në territorin e një njësie vendore përbëhet nga deklaratat e dhëna nga banorët e një njësie të caktuar. Këto deklarata duhet të jenë të nënshkruara individualisht nga banorët, si dhe të përmbajnë datën dhe një numër identifikimi personal. Për këtë ligj Gjykata Kushtetuese Kroate, në vendimin nr. U-I-3226/2006, të datës 9.7.2008, është shprehur se ai kërkon në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje shprehjen e vullnetit të qytetarëve për ndryshimin e kufijve.

34. Për arsyet e mësipërme, mendojmë se me këtë vendim të shumicës Gjykata humbi një shans për të vendosur një standard kushtetues bashkëkohor lidhur me të drejtën e popullit për referendum.

35. Si përfundim, për shkak të ndryshimeve thelbësore që reforma administrativo-territoriale ka sjellë si në sasi (kufizimi drastik i numrit të njërive bazë të qeverisjes vendore), por edhe në cilësi (duke suprimuar njësinë më të vogël bazë, komunën), pa marrë më parë mendimin e popullsisë së interesuar nëpërmjet instrumentit të referendumit, si dhe të mungesës së konsensusit ndërmjet forcave politike në miratimin e ligjit, mendojmë se ligji nr. 115/2014 bie ndesh me nenet 2/2, 13, 82/2/f, 108/1, 108/2 dhe 116 të Kushtetutës.

Anëtarë: Gani Dizdari, Vladimir Kristo

VENDIM Nr. 20, datë 15.4.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 22.1.2015, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen 52/20 Akti që i përket:

KËRKUES: jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 97/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magistraturës”, i ndryshuar.

Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 42, 75, 78, 82, 83/2, 124, 131/a, 134/c, 136, 147 dhe 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha; pretendimet me shkrim të kërkuesit, një grup prej 31 deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të subjektit të interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që kërquan pranimin e kërkesës; pretendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave që kërquan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

⁹ Në Republikën e Kroacisë njësitë e qeverisjes vendore sanksionohen në nenin 129 të Kushtetutës.



VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*në vijim “Kuvendi”*) në datën 24.7.2014 ka miratuar ligjin nr. 97/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, të ndryshuar””. Ky ligj ka sjellë ndryshime në përbërjen dhe funksionet e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës (neni 1); kriteret që duhet të plotësojë kandidati për drejtor (neni 2); procedurën e emërimit të tij (neni 3); detyrat e drejtorit (neni 4); rastet e lirimit të tij nga detyra (neni 5); detyrat dhe rregullat për funksionimin e Këshillit Pedagogjik (neni 6); kompetencën e Këshillit Drejtues të Shkollës për përcaktimin e rregullave për procedimin disiplinor të kandidatëve për magjistratë (neni 7); rregullat e emërimit të pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm (neni 8); procedurat e pranimit dhe emërimit të gjyqtarëve a prokurorëve si pedagogë të brendshëm dhe të drejtat e detyrimit për shkak të këtij statusi (neni 9); procedurat e konkurrimit për gjyqtar ose prokuror (neni 10) dhe rregullat e trajnimit fillestar (neni 11). Po ashtu, ligji në nenin 12, *dispozitë kalimtare*, përcakton datën 1.9.2014 si afatin e qëndrimit në detyrë të anëtarëve të Këshillit Drejtues të përcaktuar në nenin 6, pika 1, shkronjat “ç”, “d”, “e”, “ë”, “p” dhe “g”. Po ashtu, dispozita kalimtare përcakton afatin 30-ditor nga hyrja në fuqi e ligjit për plotësimin e vendeve vakante, afatin 5-ditor për verifikimin e plotësimit të kushteve nga drejtori, pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm, fillimin e vitit të ri akademik në 1 nëntor 2014 dhe moszhvillimin e konkursit të pranimit për formimin fillestar 2014-2015.

II

2. **Kërkuesi, një grup prej 31 deputetësh**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*këtu e në vijim: Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 97/2014, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

2.1 *Për legjitimitetin*: Qëllimi dhe nxitja konkrete për deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit objekt kundërshtimi buron nga e drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar mbrojtjen e parimit të shtetit të së drejtës,

ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe respektimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor përmes Gjykatës Kushtetuese.

2.2 *Për pezullimin e zbatimit të ligjit*: Qëllimi i ligjit për ndërprerjen e mandateve të organeve drejtuese dhe dhënien fuqi prapavepruese normave ligjore të reja cenon parimin e kushtetutshmërisë, të shtetit të së drejtës dhe respektimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Zbatimi i menjëhershëm i ligjit krijon mosmarrëveshje kompetencash ndërmjet organeve kushtetuese, duke qenë se ndërhyr haptazi në pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe përfundon marrëdhëniet e punës për drejtorin e Shkollës së Magjistraturës, i cili gëzon statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Pezullimi i aktit është në përputhje edhe me interesin publik, pasi ligji duke prekur pavarësinë e pushtetit gjyqësor cenon edhe interesat e individit, veçanërisht të drejtën për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës.

2.3 *Për procedurën e miratimit të projektligjit*, kërkuesi ka pretenduar se shqyrtimi i projektligjit është kryer në kundërshtim nenet 4/3, 75/2, 78/2, 82 dhe 83/2 të Kushtetutës, duke parashtruar si vijon:

2.3.1 Projektligji është depozituar në Kuvend në datën 30.6.2014, si nismë e një grupi deputetësh. Në relacionin shoqërues të tij mungojnë efektet financiare që shoqërojnë projektligjin, çka përbën një të metë të propozimit të ligjit dhe, për rrjedhojë, një të metë kushtetuese të tij. Ligji rrit shpenzimet në buxhetin e shtetit, prandaj Kuvendi ka shmangur qëllimisht Këshillin e Ministrave nga detyrimi për të dhënë mendim.

2.3.2 Miratimi i projektligjit është bërë me procedurë të përshpejtuar, pa ndjekur rregullat e përcaktuara në nenin 83/2 të Kushtetutës dhe në nenin 69/3 të Rregullores. Nga raporti i hartuar nga Komisioni i Ligjeve rezulton se projektligji është shqyrtuar e miratuar në parim në mbledhjen e datës 16.7.2014, ndërkohë që nuk rezulton të jetë përfshirë në kalendarin e punimeve të Kuvendit, i miratuar për periudhën 4 deri 25 korrik 2014.

2.3.3 Nëse projektligji është shqyrtuar e miratuar pa u përfshirë në kalendarin e punimeve, atëherë vendimarrja e Kuvendit nuk duhet të sjellë asnjë pasojë ligjore, sipas nenit 27/5 të Rregullores dhe nenit 78/2 të Kushtetutës.



2.4 Për themelin e çështjes, kërkuesi pretendon se nenet 1, 3, 10 dhe 12 të ligjit bien ndesh me nenet 4, 7, 136, 147 dhe 149 të Kushtetutës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

2.4.1 *Ndryshimi i formulës së përbërjes së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës dhe mënyra e zgjedhjes së drejtorit (nenet 1 dhe 3)* cenojnë parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, si dhe pavarësinë e gjyqësorit.

2.4.1.1 Shkolla e Magjistraturës është institucioni i vetëm që siguron formimin profesional fillestar e vazhdues të magjistratëve ose të gjyqtarëve e prokurorëve në detyrë. Pavarësia e këtij institucioni është e pandarë nga pavarësia e pushtetit gjyqësor, sepse pavarësia e gjyqtarëve është e lidhur drejtpërdrejt me emërimin e tyre në detyrë. Në këtë kuptim, SHM-ja, duke qenë një hallkë e procedurës së emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të jetë e shkëputur nga organet përbërëse të sistemit gjyqësor, si dhe nuk mund të ndërveprojë e pavarur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm.

2.4.1.2 Ndryshimi i balancave në Këshillin Drejtues të SHM-së, duke përjashtuar KLD-në dhe Prokurorin e Përgjithshëm nga përfaqësimi përcaktues në Këshillin Drejtues, ka efekt të drejtpërdrejtë në pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Zvogëlimi i numrit të anëtarëve përfaqësues të pushtetit gjyqësor dhe rritja e numrit të anëtarëve të jashtëm nuk siguron mekanizmin e bashkëpunimit midis institucioneve kushtetuese që janë pjesë e procesit të rekrutimit dhe emërimit të magjistratëve.

2.4.1.3 Ligjvënësi, duke i njohur Konferencës Gjyqësore dhe Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve të drejtën e përfaqësisë në Këshillin Drejtues, nuk ka mbajtur parasysh faktin që funksionet e tyre ndryshojnë thelbësisht nga ato të KLD-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

2.4.1.4 Transferimi i përgjegjësiave për edukimin e gjyqtarëve nga KLD-ja te Konferenca Gjyqësore, e cila nuk e ka këtë kompetencë funksionale, nënkupton përplasje midis normave të një ligji të miratuar me shumicë të cilësuar dhe një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë, për rrjedhojë, cenon nenin 116 të Kushtetutës.

2.4.1.5 Po ashtu, shmangia e KLD-së edhe nga procedura e emërimit të drejtorit të SHM-së ngushton hapësirën e këtij organi kushtetues në

përbushjen e përgjegjësiave kushtetuese e ligjore, çka bie ndesh me parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve dhe pavarësinë e gjyqësorit.

2.4.2 *Ndryshimi i rregullave të pranimit në Shkollën e Magjistraturës (neni 10)*, duke përfshirë në procesin e vlerësimit të aftësive mendore dhe psikologjike të kandidatëve nga struktura të Ministrisë së Shëndetësisë si pjesë e pushtetit ekzekutiv, përveçse përbën cenim të dinjitetit njerëzor, krijon premisën e qartë për ndërhyrje në procesin e rekrutimit të magjistratëve, me pasoja të drejtpërdrejta në procesin e emërimit përfundimtar të magjistratëve, dhe, për rrjedhojë, çon në cenim të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

2.4.3 *Ndërprerja e mandateve të organeve drejtuese ekzistuese dhe fuqia propavepruese e ligjit (neni 12)* cenon parimin e ligjshmërisë, të sigurisë juridike dhe të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Për më tepër, dhënia normave ligjore të reja fuqi propavepruese, si dhe ndërprerja e mandateve të organeve drejtuese ekzistuese dhe të pedagogëve bie ndesh me pavarësinë e SHM-së.

3. **Subjekti i interesuar Kuvendi** ka pabazuar me shkrim si vijon:

3.1 Pretendimi i kërkuesit për mosrespektimin e procedurës së miratimit të ligjit është i pabazuar:

3.1.1 Në referim të nenit 82, pika 1, të Kushtetutës jo çdo propozim legjislativ duhet të shoqërohet me raportin për shpenzimet financiare, çka rezulton edhe nga përdorimi në këtë normë kushtetuese i shprehjes “*kur është rasti*”. Për më tepër, ligji i ri ka pasur për qëllim vetëm ndryshimin e rregullave me natyrë procedurale pa asnjë kosto financiare, sepse nuk parashikonte krijimin e strukturave të reja për zbatimin e tij, të paparashikuara nga ligji bazë.

3.1.2 Nenet 27, 29, 38, 69 dhe 70 të Rregullores së Kuvendit i përkasin aspektit të vetërregullimit të Kuvendit dhe, si të tilla, nuk janë dispozita të nivelit kushtetues. Në këtë kuptim, mënyra e interpretimit dhe zbatimit të tyre nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues.

3.1.3 Bazuar në nenin 69 të Rregullores së Kuvendit, projektligji, si nismë e një grupi deputetësh, i është dorëzuar Kryetarit të Kuvendit, i cili ia ka vënë atë menjëherë në dispozicion deputeteve, mediave ose subjekteve të tjerë të interesuara. Projektligji është përfshirë



në programin e punimeve të Kuvendit për periudhën 4-31 korrik 2014, pas miratimit me konsensus në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, të mbajtur në datën 30.6.2014.

3.1.4 Në referim të neneve 29 dhe 38 të Rregullores, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, brenda 2 ditëve nga miratimi i programit të punimeve të Kuvendit, e ka përfshirë projektligjin në fjalë në programin e tij të punës për periudhën 4-31 korrik 2014. Projektligji ka kaluar për shqyrtim në datën 16.7.2014, pasi kishin kaluar dy javë nga depozitimi në Kuvend, duke respektuar aspektin procedural dhe substancial të nenit 69 të Rregullores.

3.1.5 Sipas procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, projektligji është miratuar në parim në mbledhjen e datës 16.7.2014, ndërsa shqyrtimi dhe miratimi nën për nen është bërë në mbledhjen e datës 22.7.2014. Në vijim të procedurave parlamentare, raporti i Komisionit për këtë projektligj i është dërguar Shërbimit të Seancave të Kuvendit, që në bashkëpunim me Kryetarin e Kuvendit e ka përfshirë atë në rendin e ditës të seancës plenare të datës 24.7.2014, bërë publike dy ditë përpara zhvillimit të saj, në përputhje me përcaktimet e nenit 27 të Rregullores.

3.1.6 Neni 78/2 i Kushtetutës ka për qëllim të shmangë dhe të pengojë që seanca plenare të zhvillohet në mënyrë abuzive, pa iu njoftuar/lajmëruar deputetëve ose pa bërë publik rendin e ditës, duke krijuar në këtë mënyrë mundësinë e përjashtimit dhe mosmarrjen pjesë të deputetëve në të. Në rastin konkret, si njoftimi i mbledhjes, ashtu edhe bërja publike e rendit të ditës dy ditë para seancës plenare të miratimit të këtij projektligji është bërë në përputhje me Rregulloren.

3.2 *Për ndryshimin e formulës së përbërjes së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës dhe të mënyrës së përzgjedhjes së drejtorit.*

3.2.1 Objektivi kryesor i projektligjit ka qenë fuqizimi i trupës akademike të Shkollës së Magjistraturës si në aspektin e formimit akademik edhe në atë vendimmarrës. Për këtë arsye është rritur nga dy në katër numri i përfaqësuesve të trupës pedagogjike të kësaj shkolle në Këshillin Drejtues.

3.2.2 Për të siguruar një nivel sa më të lartë

përfaqësues është parashikuar rritja e përfaqësuesisë së strukturave të arsimit të lartë universitar në këtë Këshill, siç është Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë, nisur nga roli, kompetencat dhe përbërja me personalitete shkencore, e me tituj të lartë akademikë.

3.2.3 Në lidhje me pretendimin për përjashtimin e KLD-së nga anëtarësia e Këshillit Drejtues jo vetëm konstatohet që ky organ kushtetues përfaqësohet *ex officio* nga zëvendëskryetari, por, nga ana tjetër edhe Konferencës Gjyqësore Kombëtare, si një institucion i parashikuar nga Kushtetuta, nuk mund t'i mohohet e drejta e përfaqësimit, duke rritur standardet e përfaqësimit të pushtetit gjyqësor në këtë strukturë.

3.2.4 Këshilli Drejtues nuk ka të drejtë të përzgjedhë kandidatë fitues për formimin fillestar apo të përcaktojë procedurat e propozimit të magistratëve për t'u emëruar në sistemin gjyqësor në përfundim të procesit të formimit fillestar.

3.2.5 Parashikimi i ri ligjor për zgjedhjen e drejtorit i shërben rritjes së standardeve profesionale që duhet të gëzojë ai, çka e bën të pabazuar pretendimin për cenimin e parimeve kushtetuese si rezultat i përcaktimit të kriterëve përjashtuese dhe diskriminuese për zgjedhjen e tij.

3.3 *Për pretendimin për ndryshimin e rregullave për pranimin në Shkollën e Magjistraturës, si rezultat i ngritjes së një komisioni të posaçëm për të vlerësuar përshtatshmërinë shëndetësore/psikike në ushtrimin e profesionit.*

3.3.1 Kërkesit konfundojnë heqjen e zotësisë për të vepruar, si një institut i së drejtës civile, me pamundësinë për ushtrimin e profesionit të gjyqtarit ose prokurorit, që parashikohet në Kushtetutë. Në kërkesë nuk bëhet dallimi ndërmjet konceptit “*deklarim i paaftë për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë*”, i parashikuar nga Kushtetuta në nenet 71/dh, 127/d dhe 139/d për deputetët, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë nga koncepti i “*paaftësisë mendore a fizike*”, që parashikohet në nenet 91/2, 128 dhe 140, për Presidentin e Republikës, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

3.3.2 Po ashtu, parashikimi ligjor nuk është në kundërshtim me Kushtetutën nëse u referohemi



normave kushtetuese që përcaktojnë vërtetimin e pamundësisë në ushtrimin e detyrës së Presidentit të Republikës, si dhe të paaftësisë mendore a fizike të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

3.3.3 Ngritja e komisionit mjekësor u referohet edhe praktikave ndërkombëtare ekzistuese, siç është rasti i Francës.

3.4 *Për pretendimin për ndërprerjen e mandateve të organeve ekzistuese dhe fuqinë prapavepruese të ligjit.*

3.4.1 Fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim kur imponohet nga prania e interesit publik. Në rastin konkret interesi publik prezumohej, sepse konstatohej që drejtori apo pedagogët e brendshëm ose të jashtëm të Shkollës së Magjistraturës nuk plotësonin kriteret bazë të emërimit, të cilat lidhen me mësimdhënien dhe përbëjnë standard demokratik të çdo vendi që aspiron për cilësi në këtë drejtim.

3.4.2 Edhe pretendimi për prapaveprueshmërinë e ligjit në ndalimin e kryerjes së konkursit të pranimit nuk qëndron, bazuar kryesisht në qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike për arsye të interesit publik. Nisur nga mungesa e një studimi të plotë në lidhje me nevojat për magjistratë në të ardhmen, planifikimi i KLD-së për të pranuar magjistratë të rinj do të konsiderohej i pabazuar në nevojat reale që ka sistemi dhe ekziston rreziku që deri në përfundim të studimeve në vitin 2017 këta magjistratë të mos emërohen, për shkak të mungesës së vendeve të lira, dhe të shkaktojnë barrë në buxhetin e shtetit.

4. ***Subjekti i interesuar Këshilli i Ministrave*** ka prapësuar me shkrim si vijon:

4.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor është i pabazuar, pasi Shkolla e Magjistraturës nuk është organ kushtetues apo me rëndësi kushtetuese, për rrjedhojë kushtetutshmëria e ndryshimit të përbërjes së Këshillit Drejtues nuk mund të kontrollohet nga aspekti kushtetues.

4.2 Shkolla e Magjistraturës nuk përbën hallkë të procesit të emërimit të magjistratëve, por është pjesë e rekrutimit të tyre. Për sa i përket listës së magjistratëve që drejtori i SHM-së i dërgon Presidentit, ajo bazohet në vlerësimet teorike dhe të stazhit e jo mbi kritere subjektive.

4.3 SHM-ja nuk mund të jetë e varur nga

KLD-ja, siç pretendon kërkuesi, pasi kjo do të binte ndesh me autonominë universitare, në kuptim të nenit 57/7 të Kushtetutës.

4.4 Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë ka karakter ndihmues për aspektet teknike të procesit dhe rezultatet e testimit janë rrjedhojë e vlerësimeve mbi bazën e kriterëve shkencore profesionale.

4.5 Edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i fuqisë prapavepruese të ligjit është i pabazuar, për faktin se ndryshimet ligjore kanë për qëllim rritjen e performancës së SHM-së. Ligjvënësi, duke kërkuar përmbushjen e kriterëve të reja për drejtuesit dhe stafin akademik ekzistues, ka ndjekur një qëllim legjitim brenda diskrecionit të tij.

5. ***Subjekti i interesuar Këshilli i Lartë i Drejtësisë*** ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

5.1 Ndryshimet e ligjit bien ndesh me nenet 7, 145/1 dhe 147 të Kushtetutës, pasi cenojnë parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve në dëm të pavarësisë strukturore dhe personale të pushtetit gjyqësor. Autonomia dhe pavarësia e pushtetit gjyqësor sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vlerësohen, midis të tjerash, edhe nën dritën e mënyrës së përzgjedhjes së anëtarëve, mandateve të tyre, ekzistencës së mekanizmave mbrojtës ndaj presioneve nga jashtë, etj.

5.2 KLD-ja është institucioni kryesor që ka për detyrë të sigurojë integritetin e gjyqësorit, por ligji i ri nuk e justifikon ekzistencën e interesit publik për kufizimin e dukshëm të kompetencës së KLD-së për emërimin për herë të parë të gjyqtarëve, madje edhe për ndjekjen e mëtejshme të karrierës së tyre.

5.3 Dobësimi i rolit kushtetues të KLD-së dhe forcimi i pushtetit ekzekutiv krijon potencialisht influencë të papërshtatshme në procesin e rekrutimit dhe të karrierës së gjyqtarëve. Përfshirja në Këshillin Drejtues të një përfaqësuesi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS-i) cenon parimin e autonomisë së arsimit të lartë, i përcaktuar në nenin 57/7 të Kushtetutës.

5.4 Për sa u përket dispozitave kalimtare, ato janë shprehje e fuqisë prapavepruese të ligjit dhe cenojnë parimin e sigurisë juridike, sepse ndërpresin mandatet e anëtarëve aktualë,



mandatin e drejtorit dhe marrëdhëniet e punës për pedagogët aktualë, në datën 1.9.2014, që është data e botimit në Fletoren Zyrtare dhe jo e hyrjes në fuqi të ligjit.

5.5 Edhe parashikimi transitor për moszhvillimin e konkursit të pranimit fillestar të magistratëve 2014-2015 ka dëmtuar besimin e publikut në seriozitetin e autoriteteve shtetërore, duke sjellë dëm të paarsyeshëm për kandidatët që kishin filluar përgatitjet për këtë konkurrim, madje edhe dëm financiar për shtetin, pasi aplikimet për konkurrim ishin kryer dhe pagesa u rimbursua.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit objekt kundërshtimi

6. Gjykata, përpara shqyrtimit të pretendimeve të kërkesit mbi themelin e çështjes, vlerëson të shprehet në lidhje me kërkesën për pezullimin e zbatimit të mëtejshëm të ligjit nr. 97/2014 deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

7. Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 22.10.2014, vlerësoi se argumentet e parashtruara nga kërkesi për të provuar cenimin e interesit shtetëror dhe shoqëror, të tilla si: qëllimi i paracaktuar i ligjit për kapjen politike të Shkollës së Magistraturës përmes dhënies fuqi prapavepruese normave ligjore, cenimi i parimit të pavarësisë së gjyqësorit, krijimi i mosmarrëveshjeve të kompetencave midis organeve kushtetuese, afatet kohore të shkurtra sipas dispozitës kalimtare apo edhe argumentet për cenimin e interesit individual, si mosgarantimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor apo ulja e cilësisë së mësimdhënies, nuk plotësojnë kërkesat e nenit 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kësaj kërkeje si të pabazuar.

B. Për legjitimitetin e kërkesit¹⁰

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) të një të

pestës së deputetëve është vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nga Gjykata Kushtetuese. Edhe në çështjen konkrete, Gjykata rithekson qëndrimin e konsoliduar të jurisprudencës kushtetuese se një e pesta e deputetëve përfaqëson një nga subjektet e parashikuara në nenin 134/1, shkronja “c”, të Kushtetutës, të cilat kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar.

C. Për pretendimin e mosrespektimit të neneve 4/3, 75/2, 78/2, 82 dhe 83/2 të Kushtetutës, si dhe të Rregullores së Kuvendit

9. Kërkesi ka pretenduar se Kuvendi gjatë procesit të miratimit të ligjit nuk ka respektuar kërkesat procedurale të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit. Konkretisht, pretendimet e kërkesit kanë të bëjnë me mosrespektimin e neneve: 4/3 të Kushtetutës që përcakton zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të dispozitave kushtetuese; 75/2, që përcakton se Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së miratuar nga shumica e anëtarëve; 78/2, që përcakton se mbledhjet e deputetëve që nuk zhvillohen sipas rregullores nuk sjellin asnjë pasojë; 82, pika 2, që kërkon marrjen e mendimit paraprakisht të Këshillit të Ministrave mbi efektet financiare të ligjit; 83, pika 2, mbi kriteret e procedurës së përshpejtuar. Po ashtu, kërkesi pretendon mosrespektimin e neneve 27/5 dhe 69/3 të Rregullores, si rezultat i miratimit të projektligjit me procedurë të përshpejtuar pa qenë i përfshirë paraprakisht në kalendarin e punimeve të Kuvendit.

10. Kushtetuta në nenin 82, pika 1 përcakton se “*Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga marrja e projektligjit*”.

11. Gjykata konstaton se dispozita e mësipërme kushtetuese përcakton plotësimin e disa kriterëve, që konkretisht përfshijnë natyrën jo qeveritare të projektligjit, efektet financiare, që

¹⁰ Gjyqtari V. Kristo votoi kundër legjitimitetit të kërkesit, sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 25, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese.



sipas rastit mund të jenë rritje shpenzimesh ose pakësim i të ardhurave, si dhe respektimin e afatit kohor.

12. Duke e vlerësuar ligjin nën dritën e kriterëve të mësipërme, Gjykata, në referim të pjesës hyrëse të projektligjit, konstaton se ai është paraqitur si nismë e një grupi deputetësh. Edhe pse projektligji plotëson një nga kriteret e përcaktuara nga norma kushtetuese, Gjykata vëren se, referuar pretendimeve të kërkuarit, mungojnë argumente konkrete në lidhje me rritjen e shpenzimeve apo pakësimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit si rrjedhojë e miratimit apo zbatimit të ligjit të kundërshtuar.

13. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit nuk është ngritur në nivel kushtetues.

14. Për sa i përket pretendimit për mospërfshirjen e projektligjit në kalendarin e punimeve, Gjykata çmon ta vlerësojë atë referuar kushteve dhe kriterëve procedurale të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit lidhur me procedurat për miratimin e programit të punës dhe kalendarit të punimeve të Kuvendit (nenet 26-31), të kalendarit të komisioneve të përhershme (nenet 32-41) dhe të zhvillimit të seancave plenare (nenet 42-54).

15. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se bazuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 4-31 korrik 2014, dokument i cili është administruar në gjykimin kushtetues, projektligji “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës” ka qenë i përfshirë në të (f. 20). Për më tepër, kalendarit identifikon grupin e nismëtarëve, datën e depozitimit në Kuvend, komisionin parlamentar përgjegjës (Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut) dhe komisionin përgjegjës për dhënie mendimi (Komisioni i Integritetit dhe Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik). Po ashtu, bazuar në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të datës 16.7.2014, Gjykata vëren se një ndër çështjet e rendit të ditës ka qenë edhe projektligji objekt kundërshtimi.

16. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit është i papabazuar.

17. Në lidhje me pretendimin për

mosrespektimin e kërkesave të nenit 83, pika 2, të Kushtetutës mbi procedurën e përshpejtuar, Gjykata vlerëson paraprakisht të risjellë në vëmendje qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese në lidhje me këtë çështje.

18. Norma kushtetuese në fjalë parashikon kushtet dhe kriteret për shqyrtimin dhe miratimin e një projektligji me procedurë të përshpejtuar. Po ashtu, ajo evidenton edhe subjektet që legjitimohen t'i drejtohen me kërkesë Kuvendit, të cilat janë: Këshilli i Ministrave ose një e pesta e të gjithë numrit të deputetëve. Për sa i përket aspektit kohor të zbatimit të kësaj procedure, norma kushtetuese vendos kufij kohorë, duke sanksionuar se *“Kuvendi... mund të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit”*.

19. Gjykata vëren se Rregullorja e Kuvendit, në nenin 28, përshkruan në mënyrë të detajuar rregullimin kushtetues të nenit 83, pikat 2, duke evidentuar një tërësi veprimesh procedurale që duhet të zbatohen gjatë shqyrtimit dhe miratimit të një projektligji me procedurë të përshpejtuar. Konkretisht, kërkesa e Këshillit të Ministrave ose e një të pestës së deputetëve i paraqitet me shkrim Kryetarit të Kuvendit, i cili ia njofton Kuvendit në seancën plenare më të parë. Pas njoftimit të Kryetarit dëgjohet një folës pro dhe një kundër për jo më shumë se 10 minuta. Kryetari i Kuvendit i paraqet Kuvendit për votim projektvendimin përkatës, në të cilin përcaktohet data e shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës, afati brenda të cilit mund të propozohen amendamente dhe data e shqyrtimit në seancë plenare. Konferenca e Kryetarëve mund të përcaktojë kohën e debatit në seancë plenare, duke respektuar rregullin e parashikuar në nenin 48, pika 3, të kësaj Rregulloreje, por në asnjë rast jo më pak se 10 minuta për çdo grup parlamentar. Afati brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja në komision dhe në seancë plenare nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare. Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se tri projektligje me procedurë të përshpejtuar gjatë programit 12-javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj gjatë programit 3-javor të punës së tij.

20. Në rastin konkret Gjykata konstaton se në



pjesën hyrëse të projektligjit parashikohet “... është miratuar në mbështetje të neneve 78, pika 1 dhe 83, pika 1”. Në vlerësimin e Gjykatës përcaktimi i bazës kushtetuese në pjesën hyrëse të ligjit nuk përbën thjesht një kriter formal të tij, por një element thelbësor që përcakton sjelljen dhe qëndrimin e deputetëve ndaj rregullave që zbatohen gjatë procedurave legjislativë. Gjykata rithekson se rregullat gjatë procedurave normale janë thelbësisht të ndryshme nga ato të procedurave të përshpejtuara dhe se dallimet konceptuale midis këtyre procedurave, apo edhe ndalimet përkatëse për zbatimin e tyre mbi një numër të caktuar ligjesh, kushtëzohen, veçanërisht, nga natyra e ligjeve objekt miratimi e përcaktuar në qëllimin dhe objektin e tyre. Në këtë kuptim, evidentimi qartësisht i bazës kushtetuese përbën një garanci më shumë për respektimin e kriterëve procedurale të miratimit të ligjit.

21. Gjykata konstaton se përveç mungesës së referimit në projektligj shprehimisht të pikës 2 të nenit 83 të Kushtetutës, në praktikën shoqëruese të tij nuk konstatohet ndonjë kërkesë e Këshillit të Ministrave ose e një të pestës së deputetëve për t'i kërkuar Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit me procedurë të përshpejtuar. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimi për miratimin e ligjit me procedurë të përshpejtuar është i pabazuar.

22. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit mbi mosrespektimin e kërkesave procedurale të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit ose mbi mungesën e pasojave të mbledhjes së deputetëve, janë të pabazuara.

Ç. Për themelin e çështjes

23. Gjykata paraprakisht konstaton se ndonëse kërkuar ka pretenduar shfuqizimin e ligjit në tërësi, argumentet e parashtruara në kërkesë kanë të bëjnë me nenet 1, 3, 10 dhe 12 të tij. Sipas kërkuarit, normat ligjore, të cilat ndryshojnë formulën e përbërjes së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, mënyrën e zgjedhjes së drejtorit, rregullat për pranimin në Shkollën e Magjistraturës, që ndërpresin mandatet e organeve drejtuese ekzistuese dhe që i japin ligjit fuqi prapavepruese, bien ndesh me parimin e ndarjes së pushteteve, hierarkinë e akteve normative, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, parimin e sigurisë juridike dhe

autonominë universitare. Këto pretendime të kërkuarit mbështeten edhe nga subjekti i interesuar Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Ç.1 Për pretendimin e cenimit të parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

24. Kërkuar ka parashtruar se nenet 1, 3 dhe 10 të ligjit objekt kundërshtimi, që parashikojnë ndryshimin e formulës së përbërjes së Këshillit Drejtues, mënyrën e zgjedhjes së drejtorit dhe rregullat për pranimin në SHM, cenojnë parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, pasi nuk respektojnë pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

25. Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka ritheksuar se neni 7 i Kushtetutës, që parashikon parimin e ndarjes së pushteteve në demokraci, si formë e qeverisjes, synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Pra, në thelb, në bazë të këtij parimi, tri pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur, por edhe në mënyrë të balancuar. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit (shih vendimet nr.24, datë 10.11.2006; nr. 19, datë 3.5.2007, nr. 11, datë 6.4.2010 dhe nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

26. Në lidhje me pushtetin gjyqësor, i cili është i ndarë dhe i balancuar me dy pushtetet e tjera, Gjykata rithekson se pavarësia e gjyqësorit kuptohet si pavarësi funksionale, strukturale organizative dhe financiare (shih vendimet nr. 11, datë 27.5.2004 dhe nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Përveç sa më sipër, Kushtetuta, krahas mbrojtjes së veçantë për disa organe kushtetuese, parashikon edhe krijimin e disa organeve qendrore me pozicion neutral ose të ndërmjetëm, vendi dhe roli i të cilave është mjaft i rëndësishëm në funksionimin e shtetit demokratik, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Edhe këto organe të rëndësishme, në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese, gëzojnë pavarësi që garantohet me



dispozita të veçanta të Kushtetutës. Ide qendrore mbetet shpërndarja e pushtetit shtetëror në disa organe apo mekanizma qendrorë kushtetues, të cilët e ushtrojnë atë në mënyrë të pavarur, por duke krijuar gjithnjë mundësinë që secili prej tyre të kontrollohet në mënyrë reciproke. Kushtetuta, duke theksuar pavarësinë e organeve, si: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, etj., bën kujdes që të mos i lërë ata jashtë çdo lloj kontrolli. Ajo vendos raporte të caktuara mes tyre si dhe mes tyre dhe organeve të tjera qendrore të pushtetit shtetëror, veçanërisht me Kuvendin. Këto raporte krijojnë mundësi për ushtrim kontrolli reciprok dhe për balancim të mjaftueshëm të pushtetit, duke u bazuar në kompetencat dhe funksionin kushtetues të secilit prej tyre. Një nga mjetet më të rëndësishme për mbrojtjen e pavarësisë së organeve apo institucioneve kushtetuese, është veçanërisht përcaktimi i saktë i mekanizmave dhe procedurave për zgjedhjen, emërimin dhe sidomos shkarkimin e drejtuesve apo anëtarëve të tyre (*shih vendimin nr. 19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata paraprakisht vëren se SHM-ja nuk përfshihet në rrethin e organeve të parashikuara nga Kushtetuta. Ajo përfaqëson një institucion publik, që gëzon cilësinë e personit juridik, krijuar me ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë”. Ky institucion gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave të caktuara nga kuadri ligjor në fuqi, të cilat kryesisht konsistojnë në formimin profesional të magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë).

29. Organet drejtuese të SHM-së përfshijnë Këshillin Drejtues, drejtorin, Këshillin Pedagogjik dhe Komisionin Disiplinor (neni 5). Këshilli Drejtues është një organ kolegjal dhe ka këto kompetenca: a) ndjek zbatimin e kriterëve për pranimin e kandidatëve që do të ndjekin programin e formimit fillestar dhe shpall listën përfundimtare të tyre; b) merr masa për zbatimin e rregullave të përzgjedhjes së trupës mësimdhënëse, si dhe bën emërimin dhe largimin e tyre nga detyra, me propozimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit Drejtues ose të drejtorit të Shkollës; c) përcakton brenda buxhetit strukturën

organizative dhe kriteret e emërimit të personelit administrativ; ç) miraton dhe ndjek zbatimin e rregullores së brendshme të Shkollës dhe të programit vjetor të veprimtarive të saj; d) përcakton, me propozimin e drejtorit, planin mësimor dhe rregullon raportet ndërmjet lëndëve për përgatitjen e përbashkët e të veçantë të kandidatëve sipas profileve, gjyqtarë dhe prokurorë; dh) propozon projektbuxhetin dhe shqyrton raportet e drejtorit për realizimin e buxhetit dhe shpenzimet e të ardhurave; e) paraqet raporte vjetore përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrit të Drejtësisë për rezultatet e arritura dhe drejtimit e punës për të ardhmen.

30. Për sa i përket përbërjes të Këshillit Drejtues, Gjykata konstaton se përpara ndryshimeve ligjore objekt kundërshtimi pjesë e këtij organi kolegjal kanë qenë: a) kryetari i Gjykatës së Lartë, i cili kryente njëkohësisht funksionin e Kryetarit të Këshillit Drejtues; b) Prokurori i Përgjithshëm, i cili kryente njëkohësisht funksionin e zëvendëskryetarit të Këshillit Drejtues; c) zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë; ç) dy gjyqtarë dhe dy prokurorë me përvojë, që caktoheshin përkatësisht nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nga Prokurori i Përgjithshëm; d) dy përfaqësues të caktuar nga ministri i Drejtësisë; dh) kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë; e) dekani i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës; ë) drejtori i Shkollës së Magjistraturës; f) përgjegjësit e trajnimit fillestar dhe vazhdues; g) dy studentë të zgjedhur me votim të fshehtë nga Asambleja e Kandidatëve për Magjistratë që ndjekin formimin fillestar.

31. Bazuar në ndryshimet e nenit 1 objekt kundërshtimi, Gjykata konstaton se përcaktimi i ri ligjor ka sjellë disa ndryshime në përbërjen e Këshillit Drejtues të SHM-së. Ligjvënësi ka ndryshuar përfaqësimin në pikat “ç”, “e” dhe “f”, duke bërë pjesë të këtij Këshilli: “ç) një gjyqtar dhe një prokuror me përvojë, që caktohen përkatësisht nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore dhe nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve. Anëtar i zgjedhur nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe anëtar i zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Këshillit të Prokurorisë; e) një përfaqësues i Ministrisë së



Arsimit dhe Sportit, që caktohet nga radhët e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë me përvojë të spikatur në fushën juridike; f) përgjegjësit e trajnimit fillestar dhe vazhdues, si dhe dy pedagogë të brendshëm të Shkollës së Magistraturës.”

32. Nisur nga përbërja aktuale e Këshillit Drejtues, Gjykata paraprakisht vëren se ndryshimet, sipas nenit 1 të ligjit, nuk kanë rritur apo zvogëluar numrin total të anëtarëve, por kanë zgjeruar kategorinë e organeve të emërtesës së anëtarëve të Këshillit Drejtues. Konkretisht, është ulur nga dy në një numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve që kishte të drejtë të zgjidhte përkatësisht KLD-ja dhe Prokurori i Përgjithshëm. Megjithatë, Gjykata konstaton se ka mbetur i pandryshuar përfaqësimi në Këshillin Drejtues i nënkryetarit të KLD-së, kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili është anëtar *ex officio* i KLD-së, si dhe një gjyqtar i zgjedhur prej saj. Po ashtu, ka mbetur i pandryshuar përfaqësimi në Këshillin Drejtues i Prokurorit të Përgjithshëm dhe i një prokurori të zgjedhur prej tij. Kështu, krahas një gjyqtari të caktuar nga KLD-ja dhe një prokurori të caktuar nga Prokuroria e Përgjithshme, tashmë në Këshillin Drejtues përfaqësohet edhe Konferenca Gjyqësore Kombëtare (KGJK-ja) dhe Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve (MPP-ja). Gjithashtu, janë pjesë përbërëse e tij edhe përfaqësues të Komisionit të Verifikimit të Titujve Akademikë, organ kolegjal pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe pedagogë të brendshëm të SHM-së.

33. Në vlerësimin e Gjykatës, formula e re e përbërjes së Këshillit Drejtues nuk ngre dyshime për cenimin e parimeve kushtetuese. Gjykata vëren se si KLD-ja, ashtu dhe KGJK-ja gëzojnë statusin e organeve kushtetuese me kompetenca të rëndësishme në garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Konkretisht, KLD-ja është vlerësuar si organi kushtetues i pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. Ky organ përbëhet në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen e këtij Këshilli me korpusin gjyqësor. Nga ana tjetër, KGJK-ja është organ përfaqësues i të gjithë gjyqtarëve që organizohet nga vetë gjyqësori. Parashikimi drejtpërdrejt nga Kushtetuta i këtij organi, duke i veshur statusin e institucionit me kompetencë

kushtetuese, ka për qëllim garantimin e pavarësisë së gjyqësorit (*shih vendimin nr.25, datë 5.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Po në këtë linjë arsyetimi, Gjykata çmon se si Prokurori i Përgjithshëm, ashtu edhe MPP-ja, si organ përfaqësues i prokurorëve, kanë për qëllim të përmbushin të njëjtin mision në kuadër të funksioneve që ata ushtrojnë në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjeve.

35. Në vështtrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se përfshirja e KGJK-së dhe Këshillit të Prokurorisë në kategorinë e organeve që kanë të drejtë të zgjedhin përfaqësues në Këshillin Drejtues të SHM-së nuk vë në dyshim cenimin e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

36. Po ashtu, Gjykata thekson se përfundimi i mësipërm përforcohet edhe më shumë duke vlerësuar funksionet e Këshillit Drejtues (*shih supra prg. 30*). Në referim të nenit 6, pika 2, të ligjit, kompetencat dhe detyrat e Këshillit Drejtues lidhen me ndjekjen e zbatimit të kriterëve për pranimin e kandidatëve që do të ndjekin programin e formimit fillestar dhe shpall listën përfundimtare të tyre. Ligji parashikon se përzgjedhja e magistratëve realizohet përmes një komisioni të posaçëm dhe trajnimit fillestar i tyre realizohet nga një trupë me përgatitje të lartë akademike. Nisur nga këto rregullime, Gjykata vlerëson se normat ligjore nuk përcaktojnë kompetenca që e përfshijnë Këshillin Drejtues drejtpërdrejt në procesin e përzgjedhjes së magistratëve, procesin e trajnimit fillestar e vazhdues dhe akoma më pak në procesin e emërimit të tyre, funksione të cilat respektivisht kanë mbetur të pandryshuara dhe ekskluzive për Presidentin e Republikës, pas propozimit të KLD-së dhe të trupës mësimdhënëse të SHM-së.

37. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si rezultat i ndryshimit të përbërjes së Këshillit Drejtues, është i pabazuar.

38. Një tjetër argument i kërkuesit, në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve dhe pavarësisë së gjyqësorit, ka të bëjë me shmangien e KLD-së nga procedura e emërimit të drejtorit të SHM-së dhe ngushtimin e hapësirës së këtij organi kushtetues në përmbushjen e përgjegjësiave kushtetuese e ligjore.



39. Kushtetuta në nenin 147, pika 4, parashikon se KLD-ja vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësitë e tyre disiplinore sipas ligjit. Gjykata vëren se norma kushtetuese evidenton kompetencat me natyrë ekskluzive të KLD-së, ndërkohë që nuk e parashikon emërimin e drejtorit të SHM-së si kompetencë ekskluzive të KLD-së në ushtrim të funksioneve kushtetuese. Për më tepër, edhe raporti midis SHM-së dhe KLD-së nuk përfaqëson raport varësie midis këtyre institucioneve. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimi për ngushtimin e kompetencave të KLD-së për emërimin e drejtorit të SHM-së është i pabazuar.

40. Gjykata konstaton se një tjetër argument, mbi të cilin kërkuesi dhe KLD-ja bazojnë cenimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, ka të bëjë me ndryshimin e rregullave të pranimi në Shkollën e Magjistraturës dhe përfshirjen e strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë në procesin e vlerësimit të aftësive mendore dhe psikologjike të kandidatëve.

41. Gjykata paraprakisht rithekson qëndrimin e konsoliduar se Kushtetuta i njeh Kuvendit, si organ ligjvënës, të drejtën të zbatojë apo të konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, apo t'u përgjigjet prioriteteve ose problemeve të ndryshme të vendit (*shih vendimet nr. 29, datë 31.5.2010 dhe nr. 43, datë 6.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Është e rëndësishme për çdo shtet të së drejtës që zbaton rregullat e një shoqërie demokratike, të gëzojë hapësira të konsiderueshme për të përcaktuar rregulla dhe kritere të drejta brenda rendit të tij kushtetues, në përputhje me kushtet konkrete, si dhe me faktorët e ndryshëm politikë, historikë, socialë, kulturorë e tradicionalë, të cilët janë përcaktues. Megjithatë, duhet të ritheksohet se ligjet ose dispozita të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të bien në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimet nr. 1, datë 7.1.2005; nr. 32, datë 21.6.2010 dhe nr. 28, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Gjykata vëren se neni 17 i ligjit parashikon se kandidatët që kualifikohen në fazën e parë duhet të kalojnë në një testim lidhur me shëndetin mendor dhe psikologjik, të kryer nga një komision i ngritur nga Këshilli Drejtues i

SHM-së në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë. Ky komision, aspektet teknike të të cilit përcaktohen në rregulloren e shkollës, përbëhet nga dy mjekë psikiatër, dy psikologë dhe një pedagog i brendshëm i SHM-së. Pas kalimit të këtij testimi, kandidatët për gjyqtarë ose prokurorë përfshihen në fazën e dytë të konkurrimit, që zhvillohet me shkrim para një komisioni të përbërë prej 5-7 vetash të caktuar nga Këshilli Drejtues, nga të cilët 2-3 janë pedagogë të brendshëm dhe 3-4 pedagogë të jashtëm me eksperiencë mësimdhënieje në SHM mbi pesë vjet. Këta të fundit nuk mund të jenë dy herë në mënyrë të njëpasnjëshme anëtarë komisioni.

43. Gjykata konstaton se testet psikologjike të aftësisë (*psychological aptitude tests*) përbëjnë tashmë një praktikë të konsoliduar në disa vende të Evropës që i përkasin sistemit të së drejtës kontinentale (Austri, Francë, Holandë). Këto teste zbatohen në mënyra të ndryshme dhe kanë për qëllim jo vetëm të zbulojnë patologji të mundshme të kandidatëve, por edhe të japin informacion në lidhje me motivimin dhe personalitetin e tyre. Gjatë procesit të rekrutimit të kandidatëve për magjistratë, vlerësimi i aftësive psikologjike të tyre, që konsiston në teste personaliteti (standard me shkrim ose në kompjuter) dhe një intervistë me një psikolog, është konsideruar i nevojshëm nga ligjvënësi.

44. Duke e vlerësuar pretendimin e mësipërm në këndvështrimin kushtetues, Gjykata çmon se subjekti i interesuar, KLD-ja, nuk ka arritur të sjellë argumente të mjaftueshme për të justifikuar se në ç'mënyrë përmbajtja e nenit 10 të ligjit të kundërshtuar cenon parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, duke mos arritur ta ngrejë këtë pretendim në nivel kushtetues.

45. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e neneve 4, 7, 136, 147 dhe 149 të Kushtetutës, si rrjedhojë e ndryshimit të përbërjes së Këshillit Drejtues të SHM-së, procedurave të zgjedhjes së drejtorit dhe rregullave për pranimi në SHM, janë të pabazuara.

Ç.2 Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike si rrjedhojë e fuqisë prapavepruese të ligjit

46. Një tjetër pretendim i parashtruar nga kërkuesi dhe KLD-ja ka të bëjë nën 12 të ligjit, i cili ka ndërprerë mandatet e drejtorit, të



pedagogëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm si rezultat i mosplotësimit të kriterëve të reja. Në vlerësimin e kërkuesit, dispozita kalimtare cenon parimin e sigurisë juridike për shkak të fuqisë prapavepruese të ligjit. Në lidhje me këtë pretendim, subjekti i interesuar Kuvendi ka prapësuar se ndërhyrja ligjore përmes ndërprerjes së mandateve justifikohet nga interesi publik i mësimdhënies me standarde.

47. Për sa i përket sigurisë juridike, mbrojtjes së të drejtave të fituara, si dhe pritshmërive të ligjshme si standarde kushtetuese, Gjykata rithekson se ato përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve, duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion. Shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive (*shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005; nr. 9, datë 26.2.2007; nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 4, datë 12.2.2010; nr. 31, datë 18.6.2010; nr. 43, datë 6.10.2011 dhe nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se neni 12 i ligjit, midis të tjerash, përcakton datën 1.9.2014 si afatin e qëndrimit në detyrë të anëtarëve të Këshillit Drejtues të përcaktuar në nenin 6, pika 1, shkronjat “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”. Dispozita kalimtare përcakton afatin 30-ditor nga hyrja në fuqi e ligjit për plotësimin e vendeve vakante, si dhe afatin 5-ditor për verifikimin e plotësimit të kushteve nga drejtori, pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm. Po ashtu, Gjykata konstaton se rregullimi ligjor

me natyrë kalimtare ndërpret mandatet e fituara të organeve të SHM-së.

49. Gjykata rithekson se respektimi i parimit të sigurisë juridike nga ndërhyrjet e pushtetit ligjvënës është vlerësuar lidhur ngushtësisht me të drejtat, liritë themelore apo garancitë e parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta. Nisur nga ky fakt, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e sigurisë juridike në çështjen konkrete vlerësohet në dritën e respektimit të garancive kushtetuese.

50. Bazuar në përfundimin e arritur se SHM-ja nuk është organ kushtetues, Gjykata vlerëson se edhe drejtori i këtij institucioni nuk përfshihet në kategorinë e funksionarëve të cilët gëzojnë mandat kushtetues. Për pasojë, drejtori i SHM-së nuk gëzon mbrojtje të veçantë kushtetuese në nivelin që gëzojnë drejtuesit e organeve apo të institucioneve kushtetuese në rastin e përfundimit të mandatit të tyre dhe procedurat e veçanta për këtë qëllim nuk janë të zbatueshme në rastin konkret. Në këtë kuptim, çështja nëse ligji objekt kundërshtimi ka cenuar sigurinë juridike për drejtorin e SHM-së, nuk përbën një çështje me natyrë kushtetuese, por mund të ngrihet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

51. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në thelb normat ligjore objekt kundërshtimi nuk kanë shkaktuar papajtueshmëri me ndonjë normë kushtetuese, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin që buron nga Kushtetuta për respektimin e parimit të sigurisë juridike dhe qëndrueshmërisë së rendit ligjor si themele të shtetit të së drejtës.

Ç.3 Për pretendimin e cenimit të parimit të autonomisë universitare

52. Gjykata konstaton se një tjetër pretendim i parashtruar nga subjekti i interesuar, KLD-ja ka të bëjë me faktin se si rezultat i përfshirjes në Këshillin Drejtues të një përfaqësuesi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS-i) cenohet parimi i autonomisë së arsimit të lartë, i përcaktuar në nenin 57/7 të Kushtetutës.

53. Në referim të jurisprudencës kushtetuese, parimi i autonomisë universitare është i lidhur ngushtë me parimin e lirisë akademike, i cili është shprehje e përpjekjeve për të mbrojtur lirinë e mendimit shkencor të personave që merren me kërkime shkencore dhe me mësimdhënie. Autonomia universitare është një formë



institucionale e lirisë akademike dhe një parakusht për të garantuar përmbushjen e duhur të funksioneve që i janë besuar personelit mësimdhënës dhe institucioneve të arsimit të lartë. Autonomia universitare është thelbi i vetëqeverisjes, e nevojshme për vendimmarrjen efektive të institucioneve të arsimit të lartë në përmbushjen e detyrave akademike dhe arsimore. Respektimi i parimit të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, të sanksionuar në nenin 57, pika 7 të Kushtetutës, kërkon që ligji të krijojë dimensione të tilla që institucionet e arsimit të lartë të pajisen me pushtet të mjaftueshëm për të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Vetëqeverisja, kolegialiteti dhe drejtimi i përshtatshëm akademik janë elemente thelbësore të autonomisë së vërtetë për institucionet e arsimit të lartë. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë konsiston në të drejtën e vetëqeverisjes së tyre në organizimin e strukturave të brendshme, në zhvillimin e veprimtarive nëpërmjet statuteve dhe rregulloreve të tyre; në të drejtën e zhvillimit të pavarur të veprimtarive kërkimore-shkencore për hartimin e programeve studimore dhe projekteve të kërkimit; në të drejtën për të caktuar kriteret e pranimit të studentëve; në të drejtën për të administruar fonde publike ose për të mbledhur dhe administruar fonde të tjera, si dhe për të realizuar marrëveshje me qeverinë ose me organizma të tjerë për trajnime, kualifikime ose për projekte kërkimore-shkencore (*shih vendimin nr. 9, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Në vështrim të standardit të mësipërm, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka argumentuar se cili aspekt i autonomisë universitare të SHM-së është cenuar nga ndryshimet ligjore objekt kundërshtimi. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues.

55. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, të sigurisë juridike dhe të autonomisë universitare, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a”, 134, paragrafi 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e vijues të ligjit

nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen e kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 97/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar”, Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës së 1/5-ës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

2. Sikurse konstaton edhe shumica, kërkuesi pretendon se normat ligjore, të cilat ndryshojnë formulën e përbërjes së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, mënyrën e zgjedhjes së drejtorit, rregullat për pranimin në Shkollën e Magjistraturës, që ndërpresin mandatet e organeve drejtuese ekzistuese dhe që i japin ligjit fuqi prapavepruese, bien ndesh me parimin e ndarjes së pushteteve, hierarkinë e akteve normative, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, parimin e sigurisë juridike dhe autonominë universitare (*shih paragrafin 23 të vendimit*).

3. Shumica ndryshimet në përbërjen e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe shmangien e KLD-së nga procedura e emërimit të drejtorit të kësaj shkolle, i ka analizuar nën dritën e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Ajo, pasi ka konstatuar funksionet e Këshillit Drejtues (shih paragrafët 29 dhe 36 të vendimit), ka vlerësuar se ndryshimet e ligjit nuk kanë rritur apo zvogëluar numrin total të anëtarëve, por kanë zgjeruar kategorinë e organeve të emërtesës së anëtarëve të Këshillit Drejtues (*shih paragrafin 32 të vendimit*); se KLD-ja dhe Konferenca Gjyqësore Kombëtare gëzojnë statusin e organeve kushtetuese me kompetenca të rëndësishme në



garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor (*shih paragrafin nr. 33 të vendimit*); se Prokurori i Përgjithshëm, ashtu edhe Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, si organ përfaqësues i prokurorëve, kanë për qëllim të përmbushin të njëjtin mision në kuadër të funksioneve që ata ushtrojnë në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjeve. Në këtë këndvështrim, shumica ka arritur në përfundimin se përfshirja e organeve të lartpërmendura në kategorinë e organeve që kanë të drejtë të zgjedhin përfaqësues në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës nuk vë në dyshim cenimin e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor (*shih paragrafët 34- 35 të vendimit*).

4. Gjykata lidhur parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, është shprehur se sipas tij asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që sipas rastit do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se ai shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit: ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Edhe pse pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, vlerësoj se pretendimi i kërkuarit lidhur me cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit pushteteve, në çështjen në shqyrtim, është haptazi i pabazuar. Gjykata duhet të analizonte dhe të vinte në diskutim një standard tjetër, atë të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë ku përfshihet edhe Shkolla e Magjistraturës.

6. Neni 2 i ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë” parashikon se “Shkolla e Magjistraturës siguron formimin profesional të magistratëve (gjyqtarë, prokurorë). Formimi profesional përfshin programin e formimit fillestar të kandidatëve për magistratë dhe të formimit vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Shkolla e Magjistraturës, në përputhje me ligjin ose me kërkesë të institucioneve të interesuara, në varësi të kapaciteteve të lira, që i krijohen nga veprimtaria për formimin fillestar dhe atë vazhdues të magistratëve, si dhe

të fondeve përkatëse, që i viben në dispozicion nga institucionet përgjegjëse apo donatorët, realizon edhe veprimtari të formimit profesional të punonjësve të administratës gjyqësore, si dhe të profesioneve të tjera juridike që lidhen me sistemin e drejtësisë”.

7. Nga sa më lart, në thelb, misioni i Shkollës së Magjistraturës konsiston në formimin fillestar dhe atë vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të aktorëve të tjerë të drejtësisë. Në këtë drejtim, qëllimi i saj është i njëjtë me atë të universiteteve si entitete të shkencës dhe studimit. Për institucionet e arsimit të lartë, Kushtetuta, në nenin 57/7 të saj, ka sanksionuar parimin e autonomisë universitare, i cili është i lidhur ngushtë me parimin e lirisë akademike. Ky i fundit, sipas jurisprudencës së Gjykatës (*shih vendimin nr. 9, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*), është shprehje e përpjekjeve për të mbrojtur lirinë e mendimit shkencor të personave që merren me kërkime shkencore dhe me mësimdhënie. Për këto arsye, në ndryshim nga shumica, mendoj se pretendimet e kërkuarit duhet të shqyrtoheshin nën parimin e autonomisë universitare.

8. Sikurse thekson edhe shumica (*shih paragrafin nr. 53 të vendimit*), respektimi i parimit të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, të sanksionuar në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, kërkon që ligji të krijojë dimensione të tilla që institucionet e arsimit të lartë të pajisen me pushtet të mjaftueshëm për të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Vetëqeverisja, kolegjaliteti dhe drejtimi i përshtatshëm akademik janë elemente thelbësore të autonomisë së vërtetë për institucionet e arsimit të lartë. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë konsiston në të drejtën e vetëqeverisjes së tyre në organizimin e strukturave të brendshme, në zhvillimin e veprimtarive nëpërmjet statuteve dhe rregulloreve të tyre; në të drejtën e zhvillimit të pavarur të veprimtarive kërkimore-shkencore për hartimin e programeve studimore dhe projekteve të kërkimit; në të drejtën për të caktuar kritere të pranimit të studentëve; në të drejtën për të administruar fonde publike ose për të mbledhur dhe administruar fonde të tjera, si dhe për të realizuar marrëveshje me qeverinë ose me organizma të tjerë për trajnime, kualifikime ose për projekte kërkimore-shkencore (*shih vendimin nr. 9, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).



9. Në rastin në shqyrtim ndryshimet që ka sjellë ligji i kundërshtuar konsistojnë, siç u përmend edhe më lart, në ndryshimin e përbërjes së Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, duke bërë pjesë të tij *“një gjyqtar dhe një prokuror me përvojë, që caktohen përkatësisht nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore dhe nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve; një përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, që caktohet nga radhët e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, me përvojë të spikatur në fushën juridike; përgjegjësit e trajnimit fillestar dhe vazhdues, si dhe dy pedagogë të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës”* (neni 6, pikat “ç”, “e” dhe “f” të ligjit të Shkollës së Magjistraturës), si dhe në shmangien e KLD-së nga procedura e emërimit të drejtorit të saj.

10. Jam i mendimit se këto ndryshime nuk cenojnë parimin e autonomisë universitare. Ato janë shprehje e vetëqeverisjes dhe e drejtimit të përshtatshëm akademik, të cilat janë të nevojshme për vendimmarrjen efektive të institucioneve akademike në pëmbushjen e detyrave të tyre. Nga ana tjetër, sikurse thekson Gjykata, ushtrimi i tagrit të vendimmarrjes përbën një shprehje të efektivitetit të autonomisë institucionale (*shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj çmoj se ndryshimet në ligj nuk cenojnë parimin e autonomisë universitare.

11. Gjithashtu nuk jam dakord edhe me arsyetimin e shumicës lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Ligji nr. 97, datë 24.7.2014, objekt shqyrtimi, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 1.9.2014 dhe bazuar në nenin 13 të tij, ka hyrë në fuqi 15 ditë pas këtij publikimi, pra në datë 15.9.2014. Pavarësisht këtij parashikimi, neni 12 i ligjit të kundërshtuar, dispozitë kalimtare, përcakton datën 1.9.2014 si afatin e qëndrimit në detyrë të anëtarëve të Këshillit Drejtues, të përcaktuar në nenin 6, pika 1, shkronjat “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”. Dispozita kalimtare, gjithashtu, përcakton afatin 30-ditor nga hyrja në fuqi e ligjit për plotësimin e vendeve vakante, si dhe afatin 5-ditor për verifikimin e plotësimit të kushteve nga drejtori, pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm. Rregullimi i ri ligjor me natyrë kalimtare, ndërkohë ndërpret edhe mandatet e fituara të organeve të Shkollës së Magjistraturës.

12. Nga sa më sipër, përderisa ligji ka hyrë në fuqi në datën 15.9.2014 dhe neni 12 i tij ka parashikuar datën 1.9.2014, si afatin e qëndrimit

në detyrë të disa prej anëtarëve të Këshillit Drejtues, midis të tjerëve, edhe të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, mendoj se ligji i ka dhënë fuqi prapavepruese, edhe pse për vetëm 15 ditë, ndërprerjes së mandateve të organeve të saj.

13. Në ndryshim nga shumica, jam i mendimit se Gjykata në jurisprudencën e saj nuk e ka lidhur asnjëherë zbatimin e parimit të sigurisë juridike me faktin nëse kemi të bëjmë apo jo me një organ kushtetues, dhe, për rrjedhojë, nëse drejtori i organit në fjalë përfshihet apo jo në kategorinë e funksionarëve të cilët gëzojnë mandat kushtetues. Përkundrazi, Gjykata e ka zbatuar këtë parim edhe ndaj individit. Sikurse thekson edhe vetë shumica, parimi i sigurisë juridike i mishëruar në jurisprudencën kushtetuese përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve, duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion. Shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive (*shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005; nr. 9, datë 26.2.2007; nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 4, datë 12.2.2010; nr. 31, datë 18.6.2010; nr. 43, datë 6.10.2011 dhe nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Pavarësisht sa më lart, edhe pse ligji shfaq problem të natyrës kushtetuese për shkak të parashikimit prapaveprues të dispozitës kalimtare, mendoj se fuqia e tij prapavepruese nuk mund të jetë relevante në rastin në shqyrtim për dy arsye:

Së pari, për shkak të kohës së shkurtër të prapaveprimit të ligjit (15 ditë), mendoj se parashikimi i kësaj fuqie më tepër se qëllim në vetvete është një pakujdesi e ligjvënësist në



vlerësimin e drejtë të harkut kohor nga data e miratimit të ligjit, publikimit të tij në Fletoren Zyrtare dhe hyrjes në fuqi të tij.

Së dyti, përderisa në momentin e shqyrtimit të kërkesës ligji i ka dhënë efektet e tij, shfuqizimi eventual i tij për këtë arsye do të kishte thjesht vlerë formale.

15. Gjithsesi, duke konsideruar se pakujdesi të tilla nuk i shërbejnë stabilitetit juridik të vendit, si një kusht i rëndësishëm për funksionimin e shtetit të së drejtës, në mënyrë që të evitohen ndërhyrje në legjislacion, të cilat mund të çojnë në cenim të parimit të sigurisë juridike, vlerësoj se ligjvënësi duhet të jetë i kujdesshëm në respektimin e parimeve të veprimit të ligjit në kohë.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM Nr. 21, datë 16.4.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Vladimir Kristo anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 10.3.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 6 Akti, që i përket:

KËRKUES: Halit Hoxha, Xhevdet Hoxha, Zija Hoxha, Razije Hoxha

SUBJEKT I INTERESUAR: shoqëria “Filanto Albania” sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Artan Hajdari dhe Envi Hicka, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 10-2012-219 (132), datë 8.2.2012, i Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 00-2012-2437, datë 22.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë; neni 6/1/3/b/c i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 1, protokoll i shtojcë nr. 1 i Konventës; nenet 28, 29, 30, 39, 42 e vijues të ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesve, që janë shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datë 22.12.1994 ndërmjet shtetasit Fadil Hoxha, trashëgimlënës i kërkesve, në cilësinë e shitësit, dhe subjektit të interesuar, shoqëria “Qendra e Përpunimit të Lëkurëve Shijak” sh.p.k., sot e regjistruar me emërtimin “Filanto Albania” sh.p.k., në cilësinë e blerësit, është nënshkruar një kontratë shitblerje nr. 2093 Rep., nr.1391 Kol., për pronën me sipërfaqe 15.500 m², tokë arë, e ndodhur në komunën Xhafzotaj, qarku Durrës.

2. Prona në fjalë e ka origjinën nga procesi i ndarjes së tokës sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, çka rezultoi e provuar me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. 41, datë 21.2.1994. Shitësi, shtetasi Fadil Hoxha, në atë kohë ishte kryetar i familjes bujqësore.

3. Në momentin e shitjes sipërfaqja në fjalë i është dorëzuar subjektit të interesuar. Ky i fundit mbi këtë pronë ka ndërtuar një fabrikë për prodhimin e këpucëve, në të cilën vazhdon aktivitetin e tij të prodhimit. Objekti është ndërtuar me leje ndërtimi, sipas procedurave përkatëse të përcaktuara në ligj, pasi është bërë më parë ndryshimi i destinacionit nga tokë bujqësore në tokë truall (me vendimet nr. 3, datë 13.4.1994 të KRRT-së Durrës dhe nr. 19, datë 10.6.1994 të KRRTRSH-së).

4. Subjekti i interesuar nuk ka mundur ta regjistrojë pronën në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Durrës në momentin e lidhjes së kontratës.



ZVRPP-ja Durrës ka refuzuar të bëjë regjistrimin, për shkak se toka objekt gjykimi ka qenë pronë e të gjithë familjes bujqësore dhe jo vetëm e shitësit dhe si pasojë kontrata e shitblerjes nuk mund të regjistrohet, pasi nuk është e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e familjes bujqësore.

5. Në këto kushte, subjekti i interesuar, shoqëria “Filanto Albania” sh.p.k., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi me objekt detyrimin e kërkesve, trashëgimtarë ligjorë të zotit Fadil Hoxha, për ta njohur pronar të sipërfaqes prej 15.500 m² nëpërmjet fitimit të pronësisë me parashkrim fitues, sipas nenit 168 të Kodit Civil (KC).

6. Gjatë shqyrtimit gjyqësor është paraqitur nga kërkesit kundërpadi me objekt lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes prej 15.200 m², tokë arë, për shkak se kontrata e shitblerjes së tokës ka qenë në kundërshtim me ligjin.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 11-2010-5149 (2932), datë 11.11.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadi dhe kundërpadi si të pabazuara në ligj dhe në prova.

8. Gjykata e Apelit Durrës, mbi ankimin e palëve ndërgjyqëse, me vendimin nr. 10-2012-219 (132), datë 8.2.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë lidhur me rrëzimin e kundërpadi dhe ndryshimin e këtij vendimi për sa i përket disponimit mbi objektin e padi, duke pranuar kërkesëpadinë e subjektit të interesuar. Gjykata e apelit arsyeton se kontrata e shitblerjes është kryer pas ndryshimit të destinacionit të pronës nga tokë bujqësore në tokë truall dhe si e tillë kjo kontratë nuk është e ndaluar nga ligji dhe nuk është pengesë për fitimin me parashkrim fitues.

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin nr. 136, datë 13.4.2012, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 11-2010-5149 (2932), datë 11.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndryshuar pjesërisht nga gjykata e apelit. Ndërsa me vendimin nr. 00-2014-2437, datë 22.11.2012, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkesve, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

10. **Kërkesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”), duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë. Ata kanë parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

10.1. Është cenuar parimi i arsytimit të vendimit gjyqësor, sepse vendimi i gjykatës së apelit përmban kundërtënie dhe nuk ka bërë analizën e plotë të provave.

10.2. Është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje provave të kërkesve.

10.3. Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë përcaktuar mënyrën se si të paditurit kanë humbur të drejtën e pronësisë.

10.4. Është cenuar e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit edhe pse në prani të shkaqeve të parashikuara në nenin 472 të KPC-së nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura dhe në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit.

11. *Subjekti i interesuar*, shoqëria “Filanto Albania” sh.p.k., ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur se:

11.1 Kërkesit nuk legjitimohen për t’ju drejtuar Gjykatës për pretendimin se gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të tyre, pasi nuk kanë ezauruar të gjitha mjetet e njohura nga ligji për riparimin e shkeljes.

11.2 Vendimi i gjykatës së apelit plotëson të gjitha kriteret, në kuptim të standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi në pjesën që ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë ka argumentuar mbi elementet që çuan gjykatën në marrjen e një vendimi të kundërt.

11.3 Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku mbështeten gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes në themel, prandaj pretendimi i kërkesve për vlerësim të provave në gjykatën e apelit është i pabazuar.

11.4 Vendimi i Gjykatës së Lartë përmbush standardet e elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese dhe ajo e GJEDNJ-së për arsytimin e vendimeve në dhomë këshillimi.



11.5 Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë cenuar të drejtën e pronësisë, pasi ato kanë arsyetuar, në zbatim të normave të së drejtës private, mbi mënyrën e fitimit të pronësisë nga njëra prej palëve ndërgjyqëse.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

12. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkuësit nuk legjitimohen për t'ju drejtuar Gjykatës për pretendimin se gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të tyre, pasi nuk kanë ezauruar të gjitha mjetet e njohura nga ligji për riparimin e shkeljes. Sipas subjektit të interesuar, dispozitat e KPC-së ofrojnë mundësi procedurale efektive për riparimin e kësaj shkeljeje. Nëse gjykata në vendimin e saj nuk u ka dhënë zgjidhje të gjitha pretendimeve të ngritura nga palët, kërkuësi mund ta realizojë të drejtën e tij duke kërkuar plotësimin e vendimit sipas nenit 313 të KPC-së. Ndërsa në rastet kur vendimi është i errët, kontradiktor, alogjik, palët mund të eliminojnë paqartësitë duke kërkuar interpretimin e vendimit sipas nenit 314 të KPC-së. Ky mjet është më efektiv sesa rekursi, pasi Gjykatës së Lartë do t'i duhej të sqaronte dhe argumentonte se çfarë ka dashur të thotë gjykata më e ulët.

13. Në kundërshtim nga sa prapëson subjekti i interesuar, Gjykata vlerëson se kërkuësit i kanë ezauruar mjetet për riparimin e shkeljes së pretenduar. Përderisa rekursi në Gjykatën e Lartë mund të kryhet edhe për shkaqet e pretenduara nga kërkuësit, zgjedhja ndërmjet mjeteve të ofruara nga ligjvënësi u përket kërkuësve. Gjithashtu, Gjykata çmon se në prani të disa shkaqeve për të kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit, zgjedhja e një mjeti që i përfshin ato të gjitha, është më efektive se zgjedhja e mjeteve të veçanta për secilin pretendim.

14. Për sa më lart, Gjykata çmon se ky pretendim i subjektit të interesuar nuk është i bazuar dhe se kërkuësit legjitimohen për t'ju drejtuar Gjykatës.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në gjykatën e apelit

15. Kërkuësit, për gjykimin e zhvilluar në gjykatën e apelit, pretendojnë se u janë cenuar

disa të drejta lidhur me procesin e rregullt ligjor, si e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, si dhe e drejta për të marrë një përgjigje përfundimtare prej gjykatës, që sipas tyre lidhet me respektimin e parimit të barazisë së armëve.

16. Subjekti i interesuar lidhur me këtë pretendim prapëson se gjykata e apelit i ka përmbushur të gjitha kriteret e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit, pasi në pjesën që lë në fuqi vendimin e shkallës së parë, në linjë me jurisprudencën e GJEDNJ-së (*shih vendimin Hirvisaari kundër Finlandës, nr. 49684, datë 25.12.2001*), i është referuar dhe ka miratuar arsyetimin e bërë nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa në pjesën që ka ndryshuar këtë vendim ka arsyetuar mbi elementet që e kanë çuar në marrjen e vendimit. Gjithashtu, ai prapëson se Gjykata nuk ka si detyrë të analizojë provat dhe faktet ku mbështeten gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes në themel, prandaj pretendimi i kërkuësve për vlerësim të provave në gjykatën e apelit është i pabazuar.

17. Gjykata ka tashmë jurisprudencë të konsoliduar për parimet të cilat pretendohen nga kërkuësit se janë cenuar. Për të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, Gjykata është shprehur se ajo përfshihet në kuadrin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42, 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata, po ashtu, ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai



duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendur. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete e natyrës së vendimit, dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky detyrim nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008 dhe nr. 35, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa i përket së drejtës së aksesit, Gjykata ka vlerësuar se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për parimin e barazisë së armëve në gjykim, Gjykata është shprehur se ai është një parim i cili është pjesë e domosdoshme si e procesit penal, ashtu edhe atij civil. Edhe ky parim, ndonëse zhvillohet më shumë nga doktrina dhe jurisprudenca në fushën penale, ku ky i fundit është pjesë e së drejtës së mbrojtjes të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës, është përsëri i zbatueshëm në procesin civil, pasi ky proces duhet të garantojë barazi substanciale të palëve

nëpërmjet një kontradiktoriteti efektiv midis tyre (*shih vendimin nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuësve, dhe ia ka nënshtruar ato debatit gjyqësor dhe se vendimi i gjykatës përmbush elementet që burojnë nga KPC-ja dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate për arsyetimin e vendimit. Gjithashtu, Gjykata konstaton se pavarësisht se kërkuësit pretendojnë cenimin e parimeve të lartpërmendura, ata nuk kanë përcaktuar konkretisht se ku konsistojnë këto shkelje. Në thelb, ajo që kërkuësit parashtrojnë ka të bëjë me mënyrën e fitimit të pronësisë së sipërfaqes së tokës dhe zbatimin e institutit të parashkrimit fitues.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur, në mënyrë të vazhdueshme se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor, të cilat nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 26, datë 15.12.2008; nr. 7, datë 27.4.2005 dhe nr. 106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit nuk ka cenuar të drejtën e aksesit, parimin e arsyetimit të vendimit dhe atë të barazisë së armëve. Prandaj pretendimet e lartpërmendura të kërkuësve për procesin e zhvilluar në atë gjykatë nuk janë të bazuara.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike

25. Kërkuësit parashtrojnë se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë përcaktuar mënyrën se si të paditurit kanë humbur të drejtën e pronësisë, çka, sipas tyre, ka passjellë cenimin e parimit të sigurisë juridike. Ndërsa subjekti i interesuar prapëson se gjykatat e faktit, në zbatim



të normave të së drejtës private, kanë argumentuar për mënyrën e fitimit të pronësisë nga njëra prej palëve ndërgjyqëse.

26. Gjykata në lidhje me parimin e sigurisë juridike ka theksuar se ai nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. (*shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më sipër, në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se përderisa pretendimi i kërkuësve për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk lidhet me ekzistencën e ndonjë vendimi të formës së prerë, ai (pretendimi) nuk është ngritur në nivel kushtetues. Gjykata gjithashtu çmon se edhe ky pretendim i kërkuësve në thelb ka të bëjë me mënyrën e fitimit të pronësisë, që, sikurse u tha më lart (*shih paragrafin 23*), nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

D. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga vendimi i Gjykatës së Lartë

28. Gjykata, nën dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së, për zbatimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore nga Gjykata e Lartë, të pretenduar nga kërkuësit, është shprehur se për vendimet e dhëna prej saj në dhomë këshillimi, mënyra e formulimit të pjesës arsyetuese të këtij vendimi, se “*rekursi nuk përmban shkaqe ligjore*”, është e rregullt. Fakti se në këtë vendim nuk u jepet përgjigje e detajuar të gjitha pretendimeve të palëve, nuk do të thotë se ky vendim është i paarsyetuar, përderisa shkaqet e parashtruara në rekurs, të ngritura si shkaqe ligjore për prishjen e vendimit të gjykatës së

apelit, nuk gjejnë mbështetje as në ligj dhe as në materialet e çështjes. Kur Gjykata e Lartë nuk pranon një rekurs për shkak se nuk është parashtruar baza ligjore e çështjes, kërkesat e nenit 6 të Konventës Evropiane e Drejtave të Njeriut mund të plotësohen me një arsyetim shumë të kufizuar (*shih vendimet nr. 17, datë 16.5.2011; nr. 26, datë 13.6.2011 dhe nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjithashtu, Gjykata për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005 dhe nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata vëren se në çështjen në fjalë përmbajtja e shkaqeve të ngritura në rekurs nuk ka të bëjë me cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por me mënyrën e interpretimit të ligjit, konkretisht dispozitave që lidhen me institutin e parashkrimit fitues, që është kompetencë ekskluzive e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin dhe ka vendosur mospranimin për mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, duke ushtruar në këtë mënyrë funksionin e saj si gjykatë e ligjit.

31. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësve janë të pabazuara dhe, për pasojë, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash¹¹

¹¹ Gjyqtari V. Kristo votoi për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë sipas qëndrimit të shprehur në mendimin paralel të vendimit nr. 37, datë 30.6.2014, të Gjykatës Kushtetuese lidhur me cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit të mospranimin të rekursit të



VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari

Anëtar kundër: Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 37, datë 18.3.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SHPK
NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë Elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 38, datë 18.3.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SHPK
PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika 4, dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,



konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Dokumentacioni i përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit është plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4/9, gjerat “a”, “b”, “c”, dokumentacioni teknik është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 39, datë 18.3.2015

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.3.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të

Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 155, datë 29.12.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshohet si më poshtë: “Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do të shtrijë efektet deri në datën 30.6.2015”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 40, datë 18.3.2015

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR
TË ERE-s “GJENDJA E SEKTORIT TË
ENERGJISË DHE VEPRIMTARISË SË
ERE-s” GJATË VITIT 2014**

Në zbatim të neneve 9 dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, neni 13, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 18.3.2015, pasi shqyrtoi raportin vjetor të ERE-s, “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2014”, të paraqitur nga grupi i punës,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit vjetor të ERE-s “Gjendja e sektorit të energjisë dhe veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2014”, që do t’i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë (raporti bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**UDHËZIM****Nr. 4, datë 9.4.2015****PËR MËNYRËN E CAKTIMIT DHE ORGANIZIMIT TË VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, KRITERET PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË GRUPEVE TË NUMËRIMIT PËR ÇDO VEND TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR NDARJEN E DETYRAVE MIDIS ANËTARËVE TË GRUPIT TË NUMËRIMIT**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 23, pika 1, germa “b”, nenit 93, nenit 94, nenit 95 dhe nenit 96, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:**PJESA I
TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim të detajojë rregulla për mënyrën e caktimit dhe të organizimit të vendit të numërimit të votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit të votave për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit të votave.

**Neni 2
Parime të përgjithshme**

1. Vendi i numërimit të votave (VNV) caktohet me vendim të KQZ-së, sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor dhe përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Për numërimin e votave në rang ZAZ-je, nuk mund të caktohen më pak gjashtë dhe më shumë se njëzet grupe të numërimit të votave (GNV).

3. Numri i grupeve të numërimit të votave, të cilat angazhohen në të njëjtën kohë për numërimin e votave në VNV nuk mund të jetë më pak se tre dhe me shumë se dhjetë.

4. KZAZ-ja cakton me vendim numrin e GNV-ve që do të numërojnë votat në rang ZAZ-je.

5. Anëtarët e GNV-së emërohen nga KZAZ-ja.

6. Çdo grup numërimi përbëhet nga numëruesi i parë, sekretari dhe 2 anëtarë.

7. Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 qendra votimi.

**PJESA II
CAKTIMI DHE ORGANIZIMI I VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE****Neni 3
Vendndodhja e VNV-së**

1. Vendndodhja e VNV-së caktohet me vendim të KQZ-së, jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve dhe vendoset menjëherë në dispozicion të KQZ-së për instalimin e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

2. KQZ-ja, për caktimin e vendit të numërimit të votave, mund të përzgjedhë bashkinë qendër qarku, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së ose bashkinë brenda territorit të ZAZ-së, apo edhe në njësinë më të madhe administrative, nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 4 të këtij udhëzimi.

3. Në përzgjedhjen e VNV-së merren parasysh: përparësitë logjistike të transportit rrugor, distancat nga qendrat e votimit, hapësira që ofron ambienti, si dhe mundësitë për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.

**Neni 4
Kritere teknike të VNV-së**

1. Për zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë në përbërje të tyre deri në 30 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 120 m².

2. Për zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë në përbërje të tyre deri në 50 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 150 m².

3. Për zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë në përbërje të tyre deri në 80 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 200 m².

4. Për zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë në përbërje të tyre mbi 80 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 300 m².



5. Të ketë sistem të siguruar e të pandërprerë ndriçimi dhe energji elektrike, si në mjediset e brendshme ashtu edhe përreth godinës, të mjaftueshme për të suportuar teknologjinë mbështetëse të numërimit të votave.

6. Të ofrojë mundësitë e instalimit të teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.

7. Të ketë, për aq sa është e mundur, më shumë se një derë komunikuese me mjedisin e jashtëm.

8. Të jetë e pajisur me mjete të mbrojtjes kundër zjarrit, si dhe të ndihmës së shpejtë.

Neni 5

Organizimi i vendit të numërimit të votave

1. KQZ-ja, në bashkëpunim me organet e tjera qendrore ose vendore, siguron pajisjet e nevojshme logjistike, përfshirë edhe ndriçimin e pandërprerë, për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave.

2. Menjëherë me marrjen në dorëzim nga KQZ-ja të VNV-së, KZAZ-ja në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, merr masa për krijimin e kushteve të përshtatshme për instalimin e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

3. Vendet e numërimit të votave vihen në dispozicion të KZAZ-ve jo më vonë se dhjetë ditë para datës së zgjedhjeve.

4. KZAZ-ja organizon dhe përgatit vendin e numërimit të votave, në mënyrë të tillë që të garantojë zhvillimin normal të punës për numërimin e votave, sipas planvendosjes tip, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Për çdo grup numërimi vendosen tryeza pune, duke siguruar që ato të kenë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procesit të numërimit të votave.

6. KZAZ-ja organizon hapësirën e VNV-së, në mënyrë të tillë që:

a) hapësirat ku kryhet numërimi i votave të jenë të mjaftueshme dhe të ndara qartë nga hapësirat për vëzhguesit, kandidatët dhe mediat;

b) tavolinat e numërimit të jenë të shikueshme nga anëtarët e KZAZ-së, vëzhguesit, kandidatët dhe përfaqësuesit e medias;

c) hapësira ku do të qëndrojnë vëzhguesit të jetë përballë dhe në largësi të vogël nga hapësira ku do të vendosen tavolinat e numërimit ose nga

monitorët kur përdoret teknologjia mbështetëse për numërimin e votave.

7. Në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk duhet cenuar mundësia e vëzhguesve për të ndjekur nga afër procesin e numërimit dhe shfaqjen e fletëve të votimit në monitorët e vendosur, për këtë qëllim.

8. Organizimi fizik i hapësirës në dispozicion të çdo grupi numërimi duhet të bëhet në mënyrë të tillë që:

a) tryeza e punës ku do të kryhet numërimi i votave të ketë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procesit të numërimit të votave;

b) të mundësojë aplikimin e teknologjisë mbështetëse;

c) të pengojë kontaktin fizik të personave të tjerë të pranishëm në VNV me materialet e votimit.

9. Jo më vonë se pesë ditë para datës së zgjedhjeve, bëhet rregullimi përfundimtar i VNV-së, sipas planvendosjes orientuese bashkëlidhur këtij udhëzimi, si dhe vendosen pajisjet logjistike të nevojshme për kryerjen e procesit të numërimit, si më poshtë:

a) tavolina pune dhe 8 karrige për KZAZ-në;

b) tavolinë pune me 2 karrige për ndihmësit teknikë;

c) dyshe tavolinash (vendosen sipas shpjegimit në skemën orientuese) me nga katër karrige për çdo tavolinë numërimi të votave;

d) kompjuter, printer, fotokopje, skaner dhe telefon/fax për KZAZ-në;

e) monitorët;

f) kamerat regjistruese;

g) struktura ndarëse të hapësirës së vëzhguesve, kandidatëve dhe mediave me hapësirën për numërimin e votave;

h) tabelat treguese të dërguara nga KQZ-ja;

i) tabelat treguese për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV-së.

10. Në çdo rast, organi që administron objektin ku është vendosur VNV-ja merr masa për sigurimin e pajisjeve logjistike, të parashikuara në gerat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 9, të këtij neni.

11. KZAZ-ja, jo më vonë se pesë ditë para datës së zgjedhjeve, fton për njohje të vendit të numërimit të votave subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve.



PJESA III

NGRITJA E GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

Neni 6

Kriteret për caktimin e tavolinave të numërimit dhe numrit të grupeve të numërimit të votave

1. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë deri në 30 qendra votimi, KZAZ-ja vendos tri tavolina të numërimit të votave dhe cakton ngritjen e gjashtë grupeve të numërimit të votave.

2. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 31 deri në 50 qendra votimi, KZAZ-ja vendos katër tavolina të numërimit të votave dhe cakton ngritjen e tetë grupeve të numërimit të votave.

3. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 51 deri në 80 qendra votimi, KZAZ-ja vendos pesë tavolina të numërimit të votave dhe cakton ngritjen e dhjetë grupeve të numërimit.

4. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 81 deri në 100 qendra votimi, KZAZ-ja vendos gjashtë tavolina të numërimit të votave dhe cakton ngritjen e dymbëdhjetë grupeve të numërimit.

5. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 101 deri në 115 qendra votimi, KZAZ-ja vendos shtatë tavolina të numërimit të votave dhe cakton ngritjen e katërbëdhjetë grupeve të numërimit.

6. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 116 deri në 130 qendra votimi, KZAZ-ja vendos tetë tavolina të numërimit të votave dhe cakton ngritjen e gjashtëmbëdhjetë grupeve të numërimit.

7. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë nga 131 deri në 140 qendra votimi, KZAZ-ja vendos nëntë tavolina të numërimit të votave dhe cakton ngritjen e tetëmbëdhjetë grupeve të numërimit.

8. Në zonat e administrimit zgjedhor, të cilat kanë mbi 140 qendra votimi, KZAZ-ja vendos dhjetë tavolina të numërimit të votave dhe cakton ngritjen e njëzet grupeve të numërimit.

9. Grupet e numërimit të votave janë 2 për çdo tavolinë numërimi.

10. Tavinat e numërimit të votave numërtohen nga KZAZ-ja në rend rritës.

Neni 7

Caktimi i numrit të grupeve të numërimit të votave

1. KZAZ-ja, jo më vonë se 15 ditë para ditës së votimit, cakton me vendim numrin e grupeve të numërimit të votave që do të numërojnë votat në rang ZAZ-je. Për caktimin e numrit të GNV-ve, KZAZ-ja përdor modelin tip të miratuar me vendim të KQZ-së.

2. KZAZ-ja i numëron GNV-të me numër rendor rritës. Numri i fundit rendor është gjithmonë numër çift.

3. Grupi i dytë i numërimit të votave fillon numërimin e votave menjëherë pas përfundimit të procesit nga grupi i parë i numërimit të votave.

4. Grupet e dyta të numërimit të votave rrinë në gatishmëri dhe me vendim të KZAZ-së zëvendësojnë menjëherë grupet e para, edhe në rastet kur grupet e para ndërpresin punën pa shkaqe të përligjura.

5. Nëse nuk është e nevojshme, grupet e dyta nuk futen në punë.

PJESA IV

EMËRIMI I ANËTARËVE TË GRUPEVE TË NUMËRIMIT

Neni 8

Paraqitja e propozimeve nga partitë politike

1. KZAZ-ja njofton me shkrim partitë politike, të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve, për numrin e GNV-ve që do të ngrihen dhe u kërkon të dorëzojnë propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, të paktën 12 ditë para ditës së zgjedhjeve.

2. Propozimet për dy nga anëtarët e grupeve të numërimit bëhen nga partitë politike, të cilat kanë propozuar Kryetarin dhe zëvendëskryetarin e KZAZ-së.

3. Propozimet për anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve bëhen nga partitë politike, që janë të përcaktuara me vendim të KQZ-së.

4. Propozimet për anëtarë të GNV-ve i paraqiten KZAZ-së. Partitë politike mund t'i delegojnë degëve lokale të tyre të drejtën e propozimit për anëtarë të GNV-ve. Propozimet për çdo anëtar të GNV-së shoqërohen me dokumentet e mëposhtme:

- a) certifikatë personale;
- b) fotokopje e letërnjoftimit;



c) kopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë.

Neni 9

Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit të GNV-së

Anëtari i grupit të numërimit të votave, nuk mund të jetë:

- a) deputet ose kandidat për deputet në Kuvend;
- b) kryetar i njësisë së qeverisjes vendore;
- c) ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose Shërbimit Informativ Shtetëror;
- d) anëtar i një grupi tjetër numërimi.

Neni 10

Kushtet për emërimin e anëtarit të GNV-së

Anëtar i grupit të numërimit të votave mund të emërohet çdo person që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
- b) ka arsim të lartë;
- c) është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- e) ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

Neni 11

Emërimi i anëtarëve të grupeve të numërimit të votave

1. KZAZ-ja, jo më vonë se dhjetë ditë para datës së zgjedhjeve emëron anëtarët e grupeve të numërimit të votave pasi i gjen ata në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 9 dhe 10 të këtij udhëzimi.

2. Për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, KZAZ-ja përdor modelin tip “Për emërimin e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave”, miratuar me vendim të KQZ-së.

Neni 12

Procedura e zgjedhjes për numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV-ve

KZAZ-ja emëron numëruesin e parë dhe sekretarin e grupeve të numërimit, sipas procedurës së mëposhtme:

- a) Partia politike, e cila ka propozuar

zëvendëskryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “tek” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “çift” të numërimit të votave;

b) Partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “çift” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “tek” të numërimit të votave;

c) Anëtari i tretë dhe i katërt i grupeve të numërimit emërohen nga propozimet e partive politike, të cilave u ka lindur e drejta të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt, sipas shortit të hedhur në KQZ, për çdo ZAZ.

Neni 13

Zëvendësimi i anëtarëve të grupit të numërimit

1. Në rast se një parti politike nuk paraqet propozim brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 8 të këtij udhëzimi, KZAZ-ja me vendim cakton anëtarët zëvendësues.

2. Partia politike, e cila ka të drejtën të paraqesë propozimin për anëtarin e tretë ose të katërt të GNV-ve, sipas shortit të hedhur në KQZ dhe nuk ka anëtarë në KQV, humbet të drejtën të paraqesë anëtar të GNV-ve, nëse nuk respekton afatin e parashikuar në pikën 1 të nenit 8 të këtij udhëzimi.

3. Anëtarët zëvendësues caktohen me short ndërmjet anëtarëve të KQV-ve që i përkasin të njëjtit grupim politik në zonën e administrimit zgjedhor.

4. Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të grupit të numërimit të votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

Neni 14

Procedura e shortit për zëvendësimin e anëtarëve të GNV-ve

Anëtari zëvendësues i GNV-ve caktohet nga KZAZ-ja mbi bazën e rezultatit të shortit, të hedhur sipas kësaj procedure:

a) Sekretari i KZAZ-së përzgjedh të gjithë anëtarët e KQV-ve, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 9 dhe në nenin 10, të këtij udhëzimi;



b) Anëtarët e KQV-ve renditen, në mënyrë rastësore, në lista sipas partive politike, të cilat i kanë propozuar;

c) Çdo emri të renditur në secilën listë, i vendoset nga një numër rendor rritës, duke filluar nga 01;

d) Në një enë transparente vendosen shirita letre, ku janë shënuar numrat rendorë që i korrespondojnë çdo anëtar të KQV-së të partisë politike përkatëse të renditur në listë;

e) Kryetari i KZAZ-së tërheq shirita letre në numër të barabartë me numrin e anëtarëve të GNV-ve që mungojnë;

f) Anëtar i KQV-së, i emëruar me propozim të partisë politike, për të cilën hidhet shorti, të cilit i korrespondon numri rendor i shënuar në shiritin e letrës së tërhequr, caktohet anëtar i grupit të numërimit;

g) Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka anëtar në KQV, u përket partive të shumicës parlamentare, shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të shumicës parlamentare, e cila ka propozuar anëtar në KQV;

h) Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka anëtar në KQV i përket partive të opozitës parlamentare, shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të opozitës parlamentare, e cila ka propozuar anëtar në KQV.

Neni 15

1. Kur vendi i një anëtar të grupit të numërimit mbetet vakant gjatë procesit të numërimit të votave, partia politike, e cila kishte propozuar anëtarin, paraqet menjëherë propozimin e ri.

2. Nëse partia politike përkatëse nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur vakant, GNV-ja vazhdon numërimin kur anëtarët në detyrë nuk janë më pak se dy.

3. Nëse nga vakancat e krijuara GNV-ja mbetet me më pak se dy anëtarë, për plotësimin e vakancave KZAZ-ja zbaton procedurat e shortit të përcaktuara në nenin 14 të këtij udhëzimi.

PJESA V


HYRJA NË FUQI

Neni 16

Udhëzimi i KQZ-së nr. 12, datë 21.4.2009, “Për caktimin dhe përgatitjen e vendit të numërimit të votave, mënyrën e ngritjes së grupeve të numërimit dhe caktimin e tavolinave të numërimit të votave”, shfuqizohet.

Neni 17

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006